LIGJ
Nr.10 267, datë 15.4.2010

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË MANDATIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE DEUTSCHE BANK AG, LONDON E J. P. MORGAN SECURITIES, LTD, SI MENAXHERË BASHKËDREJTUES, PËR TRANSAKSIONIN E EMETIMIT TË EUROBONDIT DERI NË 400 MILIONË EURO DHE MIRATIMIN E DOKUMENTEVE TË TJERA TË TRANSAKSIONIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 e 2, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e mandatimit e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Deutsche Bank AG, London e J. P. Morgan Securities, ltd në rolin e menaxherëve bashkëdrejtues.

Neni 2

Miratohen tekstet e dokumenteve të mëposhtme, që lidhen me transaksionin:
1. Marrëveshje nënshkrimi;
2. Marrëveshje e agjencisë fiskale;
3. Marrëveshje zotimi;
4. Marrëveshje për termat dhe kushtet e notave (titujve),
sipas anekseve A, B, C dhe D, që i bashkëlidhen këtij ligji, për transaksionin e emetimit të titujve të eurobondeve.

Neni 3

1. Autorizohet Ministri i Financave që, brenda kufijve të përcaktuar në tekstet e dokumenteve, të nënshkruajë marrëveshjet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, për shumën deri në 400 (katërqind) milionë euro.
2. Ngarkohet Ministri i Financave të miratojë, të publikojë dhe të përditësojë prospektin e lidhur me emetimin e titujve të eurobondeve.

Neni 4

Republika e Shqipërisë merr përsipër të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji e të nënshkruara në përputhje me pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 5

Mbajtësit e titujve të eurobondeve dhe menaxherët bashkëdrejtues përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, për të gjitha transaksionet e lidhura me emetimin dhe tregtimin e eurobondeve.

Neni 6

Tejkalimi i kufijve (limiteve) të përcaktuar në nenin 58 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në asnjë rast nuk sjell si pasojë

pavlefshmërinë e asnjërës prej marrëveshjeve apo dokumenteve të transaksionit të eurobondit.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6513, datë 16.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

2 mars 2010

Ministria e Financave të Shqipërisë
Në vëmendje të z. Xhentil Demiraj
Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit të Borxhit
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1
Tirana, Albania

Të dashur zotërinj,

Deutsche Bank AG, Dega e Londrës ("Deutsche Bank") dhe J.P. Morgan Securities Ltd. ("JPM") kanë kënaqësinë të përcaktojnë në këtë letër (kjo letër së bashku me shtojcën 1 të kësaj letre, "Marrëveshja") termat sipas të cilave Republika e Shqipërisë ("Republika") ka angazhuar secilën prej Deutsche Bank and JPM (Deutsche Bank and JPM secila nje "Joint Lead Manager" dhe, së bashku, "Joint Lead Managers") të veprojnë si menaxherë drejtues të përbashkët dhe depozitues të përbashkët për emetimin dhe ofrimin e një minimumi obligacionesh të pasiguruara prej 300 milionë euro, me maturim prej 3 ose 5 vjetësh, vetëm Reg S ("Notave")* nga Republika, dhe ky emetim dhe ofertë janë përmendur në këtë Marrëveshje si "Veprimi".

Një grafik i përafërt që përcakton termat orientuese për notat, bashkëngjitet si shtojcë 1 në këtë letër. Termat përfundimtare, çmimi dhe struktura do të miratohet në kohën e fillimit të Veprimit, bazuar në kushtet ekzistues të tregut.

Në këtë Marrëveshje:

a) "Grupi Deutsche Bank" është Deutsche Bank, Deutsche Bank AG dhe anëtarët e tjerë të grupit të shoqërive të kontrolluara nga Deutsche Bank AG;

b) "Grupi JPM" është JP Morgan Securities Ltd. dhe anëtarët e tjerë të grupit të shoqërive të kontrolluara nga JPMorgan Chase & Co; dhe

c) "Grupi përkatës" është, në rastin e Deutsche Bank, Deutsche Bank Group, dhe në rastin e JPM, Grupi JPM.

1. ANGAZHIMI

Republika angazhon Joint Lead Managers për të vepruar si menaxherë drejtues të përbashkët dhe depozitues të përbashkët për Veprimin sipas termave të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse deri më 31 dhjetor 2010 në një moment Republika vendos të rihape Notat nëpërmjet "rihapjes" ("Rihapja"), Republika u jep Joint Lead Managers të drejtën e refuzimit të parë për të vepruar si depozitues të përbashkët për çdo Rihapje. Për mënjanimin e dyshimit, secila Rihapje do të jetë me të njëjtat terma në lidhje me tarifat dhe shpenzimet si Veprimi, dhe do t'u nënshtrohet të njëjtave kushte si ato që gjenden në këtë letër.

Kuptohet që Joint Lead Managers do të kenë të drejtën e refuzimit të parë për çdo instrument derivativi ose garanci në lidhje me Veprimin. Çdo instrument derivativi ose garanci do të përbëjë një veprim të pavarur dhe të ndarë për angazhimin e Joint Lead Managers dhe do të jete subjekt i një marrëveshjeje të veçante ndërmjet këtyre Joint Lead Managers dhe Republikës së Shqipërisë me terma reciprokisht të pranueshëm.

[1] Termi "Note" i referohet instrumentit te titullit te borxhit (Shenim i Perkthyesit)

Detyrimet e Joint Lead Managers në këtë Marrëveshje janë të ndarë dhe jo të përbashkët.

2. DETYRIMET

Në pajtim me angazhimin e tyre në pajtim me këtë Marrëveshje, Joint Lead Managers bien dakord të përmbushin shërbimet e mëposhtme ("Shërbimet"), dhe Shërbimet janë:

a) Veprimi si menaxherë drejtues të përbashkët dhe depozitues të përbashkët të Veprimit;

b) Asistimi me dokumentacionin në lidhje me Veprimin, me qëllim që ky dokumentacion të përgatitet, negociohet dhe ekzekutohet në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Republikën dhe Joint Lead Managers;

c) Puna me këshilltarin ligjor të Joint Lead Managers dhe me këshilltarin ligjor të Republikës;

d) Asistimi i Republikës për të përcaktuar termat e përshtatshëm (duke përfshirë madhësinë e emetimit, çmimin dhe maturimin) e Veprimit;

e) Puna me agjentin e listimit, sipas rastit, dhe Republikën me qëllim përftimin e një listimi të Notave në tregun e rregulluar të bursës EEA ose bursë tjetër që mund të bihet dakord ndërmjet Republikës dhe Joint Lead Managers;

f) Nëse Republika dhe Joint Lead Managers bien dakord që është e përshtatshme, formimi i një sindikate menaxhimi me menaxherë bashkëdrejtues dhe bashkëmenaxherë për Veprimin;

g) Bashkërendimi i procesit të tregtimit dhe roadshow të Veprimit; dhe

h) Kryerja e shërbimeve të tjera që mund të bihet dakord bashkërisht ndërmjet Joint Lead Managers dhe Republikës.

Në përmbushjen e Shërbimeve, Joint Lead Managers do të punojnë me Republikën dhe persona të tjerë ose subjekte, siç bihet bashkërisht dakord ndërmjet Joint Lead Managers dhe Republikës.

Republika autorizon çdo Joint Lead Manager për të bërë ato veprime që janë të nevojshme për përmbushjen e rregullt në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

3. KUSHTET PARAPRAKE

Pjesëmarrja e Joint Lead Managers në çdo Veprim do t'i nënshtrohet, ndërmjet të tjerash (i) përmbushjes së pranueshme të procesit të dokumentacionit; (ii) përmbushje e pranueshme e të gjithë dokumentacionit të Veprimit duke përfshirë prospektin paraprak, një prospekt final dhe marrëveshjet përkatëse duke përfshirë, sipas rastit, marrëveshjen e nënshkrimit dhe marrëveshjen e agjencisë paguese; (iii) përmbushjen ne mënyrë te kënaqshme të një rishikimi të zakonshëm kujdesi para roadshow, përcaktimit te çmimit, nënshkrimit dhe mbylljes; (iv) në përcaktimin e Joint Lead Managers, mungesa e një prej ndryshimeve negative që përshkruhen në gjuhën standarde të tregut (dispozita 2) të Shoqatës Ndërkombëtare të Tregjeve të Kapitalit të (a) vendit të Republikës, Gjermane, Mbretërisë së Bashkuar dhe ndonjë vend tjetër të Joit Lead Managers dhe (b) gjendjes financiare, operacioneve dhe prospekteve të Republikës; (v) mosbërja e asnjë deklarimi nga Republika, që sipas mendimit të Joint Lead Managers mund të ketë efekt negativ në tregtimin e Notave; (vi) marrja e të gjitha aprovimeve të kërkuara dhe mendimeve të përshtatshme ligjore, mendimet tatimore dhe letrat e pranimit; dhe (vii) aprovimi i komitetit të brendshëm përkatës të Joint Lead Managers.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifat

Në lidhje me kryerjen nga Joint Lead Managers të Shërbimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Republika bie dakord të paguajë Joint Lead Managers një tarifë prej 0.17 për qind të shumës së përgjithshme principale të Notave dhe kjo shumë do të zbritet nga të ardhurat e emetimit të Notave pas emetimit. Një tarifë e tillë mund të ndahet ndërmjet tarifave të koncesionit të shitjes dhe menaxhimit dhe nënshkrimit sipas pëlqimit të Joint Lead Managers.

4.2 Shpenzimet

a) Joint Lead Managers bie dakord të jetë përgjegjëse për tarifat dhe shpenzimet e mëposhtme fillestare:

- Këshillimi Ndërkombëtar ligjor për Joint Lead Managers;
- Këshillimi ligjor shqiptar për Joint Lead Managers,
- Të gjitha shpenzimet e roadshow dhe shpenzimet për çdo prezantim për investitorët;
- Tarifat dhe shpenzimet e të gjithë agjentëve fiskalë dhe pagues;
- Shpenzimet dhe tarifat e agjentit listues dhe të gjithë agjentëve të tjerë të përfshirë në Veprim (sipas rastit);
- Të gjitha tarifat e listimit të bursës dhe shpenzimet e tjera të listimit;
- Shpenzimet e printimit dhe shpërndarjes së çdo prospekti paraprak, prospekti apo dokument tjetër deklarues dhe çdo literaturë tjetër shitjeje apo material marketimi për Notat, shpenzimet e printimit; dhe

- Të gjitha shpenzimet e çastit dhe shpenzime të tjerë për secilin Joint Lead Manager.

b) Republika do të jetë përgjegjëse për të gjitha tarifat, shpenzimet e saj dhe kostot e shkaktuara në lidhje me Veprimin duke përfshirë, pa kufizim, tarifat për këshillimin e vet ligjor ndërkombëtar dhe të brendshëm, çdo tarifë agjencie vlerësimi dhe çdo tarifë tjetër dhe shpenzime të shkaktuara në lidhje me Veprimin që nuk përmenden në 4.2(a). Republika është gjithashtu përgjegjëse për të gjitha tarifat, shpenzimet dhe kostot e tjera të shkaktuara në lidhje me Notat gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre deri në maturim, duke përfshirë koston e printimit të notave definitive, nëse është e nevojshme.

4.3 TERMAT E PAGESËS

Të gjitha pagesat në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në pajtim me udhëzimet e pagesave të Joint Lead Managers dhe në datën e kërkueshme të pagesës ose brenda 30 ditëve kalendarike të faturës (sipas rastit). Të gjitha shumat e pagueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë te përjashtuara nga TVSH, tatime shitjeje apo të ngjashme që mund të jenë të pagueshme për ato pagesa, që do të faturohen, ose janë të pagueshme, nga Republika. Të gjitha pagesat në bazë të kësaj Marrëveshjeje bëhen të plota pa kompensime, kusht, kufizim, kundër-pretendim, zbritje apo ndalim. Në rastin e vonesës në pagesë për një shumë të kërkueshme nga Joint Lead Managers në bazë të kësaj letre, do të paguhet interesi për atë shumë të llogaritur (duke përfshirë) datën e kërkueshme deri në datën e pagesës, të dyja para dhe pas vlerësimit, të llogaritur dhe që mblidhen me bazë ditore me një normë vjetore prej 1% mbi normën bazë të Deutsche Bank ose JPM në datën e kërkueshme.

5. ROLI I JOINT LEAD MANAGERS

Joint Lead Managers nuk do të jenë përgjegjës për ofrimin ose marrjen në emër të Republikës këshillim ligjor, rregullator, financiar, tatimor ose tjetër në lidhje me Veprimin. Republika konsultohet me këshilltarët e saj në lidhje me këto çështje dhe është përgjegjëse për të bërë hetimet dhe vlerësimet e tjera të pavarura të Veprimit të parashikuara këtu. Veçanërisht Joint Lead Managers nuk do të jenë përgjegjës për të kryer ndonjë punë kujdesi në lidhje me Republikën ose Veprimin, përveç punës së kujdesit që është e zakonshme për një menaxher drejtues për një çështje të titujve të borxhit si Notat. Republika e njeh dhe bie dakord që çdo shërbim i parashikuara nga Joint Lead Managers në lidhje me këtë letër nuk përbën "këshillim investimi" sipas përkufizimit të paragrafit 1(4) të nenit 4 të Tregjeve në Direktivën e Instrumenteve Financiare (2004/39/EEC).

Republika njeh dhe bie dakord që Joint Lead Managers, në dhënien e shërbimeve të investimeve bankare Republikës në lidhje me Veprimin, duke përfshirë në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje, kanë vepruar dhe veprojnë si një kontraktor i pavarur dhe jo në mirëbesim në ndonjë pozicion më të lartë besimi dhe Republika nuk synon që Joint Lead Managers të veprojnë në një cilësi të ndryshme nga ajo e kontraktorit të pavarur. Në dhënien e Shërbimeve, Joint Lead Managers do të veprojnë vetëm në pajtim me raportin kontraktual me Republikën dhe me bazë të afërt në lidhje me Veprimin (duke përfshirë në lidhje me përcaktimin e termave të Notave).

Joint Lead Managers apo anëtarët e Grupit përkatës nuk kanë asnjë detyrim në lidhje me shërbimet ose këshillimin e dhënë Republikës nga persona të ndryshëm nga ata vetë. Megjithatë Joint Lead Managers apo anëtarët të Grupit përkatës do të kenë të drejtë të mbështeten mbi këshillimin ose informacionin e deklaruar nga këshilltarët e Republikës ose që ofrohet publikisht pa pasur asnjë përgjegjësi për të verifikuar këshillimin ose informacionin. Çdo rishikim nga Joint Lead Managers i Veprimit, termave të Notave dhe çështje të tjera në lidhje me të do të kryhet vetëm në përfitim të Joint Lead Managers dhe nuk është në emër të Republikës apo një personi tjetër.

Republika bie dakord t'u ofrojë Joint Lead Managers dhe këshilltarëve të tyre profesionalë të gjithë informacionin dhe të dhënat në lidhje me Republikën dhe subjekteve të varur prej saj dhe kontaktin me drejtorët dhe menaxhimin dhe auditët dhe këshilltarët e Republikës dhe subjekteve të varur prej saj që çdo Joint Lead Manager mund të konsiderojë të përshtatshëm ose të nevojshëm për të kryer Veprimin ose që është i rëndësishëm për Republikën në lidhje me këtë.

Republika merr përsipër para çdo Joint Lead Manager që, sipas njohurive dhe besimit të saj më të mirë, (a) i gjithë informacioni i ofruar tek një Joint Lead Manager prej saj ose një prej agjentëve ose këshilltarëve të saj në lidhje me Veprimin, i marrë si i tërë, është dhe do të mbetet i saktë dhe i plotë në të gjitha aspektet materiale dhe kjo nuk përmban ndonjë deklarim të gabuar dhe nuk lë pa përmendur ndonjë fakt që e bën ndonjë nga deklarimet që gjendet në këtë informacion të gabuar në të gjitha aspektet materiale dhe (b) të gjitha projeksionet e ofruara tek një Joint Lead Manager prej saj ose një prej agjentëve ose këshilltarëve të saj janë përgatitur ose do të përgatiten në mirëbesim dhe bazuar në prezumimin që Republika beson se është i arsyeshëm.

Republika do të jetë e vetme përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e informacionit që gjendet në një prospekt ose dokumente të tjera deklarimi, përveç informacionit të dhënë nga Joint Lead Manager (që

kuptohet që i vetmi informacion i dhënë nga një Joint Lead Manager do të përbëhet nga emrat ligjore dhe të reklamës).

Nëse Joint Lead Managers dhe Republika duan të angazhojnë bashkëmenaxherë në lidhje me Veprimin, Joint Lead Managers dhe Republika mund ta bëjë këtë secili, duke iu nënshtruar marrjes së pëlqimit verbal nga tjetri. Nuk jepen tituj apo role ose kompensim në lidhje me Veprimin pa pëlqimin e Joint Lead Managers.

Alokimi i çdo Note në pajtim me Veprimin është në diskrecionin e vetëm të Joint Lead Managers, por me pëlqimin verbal të Republikës.

Secili Joint Lead Manager është autorizuar nga Republika, në masën që ky Joint Lead Manager e gjykon të përshtatshëm, t'i delegojë çdo funksion ose përgjegjësi çdo anëtari tjetër të Grupit përkatës ose çdo agjenti të aprovuar më parë nga Republika, me kusht që ky delegim të mos ndikojë në detyrimet e këtij Joint Lead Manager për të cilat ai mbetet kryesisht përgjegjës. Secili Joint Lead Manager mund të angazhojë këshilltarë profesionistë për të asistuar në lidhje me Shërbimet dhe Veprimin.

Në rastin e përfundimit të Veprimit, secili Joint Lead Manager ka të drejtën, me shpenzimet e veta të deklarojë pjesëmarrjen e tij në Veprim, duke përfshirë, pa kufizim, vendosjen e reklamave përfundimtare në gazetat dhe revistat financiare ose të tjera.

Republika bie dakord që kjo letër është për përdorim konfidencial dhe, pa pëlqimin paraprak të Joint Lead Managers, nuk deklarohet nga Republika ndaj asnjë personi i ndryshëm nga (a) këshilltarët, drejtorët, punonjësit, shërbëtorët, të punësuarit ose agjentët që duhet ta marrin dhe shqyrtojnë atë për qëllimet e Veprimit dhe (b) siç kërkohet nga ligji ose nga një agjenci rregullatore, qeveritare ose tjetër kompetente apo autoritet i një juridiksioni ose në zbatim të një gjykimi.

6. KONFIDENCIALITETI

Secila palë në këtë Marrëveshje bie dakord të mbajë termat e emetimit të parashikuara të Notave konfidenciale, përveç kur palët e tjera bien dakord për deklarimin e informacionit. Në masën që një palë i ofron tjetrës informacion jo-publik të përcaktuar me shkrim si konfidencial, pala që merr këtë informacion bie dakord që do ta përdorë këtë informacion vetëm për qëllimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe nuk do të deklarojë ndonjë informacion të tillë pa pëlqimin e palës që jep këtë informacion përveç se agjencive të vlerësimit (sipas rastit), (dhe në rastin e secilit Joint Lead Manager, çdo anëtari tjetër të Grupit përkatës) këshilltarëve profesionistë, drejtorëve, punonjësve, shërbyesve, të punësuarve dhe agjentëve qe u duhet ta marrin dhe shqyrtojnë këtë informacion për qëllimin e Veprimit dhe, në rastin e secilit Joint Lead Manager, blerësve ose blerësve potencialë të Notave.

Detyrimet e konfidencialitetit të parashikuara në këtë Dispozitë 6 (Konfidencialieti) nuk shtrihen mbi informacionin që:

a) Është bere ose behet publik ose ofrohet për palën që e merr informacionin mbi një bazë jo-konfidenciale;

b) Kërkohet të deklarohet me ligj ose me agjenci rregullatore, qeveritare ose autoritet tjetër kompetent në një juridiksion ose në pajtim me një proces gjyqësor; ose

c) Kërkohet në përgatitje të prospektit ose dokumentit tjetër të deklarimit ose në shpërndarjen e Notave.

Pavarësisht nënklauzolës 11.1 (Përfundimi), detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në këtë klauzolë 6 (konfidencialiteti) do të përfundojnë në përvjetorin e dytë të datës së kësaj Marrëveshjeje.

7. KONFLIKTI I INTERESIT

Secili Joint Lead Manager është pjesë e Grupit përkatës. Aktivitetet përkatëse të investimeve të kryera nga Deutsche Bank, JPM dhe anëtarë të tjerë të Grupit të tyre përkatës përfshijnë financën e shoqërisë (duke përfshirë emetimet e reja,bashkimet dhe përftimet), financën bankare dhe të strukturuar, shitjet dhe tregtimin e titujve dhe borxhin (duke përfshirë derivatet) dhe kërkimin përkatës; shërbimet mbrojtëse, menaxhim i pronës, menaxhim i sendeve pasurore, kapitalin e zhvillimit dhe aktivitetet përkatëse.

Kur secili Joint Lead Manager përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, ky Joint Lead Manager, çdo anëtar tjetër i Grupit përkatës, ose një person tjetër në lidhje me këtë Joint Lead Manager mund të ketë një interes, marrëdhënie apo masë që është thelbësore ose mund të konfliktojë me këto detyrime. Asnjë Joint Lead Manager-i dhe asnjë anëtari tjetër i këtij Grupi përkatës nuk i kërkohet të deklarojë këtë interes, marrëdhënie, ose masë ndaj Republikës ose të japë llogari, deklarojë ndonjë fitim, honorar, komision apo shpërblim tjetër që rrjedh nga ky interes, marrëdhënie apo masë.

Secili Joint Lead Manager dhe çdo anëtar tjetër i Grupit përkatës, mund të vazhdojë të ndjekë interesat dhe aktivitetet e tij dhe të tyre të punës pa deklarim paraprak specifik ndaj Republikës. Asnjë në

këtë Marrëveshje nuk pengon një Joint Lead Manager dhe çdo anëtar tjetër i Grupit përkatës, nga ndjekja e interesave ekzistues ose të ardhshëm të tij ose të tyre ose të klientëve të tij apo të tyre.

8. EKSKLUZIVITETI

8.1 Marrëveshja e ekskluzivitetit

Republika bie dakord që Joint Lead Managers do të jenë të vetmet palë të përfshira për të përmbushur Shërbimet ose Realizuar Veprimin ose Rihapjen ose çdo propozim të ngjashëm me Veprimin dhe Republika nuk mban apo angazhon palë të tjera të ndryshme nga Joint Lead Managers ose ndryshe te japë një mandat me qëllimin e realizimit të shërbimeve ose Veprimit ose ndonjë propozim të ngjashëm me Veprimin, apo ndryshe që merr borxh në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, pa marrë pëlqimin me shkrim paraprak të Joint Lead Managers.

8.2 Përfundimi i Marrëveshjes së ekskluzivitetit

Në pajtim me nënklauzolën 11.2 (Mbetja në Fuqi), Klauzola 8.1 (Marrëveshja e ekskluzivitetit) përfundon së qeni në fuqi me zhvillimin e një prej ngjarjeve të mëposhtme, cilado që të ndodhë e para:

a) Mbyllja e emetimit të borxhit me shumë subjekte në tregjet ndërkombëtare të kapitalit nga Republika në lidhje me të cilën Joint Lead Managers janë depozituesit e përbashkët dhe menaxherë të përbashkët drejtimi; ose

b) Riimbursimi i secilit Joint Lead Manager nga Republika për të gjitha kostot dhe shpenzimet të përcaktuara në klauzolën 4.2 (Tarifat dhe shpenzimet) më sipër, deri në një shumë prej eur 300,000.00.

Klauzola 8.1 (Marrëveshja e ekskluzivitetit) në lidhje me rihapjen përfundon së qeni në fuqi më 31 dhjetor 2010.

8.3 Treg i pastër

Republika bie dakord që, gjatë periudhës së angazhimit të Joint Lead Managers dhe që përfundon me pushimin e fuqisë së këtij angazhimi apo, nëse emetohen Notat, 30 ditë kalendarike pas emetimit të Notave, as Republika dhe as ndonjë subjekt i varur nga Republika nuk emetojnë tituj ose ofrojnë tituj për publikun ose në një vendosje private në:

a) tregjet ndërkombëtare të kapitalit jashtë Republikës së Shqipërisë pa pëlqim me shkrim të Joint Lead Managers; ose

b) tregjet e brendshme të kapitalit në Shqipëri pa konsultim paraprak me Joint Lead Managers.

9. SHPALLJE

Republika merr përsipër që:

a) Të gjitha shpalljet dhe dokumentet e publikuara ose deklarimet e bëra prej saj ose në emër të saj gjatë ose në lidhje me emetimin e Notave do të bëhet në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në një juridiksion përkatës duke përfshirë kufizimet përkatëse të shitjes në lidhje me Notat, do të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm për të arritur këtë përputhje (duke përfshirë atë informacion që kërkohet nga rregullat e bursës (sipas rastit) mbi të cilin Notat janë ose do të listohen), do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale dhe nuk do të jenë të gabuara, dhe do të publikohen ose bëhen vetëm pas konsultimit me Joint Lead Managers;

b) Çdo shpallje madhore strategjike e publikuar ose e bërë do të publikohet dhe bëhet në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në një juridiksion përkatës duke përfshirë kufizimet përkatëse të shitjes në lidhje me Notat, dhe nuk do publikohet ose bëhet pa pëlqimin paraprak të Joint Lead Managers (dhe ky pëlqim nuk duhet të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme), përveç kur kërkohet me ligj; dhe

c) Ajo nuk do t'i referohet emrit të ndonjë prej Joint Lead Managers ose ndonjë anëtari të Grupit përkatës në asnjë raport, dokument, njoftim për shtyp, deklarim publik, prospekt ose komunikim tjetër nga Republika pa pëlqimin paraprak me shkrim të Joint Lead Managers.

10. ZHDËMTIMI DHE LIRIMI

Republika zhdëmton secilin prej Joint Lead Managers, secilin anëtar të Grupit përkatës të Joint Lead Managers dhe secilin prej drejtorëve, punonjësve, të punësuarve dhe agjentëve përkatës (së bashku, "Personat e Zhdëmtuar" dhe secili, një "Person i Zhdëmtuar") kundrejt dhe në çdo kohë i ruan personat e Zhdëmtuar ndaj çdo veprimi, pretendimi, kërkese, gjykimi dhe vendimi ("Pretendime") që mund të fillohen, bëhet ose pretendohet kundër një Personi të Zhdëmtuar dhe të gjitha detyrimet, humbjet, dëmet, kostot, detyrimet dhe shpenzimet (duke përfshirë koston dhe shpenzimet ligjore) ("Kostot") që mund të pësohen ose shkaktohen nga një Person i Zhdëmtuar në cilindo juridiksion që ka të bëjë me ose lind drejtpërdrejt ose jo nga angazhimi i Joint Lead Managers në bazë të kësaj Marrëveshje.

Ky zhdëmtim shtrihet mbi koston e hetimit, përgatitjes ose mbrojtjes së çdo Pretendimi (qoftë faktik, i filluar, i kërcënuar apo potencial) pavarësisht nëse Personi i Zhdëmtuar është palë në ato Pretendime.

Republika bie dakord gjithashtu që Person i Zhdëmtuar nuk do të jetë i detyruar (qoftë drejtpërdrejt ose jo, në kontratë, shkaktim dëmi apo ndryshe) kundrejt Republikës apo shoqërive aksionare, degëve, filialeve apo nën-filialeve të këtyre shoqërive, ose drejtorëve, punonjësve, të punësuarve dhe agjentëve për ose në lidhje me angazhimin e Joint Lead Managers në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me Veprimin, përveçse në masën që ky detyrim rrjedh nga rastet e mosplotësimit të detyrimeve, neglizhencë e hapur e Joint Lead Managers.

Zhdëmtimi i parashikuar në klauzolën 10 (Zhdëmtimi dhe Lirimi) shtrihet në masën më të madhe të lejuar me ligj dhe përveç kësaj është për të gjitha të drejtat që një Person i zhdëmtuar mund të ketë në bazë të common law ose ndryshe (duke përfshirë, por pa u kufizuar në të drejtën e kontributit). Zhdëmtimi i parashikuara në klauzolën 10 (Zhdëmtimi dhe Lirimi) mbetet në fuqi pavarësisht përfundimit (për çfarëdo lloj shkaku) të kësaj Marrëveshjeje.

11. PËRFUNDIMI DHE MBETJA NË FUQI

11.1. Përfundimi

Kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi jo më parë se (i) emetimi i Notave, ose (ii) marrja nga Joint Lead Managers e njoftimit me shkrim nga Republika që përfundon këtë Marrëveshje, ose (iii) marrja nga Republika e njoftimit me shkrim nga Joint Lead Managers që prish këtë Marrëveshje.

11.2 Mbetja në Fuqi

Çdo përfundim i kësaj Marrëveshje nuk cenon të drejtat e ligjshme ose detyrimet që mund të kenë lindur. Klauzola 4 (Tarifat dhe Shpenzimet), Klauzola 5 (Roli i Joint Lead Managers), nënklauzola 8.2 (Përfundimi i Marrëveshjes së Ekskluzivitetit) nënklauzola 8.3 (Treg i Pastër), Klauzola 10 (Zhdëmtimi dhe Lirimi), kjo Klauzolë 11 (Përfundimi dhe Mbetja në Fuqi), Klauzola 12 (Mungesa e Detyrimit), Klauzola 15 (Të Drejtat e Palëve të Treta) dhe Klauzola 17 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) vazhdojnë të zbatohen pavarësisht përfundimit së kësaj Marrëveshjeje. Pavarësisht nënklauzolës 11.1 (Përfundimi), detyrimet e konfidencialitetit të parashikuara në Klauzolën 6 (Konfidencialiteti) përfundojnë në pajtim me dispozitat e kësaj Klauzole 6.

Nëse kjo Marrëveshje përfundohet në pajtim me nënklauzolën 11.1 (Përfundimi) jo pas emetimit të Notave, *nënklauzola* 8.1 (Marrëveshja e Ekskluzivitetit) mbetet në fuqi pas përfundimit dhe pushon së qeni në fuqi në pajtim me nënklauzolën 8.2 (Përfundimi i Marrëveshjes së Ekskluzivitetit), përndryshe *nënklauzolë* 8.1 (Marrëveshja e Ekskluzivitetit) pushon së qeni në fuqi në pajtim me *nënklauzolën* 11.1 (Përfundimi).

12. MUNGESA E DETYRIMIT

Republika njeh që nëse Joint Lead Managers do të nënshkruanin Notat ose jepnin financim për Republikën ose një personi tjetër apo subjekt, termat e këtyre veprimeve do t'u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta ndërmjet Republikës, Joint Lead Managers dhe/ose një personi apo subjekti tjetër. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si detyrim nga ana e Joint Lead Managers ose një anëtari të Grupit përkatës për të hyrë në një veprim këmbimi, investimi apo garancie apo për të dhënë financim për Republikën ose një person tjetër apo subjekt për të nënshkruar Notat. Secili prej Joint Lead Managers dhe Republika, në gjykimin dhe diskrecionin e tyre të vetëm, përcaktojnë në çdo kohë për të mos vazhduar me veprimin.

13. NJOFTIMET

Një njoftim ose komunikim tjetër në bazë të kësaj Marrëveshjeje (i) është në fuqi vetëm nëse është me shkrim dhe nëse dërgohet në adresën e palës përkatëse të përcaktuar në letrën përcjellëse të kësaj letre ose tek një adresë tjetër që një palë u bën të ditur të tjerave me shkrim herë pas here, (ii) është në fuqi vetëm kur merret, dhe (iii) nëse merret jashtë orëve të punës (që janë 9 00 paradite deri 5 00 pasdite) në ditën e punës së Londrës), konsiderohet të mos jetë marrë deri në fillimin e periudhës tjetër të orëve të punës.

14. MARRËVESHJA E PLOTË

Kjo Marrëveshje përbën të gjithë dhe të vetmen marrëveshje ndërmjet Republikës dhe Joint Lead Managers në lidhje me shërbimet dhe mbizotëron dhe shfuqizon të gjitha projektet e mëparshme, marrëveshjet, detyrimet, përfaqësimet, garancitë, premtimet, garancitë dhe masat e çdo natyre qofshin, me shkrim apo jo, në lidhje me të ("Deklarimi Parakontraktual"). Secila Palë në këtë Marrëveshje njeh që lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk mbështetet në ndonjë Deklaratë Parakontraktuale që nuk është e parashikuar në këtë Marrëveshje. Asnjë palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtën e padisë palën tjetër në këtë Marrëveshje që rrjedh nga ose në lidhje me një Deklaratë Parakontraktuale, përveçse në rastin e mashtrimit ose në masën e përsëritur në këtë Marrëveshje.

15. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA

Klauzola 7 (Konflikti i interesit) i jep një përfitim çdo anëtari të Grupit përkatës të secilit Joint Lead Manager dhe Klauzola 10 (Zhdëmtimi dhe Lirimi) i jep një përfitim çdo Personi të Zhdëmtuar (të ndryshëm nga Joint Lead Managers, secili "Përfitues si Palë e Tretë") dhe për Përfituesin si Palë e Tretë merret pëlqimi paraprak me shkrim i Joint Lead Managers, synohen të jenë të ekzekutueshme nga secili prej Përfituesve si Palë e Tretë në sajë të Ligjit të Kontratave (Te drejtat e palëve të treta) të vitit 1999. Në pajtim me dispozitat e mësipërme të kësaj Klauzole 15 (Të drejtat e Palëve të Treta), palët në këtë Marrëveshje nuk synojnë që ndonjë term i kësaj Marrëveshjeje të jetë i ekzekutueshëm në sajë të Ligjit të Kontratave (Te drejtat e palëve të treta) të vitit 1999 nga që person që nuk është palë në këtë Marrëveshje por kjo nuk cenon asnjë të drejtë ose mjet të palëve të treta që ekziston përveç këtij ligji. Pavarësisht nga sa më sipër, dispozitat e kësaj Klauzole 15 (Të drejtat e Palëve të Treta), kjo Marrëveshje mund të prishet ose ndryshohet dhe çdo term i kësaj Marrëveshjeje mund të hiqet në çdo mënyrë dhe çdo kohë nga palët në Marrëveshje, pa pëlqimin e Përfituesve si Palë e Tretë.

16. DISPOZITA TË NDRYSHME

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet përveç se me shkrim nga të gjitha palët. Kjo marrëveshje është detyruese dhe ekziston në interes të çdo pale ne këtë Marrëveshje dhe trashëgimtarëve ose të caktuarve të tyre. Një palë në këtë Marrëveshje nuk mund të cedojë ose transferojë ose synojë cedimin apo transferimin e një të drejte apo detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje përveç se me pëlqimin me shkrim paraprak të të gjithë palëve të tjera në këtë Marrëveshje, me kusht që çdo Joint Lead Manager mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij tek një anëtar tjetër i Grupit përkatës. Çdo anëtar tjetër i Grupit të Joint Lead Managers ka të drejtën për të përfituar dhe t'u nënshtrohet termave të kësaj letre. Pavlefshmëria, paligjshmëria dhe mosekzekutueshmëria e një dispozite të kësaj Marrëveshjeje nuk cenon apo ndikon në vazhdimësinë në fuqi të pjesës tjetër të kësaj dispozite apo pjesës tjetër të Marrëveshjes. Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje përfaqëson që kjo Marrëveshje është autorizuar si duhet prej saj dhe secila palë merr përsipër t'i japë palës tjetër një kopje të këtij autorizimi me kërkesë. Referencat në këtë Marrëveshje tek klauzolat, nënklauzolat dhe paragrafët janë tek klauzolat, nënklauzolat dhe paragrafët e kësaj Marrëveshjeje, përveç kur përcaktohet ndryshe.

17. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

17.1 Ligji i zbatuar

Marrëveshja dhe çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

17.2 Arbitrazhi

Në pajtim me nënklauzolën 17.3 (Gjykatat), çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me detyrimet jo-kontraktuale që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje) referohet dhe zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi sipas Rregullave të Arbitrazhit ("Rregullat") të Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar ("LCIA"), ku rregullat e të cilit konsiderohen të përfshira me referencë në këtë nënklauzolë 17.2 (Arbitrazhi). Numri i arbitrave është tre, secili prej të cilëve nuk ka interes në çështje, nuk ka lidhje me ndonjë palë në Marrëveshje dhe është një jurist me eksperiencë në veprimet financiare ndërkombëtare. Joint Lead Managers dhe Republika caktojnë një arbitër dhe të dy arbitrat së bashku caktojnë një arbitër tjetër që do të jetë kryetar i gjykatës së arbitrazhit. Në rastin kur Joint Lead Managers dhe Republika apo dy arbitrat e parë nuk mundin të caktojnë një arbitër ose arbitrin e tretë brenda afateve kohore që caktohet në Rregullat, ky arbitër caktohet menjëherë nga LCIA. Selia e arbitrazhit është Londra, Angli, dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Gjykata e arbitrazhit nuk do të ketë kompetencë të japë vendim dënimi ose dënim për dëmet.

17.3 Gjykatat

Para se Joint Lead Managers të kenë caktuar arbitrin e tyre, secili prej Joint Lead Managers mund të kërkojë me kërkesë me shkrim drejtuar Republikës që të gjitha mosmarrëveshjet ose një mosmarrëveshje specifike të dëgjohet nga gjykatat e Anglisë, dhe në këtë rast gjykata e arbitrazhit nuk ka juridiksion në lidhje me këtë apo këto mosmarrëveshje. Në rastin kur një prej Joint Lead Managers dorëzon një njoftim në pajtim me këtë nënklauzolë 17.3 (Gjykatat), Republika bie dakord që gjykatat angleze do të kenë juridiksion ekskluziv për ta zgjidhur këtë mosmarrëveshje ose këto mosmarrëveshje dhe ia paraqet juridiksionit ekskluziv të gjykatave angleze në lidhje me këtë Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet që lindin nga ose në lidhje me të dhe heq dorë nga kundërshtimi për gjykatat angleze mbi shkakun e forumit të papërshtatshëm ose ndryshe në lidhje me gjykimet në lidhje me këtë Marrëveshje.

17.4 Ekzekutimi

Secila palë e kësaj Marrëveshjeje bie dakord që një vendim arbitrazhi apo vendim ose urdhër i gjykatës angleze në lidhje me këtë Marrëveshje është përfundimtare dhe detyruese për të dhe mund të

ekzekutohet prej saj nga gjykatat e çdo juridiksioni kompetent.

18. KOPJET

Kjo Marrëveshje mund të realizohet në kopje të ndryshme, secila prej të cilave e realizuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinale, dhe të gjitha të marra së bashku përbëjnë të njëjtën marrëveshje. Dorëzimi i një kopjeje të nënshkruar të një faqeje të kundërfirmosur të kësaj Marrëveshjeje me faks ka fuqi të njëjtë me një kopje të nënshkruar me dorë të kësaj Marrëveshjeje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Republikës për termat e kësaj Marrëveshjeje duke nënshkruar dhe na kthyer dublikatën e kësaj letre.

Juaji sinqerisht,

Për dhe në emër të Deutsche Bank AG, London Branch

Nga:_____	Nga:_____
Emri:	Emri:
Titulli:	Titulli:

Për dhe në emër të J.P. Morgan Securities Ltd.

Nga:_____
Emri:
Titulli:

Republika bie dakord me termat e kësaj Marrëveshjeje të përcaktuara në këtë letër nga Joint Lead Managers, datë 2 Mars 2010.

Republika e Shqipërisë

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga:_____	Nga:_____
Emri:	Emri:
Titulli:	Titulli:
Datë:	

ANEKS 1

Terma indikativë të emetimit të notave

Emetuesi:	Republika e Shqipërisë
Joint Lead Managers	Deutsche Bank AG, Dega e Londres; J.P. Morgan Securities Ltd
Formati:	Bond “Stand Alone”
Kuponi:	Për t’u përcaktuar
Maturiteti:	3 ose 5 vjet
Monedha:	EUR
Norma ne maturim:	Për t’u përcaktuar
Shuma: Minimumi	300 mil. EUR
Dokumentacioni:	Dokumentacioni i zakonshëm i Euromarket qe përfshin forcën madhore, barrën negative (ose kushti i mbulimit te barabarte), dështimin dhe kushtet e shlyerjes
Statusi i borxhit:	Senior i Pasiguruar-Pari passu
Ligji i zbatuar:	Anglez
Listimi:	Tregu i rregulluar në EEA
Forma:	Për t’u përcaktuar
Prerja:	50 000 EUR
Klerimi dhe shlyerja:	Notat do te klerohen nëpërmjet Euroclear dhe Clearstream Banking, Luksemburg

ÇMIMI TREGUES

Ministria e Financave e Republikës se Shqipërisë

Përgatitur nga Deutsche Bank dhe JP Morgan

30 mars 2010

z. Xhentil Demiraj
Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit te Borxhit
Ministria e Financave e Shqipërisë

I nderuar z. Demiraj,

RE: Çmimi tregues për Eurobondin që Shqipëria parashikon të emetojë

Sipas kërkesës tuaj, Deutsche Bank dhe JP Morgan kane kënaqësinë te paraqesin ne vijim nivelet e referencave si dhe çmimin tregues për Eurobondin e Shqipërisë qe parashikohet te emetohet:

Çmimi Tregues	
Huamarrës	Republika e Shqipërisë
Vlera e riskut, e supozuar:	B1 Moody's dhe [vjen me vone] nga S&P
Klasifikimi:	Senior, i pasiguruar
Dokumentet:	Dokumentacion "Reg. S Stand-alone"
Formati:	Norme fikse
Maturimi:	5 vjet
Shuma e synuar për emetim:	400 milion EURO
Frekuenca e Kuponit:	Vjetor
Norma e indeksit Mid-swap":	2.42 % (5vjet)
Marzhi mbi indeksin "mid-swaps"	508 pike përqindje baze
Norma e plotë e interesit	7.50%

Ne shpresojmë t'i jemi përgjigjur gjithë kërkesave tuaja ne treguesit e mësipërm. Gjithsesi nëse ju keni pyetje te tjera ose kërkoni informacion shtese ju lutem mos hezitoni te na kontaktoni.

Përshëndetjet më të mira

Ekipet Deutsche Bank dhe JP Morgan

Data e projektit: 13 prill 2010

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EURO [•]
[•] PËR QIND. NOTA[2] TË KËRKUESHME [•]
MARRËVESHJE NENSHKRIMI

KJO MARRËVESHJE është bërë më [•] 2010

_____

NDËRMJET

1. REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PERFAQESUAR NGA KESHILLI I MINISTRAVE QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE ("Emetuesi");

2. DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH dhe J.P. MORGAN SECURITIES LTD. (së bashku, "Joint Lead Managers"); dhe

3. [•] (së bashku me Joint Lead Managers, "Menaxherët").

NDËRSA

A) Se Emetuesi ka autorizuar krijimin dhe emetimin e euro [•] në një shumë të përgjithshme principali prej [•] për qind të notave të kërkueshme [•] ("Notat").

B) Notat do të jenë në formën e prurësit në prerje prej euro [50,000 dhe shumëfishat integralë të 1,000 euro mbi këtë shumë deri në dhe duke përfshirë 99,000 euro. Asnjë Notë në një formë Definitive nuk do të emetohet me një vlerë mbi €99,000]. Notat do të jenë fillimisht në formën e një note të përkohshme globale ("Nota e Përkohshme Globale"), interesa në të cilat do të jenë të këmbyeshme për interesa në një notë të përhershme globale ("Nota e Përhershme Globale") në rrethanat e përcaktuara në Notën e Përkohshme Globale. Për rrjedhojë, Nota e Përhershme Globale do të jetë e këmbyeshme për notat definitive ("Nota definitive"), me kupona interesi ("Kuponat") bashkëlidhur, vetëm në disa rrethana të kufizuara të përcaktuara në Notën e Përhershme Globale.

C) Emetuesi, në lidhje me Notat e përfaqësuara në atë masë nga Notat e Përhershme Globale, do të hyjë në një aktmarrëveshje ("Aktmarrëveshje"), një projekt i së cilës është në formën e miratuar.

D) Emetuesi, në lidhje me Notat do të lidhë një marrëveshje agjencie fiskale (“Marrëveshja e Agjencisë”) me [Deutsche Bank AG, Dega e Londrës] ("Agjenti Fiskal") dhe agjentët e tjerë pagues të përmendur në të.

Është rënë dakord si më poshtë:

1. Interpretimi

1.1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

"Clearstream, Luksemburg" nënkupton Clearstream Banking, shoqëri anonime, Luksemburg;

"Data e Mbylljes" është në pajtim me klauzolën 8.2 (mbyllja e shtyrë), [•] 2010;

"Kushtet" nënkuptojnë Termat dhe Kushtet e Notave që përcaktohen në formën e rënë dakord të Marrëveshjes së Agjencisë dhe ndryshohen herë pas here para Datës së Mbylljes) dhe çdo referencë ndaj një "Kushti" të renditur është referencë ndaj dispozitës korresponduese të renditur të saj;

"€", "EURO" ose "Eurot" nënkupton monedhën e prezantuar në fillim të fazës së tretë të bashkimit

[2] Shenim i Perkthyesit: Termi “Nota” i referohet Instrumentit te Titullit te Borxhit

monetar dhe ekonomik europian dhe që përcaktohet në nenin 2 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 974/98 të 3 majit 1998 mbi prezantimin e euros, të ndryshuar;

"Euroclear" nënkupton Euroclear Bank SA/NV;

"Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve " është një nga ato rrethana që përshkruhet në Kushtin 8 (Raste të Mosplotësimit të Detyrimeve);

"FSA" është Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Mbretërisë së Bashkuar;

"FSMA" është Ligji i Shërbimeve Financiare dhe Tregjeve 2000;

"Prezantimet e Investitorit" është çdo material me shkrim i përdorur në lidhje me marketimin, paraqitjen dhe prezantimet e investitorit në lidhje me ofertën e Notave;

"Lëshimi i Dokumenteve" është Veprim i Njëanshëm dhe Marrëveshja e Agjencisë;

"Çmimi i Emetimit" është [•] për qind e shumës së plotë principale të Notave;

"Humbje" është çdo detyrim, dëm, humbje, shpenzim (duke përfshirë, pa kufizim, tarifat ligjore, koston dhe shpenzimet dhe çdo tatim mbi vlerën e shtuar në të);

"Person" është çdo individ, shoqëri, korporatë, firmë, partneritet, shoqëri e përbashkët, shoqatë, organizatë, shtet apo agjenci shtetërore ose entitet tjetër, me ose pa personalitet të veçantë ligjor;

"Prospekt paraprak" është prospekti paraprak i datës [•] 2010 i përgatitur në lidhje me emetimin e Notave, që mund të ndryshohet ose plotësohet herë pas here, me kusht që për qëllimet e klauzolës 3.3 (Përfaqësime të përsëritura) çdo ndryshim ose shtesë e tillë nuk merret parasysh përveç kur Joint Leed Managers (në emër të Menaxherëve) bien dakord shprehimisht ndryshe;

"Prospekt" është prospekti me date te njejte me daten e kesaj Marreveshjeje pergatitur ne lidhje me emetimin e Notave, i cili mund te ndryshohet ose plotesohet kohe pas kohe, duke vertetuar, se, per qëllime të klauzolës 3.3 (Zotime te perseritura) nje ndryshim ose plotesim i tille nuk do te merret parasysh, perderisa Joint Lead Managers (ne emer te Menaxherit) ne menyre te qarte do te bien dakord ndryshe;

"Direktiva e Prospektit" është Direktiva 2003/71/EC dhe perfshin masat perkatese zbatuese ne secilin vend anetar te Zones Ekonomike Europiane i cili ka zbatuar Direktiven e Prospektusit;

"Palët përkatëse" janë në lidhje me çdo person, çdo filial i atij personi ose punonjës, drejtor, i punësuar ose agjent i atij personi dhe çdo filial apo person nga i cili kontrollohet ndonjë prej tyre (nëse termat "filial" dhe "kontrolluar" kanë kuptimet që u janë dhënë në ligjin e titujve dhe rregulloret në bazë të tyre);

"Ligji i Titujve" është Ligji i Titujve të Shteteve të Bashkuara të vitit 1933; dhe

"Menaxher Stabilizues" është Deutsche Bank AG, Dega e Londrës.

1.2 Klauzolat dhe skedulet

Çdo referencë në këtë Marrëveshje tek një klauzolë, nënklauzolë ose skedul, nëse nuk deklarohet ndryshe, është një referencë tek një klauzolë, nënklauzolë ose skedul të bashkëlidhur.

1.3 Legjislacioni

Çdo referencë në këtë Marrëveshje tek një legjislacion (qoftë legjislacion parësor apo rregullore ose legjislacion dytësor tjetër i bërë në pajtim me legjislacionin parësor) interpretohet si një referencë e bërë tek ky legjislacion, siç mund të jetë ndryshuar ose rimiratuar herë pas here.

1.4 Titujt

Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e Marrëveshjes.

1.5 Forma e miratuar

Çdo referencë këtu tek një dokument që është në "formën e miratuar" do të thotë që dokumenti në fjalë është miratuar ndërmjet palëve të propozuara, në pajtim me çdo ndryshim që palët mund të bien dakord para Datës së Mbylljes.

2. EMETIMI I NOTAVE

2.1 Detyrimi për emetim

Emetuesi merr përsipër ndaj menaxherëve që:

2.1.1 Emetimi i Notave: në pajtim me dhe duke iu nënshtruar dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Notat do të emetohen në Datën e Mbylljes, në pajtim me këtë Marrëveshje dhe Marrëveshjen e Agjencisë; dhe

2.1.2 Lëshimi i dokumentacionit: do të nënshkruajë në ose para datës së mbylljes dokumentet e emetimit.

2.2 Marrja përsipër e abonimit

Menaxherët marrin përsipër kundrejt Emetuesit që në pajtim me dhe duke iu nënshtruar dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ata do të regjistrojnë Notat në Datën e Mbylljes me Çmimin e Emetimit. Detyrimet e menaxherëve në bazë të kësaj nëndispozite janë solidare dhe të veçanta.

2.3 Stabilizimi

Në lidhje me emetimin e Notave, Menaxheri Stabilizues (ose personat që veprojnë në emër të Menaxherit Stabilizues) caktojë më shumë Nota për të realizuar veprimet me qëllim të mbështetjes së çmimit të Notave në një nivel më të lartë se ai që mund të mbizotërojë ndryshe. Megjithatë, nuk ka garanci që Menaxheri Stabilizues (ose personat që veprojnë në emër të Menaxherit Stabilizues) do të ndërmarrin veprim stabilizues. Çdo veprim stabilizues mund të fillojë në ose pas datës në të cilën është bërë deklarimi i përshtatshëm publik i termave të Notave dhe, nëse fillon, mund të mbarojë në çdo kohë, por nuk duhet të mbarojë më vonë se 30 ditë pas datës së emetimit të Notave dhe 60 ditë pas datës së caktimit të Notave. Ky stabilizim realizohet në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Çdo humbje ose fitim i realizuar si pasojë e mbicaktimi apo stabilizimi është në llogari të Menaxherit Stabilizues. Menaxherët njohin që Emetuesi nuk ka autorizuar krijimin dhe emetimin e Notave tej EUR [•] shumës së plotë principale.

2.4 Riofrimi i çmimit të fiksuar

Çdo Menaxher përfaqëson, garanton dhe bie dakord që para se të njoftohet nga Joint Lead Menaxherët që Notat janë të lira për t'u tregtuar, ai nuk ka ofruar apo shitur dhe nuk do të ofrojë dhe shesë (dhe ka marrë masat dhe do të marrë masat që asnjë prej filialeve të tij nuk do të ofrojë ose shesë) ndonjë Notë me një çmim më të ulët se çmimi i ofruar nga Joint Lead menaxherët.

2.5 Marrëveshja ndërmjet Menaxherëve

Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të të gjithë palëve do të përbëjë pranim nga secili Menaxher i Marrëveshjes së IPMA-së ndërmjet Menaxherëve Versioni 1 në pajtim me çdo ndryshim të njoftuar për këtë Menaxher me shkrim në një periudhë para marrjes nga [Deutsche Bank AG, Dega e Londrës] e dokumentit që emëron nënshkruesin e autorizuar të Menaxherit dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË NGA EMETUESI

3.1 Përfaqësimet e Emetuesit

Emetuesi përfaqëson dhe garanton ndaj Menaxherëve që:

3.1.1 Autorizimi: Emetuesi ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të aprovuar dhe autorizuar krijimin, emetimin dhe shitjen e Notave, nënshkrimin e Marrëveshjes dhe Dokumentet e Emetimit dhe kryerjen dhe përmbushjen e detyrimeve që parashikohen të përmbushen këtu dhe atje:

3.1.2 Moskryerja e shkeljes: krijimi, emetimi dhe shitja e Notave, nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të emetimit dhe përmbushja dhe realizimi nga Emetuesi i detyrimeve të parashikuara për t'u përmbushur këtu dhe atje nuk do të jenë të kundërshtim ose të rezultojnë në shkeljen ose qenien në vonesë në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, një dispozite kushtetuese, ose një dispozite të një traktati, konvente, statute, ligji, rregulloreje, dekreti vendimi gjykate apo autoriteti të ngjashëm që është detyrues për emetuesin dhe çdo marrëveshje apo instrument që ajo është palë ose detyrohet në lidhje me borxhin në lidhje me të cilin është garantues;

3.1.3 Legjitime, e vlefshme, detyruese ose e ekzekutueshme: kjo Marrëveshje përbën, dhe pas nënshkrimit të rregullt në emër të emetuesit dhe (në rastin e Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale dhe Notave Definitive) certifikimit dhe dorëzimit të rregullt, dokumentet e emetimit, Nota e Përkohshme Globale, Nota e Përhershme Globale dhe çdo Notë tjetër Definitive do të përbëjë detyrim të ligjshëm, të vlefshëm, detyrues dhe të ekzekutueshëm për Emetuesin;

3.1.4 Interpretimi i kufizimeve te borxhit: kufizimet e vendosura nga neni 58 i ligjit nr.9963, datë 26 qershor 2008 mbi "Menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" lidhur me borxhin e pergjithshem, nuk shkelin ne asnje menyre mbi ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe natyrën detyruese te detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë ne kete Marreveshje, Dokumentet e Leshimit ose Notat, pavaresisht nese ndonje pale e ketyre marreveshjeve ka njohuri aktuale ose konstruktive te permbushjes nga Republika e Shqiperise te limiteve te percaktuara në këtë ligj;

3.1.5 Zbatimi i kufizimeve te borxhit: Nen ligjin aktual shqiptar, borxhi i pergjitshem i perfaqesuar nga keto Nota, i mbledhur me borxhin e pergjithshem te Republikes se Shqiperise nuk do te kaloje ne asnje moment ndonje kufizim te vendosur nga ligjet shqiptare perfshire, pa kufizim: a) kufirin e pergjithshem te borxhit te percaktuar ne nenin 58 te ligjit nr.9963, date 26 qershor 2008 mbi "Menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", ose b) shumen prej 60 per qind te produktit te brendshem bruto te Republikes se Shqiperise dhe do te behen te gjithe hetimet e duhura per te vertetuar kete dhe ne çdo rast, te gjitha detyrimet e emetuesit lidhur me Notat do te mbeten legjitime, te vlefshme, detyruese dhe te ekzekutueshme gjate gjithe jetes se Notave, pavaresisht ndonje ndryshimi qe mund te behet ne çdo kohe ne nivelin e borxhit te kontraktuar nga Republika e Shqipërisë;

3.1.6 Statusi: Notat do të përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe pa kusht të Emetuesi që (a) renditen pari passu ndërmjet tyre dhe (b) renditen gjithmonë të paktën pari passu me të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme të pasiguruara të emetuesit, përveç detyrimeve që mund të preferohen nga dispozitat e ligjit që janë detyrues dhe me zbatim të përgjithshëm;

3.1.7 Aprovimet: të gjitha autorizimet, pëlqimet dhe aprovimet qeveritare apo rregullatore ose kërkesa të tjera për sa i takon Emetuesit ose në lidhje me krijimin, emetimin ose shitjen e Notave, nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të Emetimit, përmbushjen nga Emetuesi të detyrimeve të shprehura për t'u përmbushur prej tij këtu ose atje, vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Emetimit ose Notave dhe shpërndarjes së Prospektit në lidhje me dispozitat e parashikuara në Grafik (ose, para Datës së Mbylljes) do të përftohen ose realizohen dhe janë (ose do të jenë në Datën e Mbylljes) në fuqi të plotë;

3.1.8 Tatimi: të gjitha pagesat e principalit dhe interesit në lidhje me Notat dhe Kuponat dhe të gjitha pagesat nga Emetuesi në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve te Emetimit, mund të jenë të lira dhe të pangarkuara, dhe pa mbajtur ose zbritur ndonjë tatim, detyrim, vlerësim ose detyrim qeveritar i cilësdo natyre e ngarkuar, vendosur, mbledhur, mbajtur ose vlerësuar nga ose brenda Republikës së Shqipërisë ose ndonjë nënndarjeje politike apo autoriteti të saj ose që kë pushtet mbi tatimet; Menaxherët nuk u nënshtrohen asnjë tatimi, detyrimi apo ngarkesave të tjera që caktohen nga Emetuesi ose një nënndarje politikë apo autoritet tatimor i tij vetëm për shkak të lidhjes së kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me krijimin, emetimin, dhënien ose transferimin e Notave sipas parashikimit të këtushëm;

3.1.9 Prospekti i Paraprak: Prospekti paraprak, në datën e emetimit të të gjithë informacionit që ekzistonte (në kontekstin e emetimit, oferimit dhe shitjes së Notave); në atë datë ai informacion ka qenë i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet materiale dhe nuk ka qenë i gabuar në asnjë aspekt material; çdo mendim, parashikim ose qëllim i shprehur në Prospektin Paraprak ka qenë në atë datë të konsideruar ndershmërisht dhe i saktë në çdo aspekt material; Prospekti Paraprak nuk ka lënë pa deklaruar ndonjë fakt material të nevojshëm për ta bërë këtë informacion, mendim, parashikim ose qëllim (në kontekstin e emetimit, ofrimit dhe shitjes së Notave) të pagabuar në çdo aspekt material; dhe të gjitha hetimet e tjera përkatëse u bënë për të konstatuar dhe verifikuar sa më sipër;

3.1.10 Prospekti: Prospekti përmban të gjithë informacionin që është (në kontekstin e emetimit, ofrimit dhe shitjes së Notave) material; ky informacion është i vërtetë dhe i saktë në aspektet materiale dhe nuk është i gabuar në aspektet materiale; çdo mendim, paramendim ose qëllim i shprehur me Prospekt konsiderohet dhe bëhet në mënyrë të ndershme dhe nuk është i gabuar në aspektin material; Prospekti nuk lë pa përmendur asnjë fakt material të nevojshëm për të bërë këtë informacion,mendim, paramendim apo qëllim (në kontekstin e emetimit, ofrimit dhe shitjes së Notave) jo të gabuar në asnjë aspekt material; dhe të gjitha hetimet e nevojshme janë bërë për të përcaktuar dhe verifikuar sa më sipër; dhe

3.1.11 Detyrimi i përgjithshëm i deklarimit: Prospekti përmban të gjithë informacionin që është i nevojshëm për të mundësuar investitorët për të bërë një vlerësim të informuar në lidhje kushtet (financiare, ekonomike ose politike) ose të çështjeve të përgjithshme të Emetuesit dhe të të drejtave qe u bashkëngjiten Notave;

3.1.12 Asnjë rast i mosplotësimit të detyrimeve: asnjë rast nuk ka ndodhur që është ose do të bëhej (me kalimin e kohës, dhënien e njoftimit ose bërjen e një përcaktimi) një Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve;

3.1.13 Mosgjykimi: nuk ka procedime qeveritare, ligjore apo të arbitrazhit (duke përfshirë çdo gjykim që ka filluar ose të mundshëm, për të cilin ka dijeni emetuesi) që mund të ketë ose mund të ketë patur gjatë 12 muajve para datës së Prospektit, një efekt të rëndësishëm mbi pozitën financiare të Emetuesit që është material në kontekstin e emetimit të Notave;

3.1.14 Mungesa e ndryshimeve materiale negative: që nga 31 dhjetor 2009 nuk ka ndryshim negativ ose ndonjë ndryshim që ka të bëjë me një ndryshim të mundshëm negativ në gjendjen financiare, politike ose ekonomike ose në punët e përgjithshme të emetuesit që është material në kontekstin e emetimit të Notave;

3.1.15 Ekzekutimi i vendimeve te arbitrazhit: në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë çdo vendim arbitrazhi kundër Republikës së Shqipërisë i dhene ne Mbreterine e Bashkuar në lidhje me këtë Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit ose Notat do të njihen dhe ekzekutohen ne Republikën e Shqipërisë ne perputhje me Konventen e New York te vitit 1958 mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve te Huaja te Arbitrazhit[1]

3.1.16 Mungesa e imunitetit: në çdo gjykim të filluar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me këtë Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit ose Notat, Emetuesi nuk ka të drejtë të pretendojë për veten e vet ose për ndonjë nga sendet e tij pasurore imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose proces tjetër i

ligjshëm- te ndryshme nga sa parashikohet ne Kushtet. Pasuria e Emetuesit që gjendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk gëzon, në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë asnjë të drejtë imuniteti nga padia, ekzekutimi, sekuestrua ose proces tjetër ligjor në lidhje me detyrimet e Emetuesit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Emetimit ose Notave. Në masën që një juridiksion në të cilin mund të fillojë gjykimi nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit ose Notat, emetuesit ose ndonjë prej pasurive të tij mund të jepet çdo e drejtë imuniteti (pavarësisht nëse pretendohet apo jo), heqja dorë nga imuniteti i parashikuar këtu, në Dokumentet e emetimit dhe Notat është detyrues për Emetuesin; nënshkrimi nga emetuesi i kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Emetimit dhe Notave përbën dhe në ushtrim të të drejtave dhe përmbushje të detyrimeve të tij përbën akte të përshtatshme për t'u shqyrtuar gjyqësisht në gjykatat me juridiksion kompetent dhe Republika e Shqipërisë nuk është në gjendje të pretendojë imunitet në lidhje me këto akte;

3.1.17 Njohja e ligjit anglez: zgjedhja e ligjit anglez si ligj rregullues të kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të emetimit dhe Notave është një zgjedhje e vlefshme e ligjit në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, do të zbatohej nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë nëse kjo Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit dhe çdo Notë tjetër ose pretendim i bërë në bazë të saj sillet para një gjykate mbështetur përkatësisht në dispozitat përkatëse të ligjit anglez dhe me kusht që këto dispozita të mos jenë në kundërshtim me politikën publike të Republikës së Shqipërisë; asnjë dispozitë në këtë Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit ose Notave nuk është në kundërshtim me politikën publike të Republikës së Shqipërisë;

3.1.18 Anëtarësia në FMN: Emetuesi është një anëtar dhe është i përshtatshëm për të përdorur mjetet e përgjithshme të Fondit Monetar ndërkombëtar ("FMN") dhe FMN-ja nuk ka kufizuar në pajtim me nenet e Marrëveshjes ose rregullave dhe rregulloreve përdorimin nga emetuesi të burimeve të përgjithshme të FMN-së;

3.1.19 Qëllimi i sanksioneve OFAC: As Emetuesi dhe as sipas njohurive të Emetuesit apo ndonjë nëpunësi, agjenti, përfaqësuesi, punonjësi apo filiali të Emetuesit nuk është objekt i ndonjë sanksioni ekonomik të administruar nga Zyra e Kontrollit të Sendeve Pasurore të Huaja e Departamentit të Thesarit të SHBA-së ("Objekt i Sanksioneve"); dhe

3.1.20 Prezantimet e investitorit: Prezantimet e investitorit janë në çdo material veçanërisht të vërtetë dhe të saktë dhe jo të gabueshëm; çdo deklarim i mendimit i shprehur në Prezantimet e Investitorit është i bërë në mënyrë të ndershme, është arritur pas shqyrtimit të të gjithë rrethanave përkatëse dhe bazuar në Prezumimet e arsyeshme; nuk ka fakte të tjera në lidhje me Emetuesin ose Notat mosveprimi i të cilit, në kontekstin e emetimit dhe ofrimit të Notave, do të bënte një deklarim jo të vërtetë në Prezantimet e Investitorit dhe të gjitha hetimet e arsyeshme janë bërë nga Emetuesi për të konfirmuar këto fakte dhe për të verifikuar saktësinë e të gjithë këtij informacioni dhe fakteve.

3.2 Ndryshim në çështjet e përfaqësuara

Emetuesi njofton menjëherë Joint Lead Managers për çdo gjë që para përfundimit të parë të (sipas mendimit të Joint Lead Managers) të ofertës së Notave dhe pranimit të Notave për tregtim në Tregun e Rregulluar të Bursës së Londrës është ose ka qenë vërtetuar, ose mund të vërtetohet e pavërtetë ose e pasaktë në çdo aspekt një përfaqësim dhe garanci e Emetuesit në këtë Marrëveshje sikur të bëhej ose jepej në atë kohë në lidhje me faktet dhe rrethanat ekzistuese.

3.3 Përfaqësimet e përsëritura

Përfaqësimet dhe garancitë në klauzolën 3.1 (përfaqësimet e Emetuesit) konsiderohen të përsëriten (në lidhje me faktet dhe rrethanat ekzistuese) në çdo datë që është para ose në Datën e Mbylljes.

4. DETYRIMET E EMETUESIT

4.1 Publikimi dhe Dhënia e Prospektit

Emetuesi merr masa që Prospekti t'i ofrohet publikut në pajtim me kërkesat e Direktivës së Prospektit dhe masat përkatëse zbatuese në Mbretërinë e Bashkuar. Përveç kësaj Emetuesi u jep Joint Lead Managers në emër të Menaxherëve, pa pagesë, në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe pas kësaj here pas here me kërkesë aq kopje të Prospektit sa Menaxherët mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme.

4.2 Shtesat

Pa cenuar detyrimet e tij në bazë të ligjit të zbatueshëm, Emetuesi me kërkesë të Joint Lead Managers në çdo moment para përfundimit të parë të (sipas mendimit të Joint Lead Managers) të ofertës së Notave dhe pranimit të Notave për tregtim në Tregun e Rregulluar të Bursës së Londrës mund të ndryshojë ose plotësojë prospektin sipas miratimit të Joint Lead Managers. Emetuesi merr masa që çdo Prospekt i

ndryshuar ose Prospekt shtesë t'i ofrohet publikut në pajtim me kërkesat e direktivës së Prospektit dhe masat përkatëse zbatuese në Mbretërinë e Bashkuar. Përveç kësaj, Emetuesi u jep Menaxherëve herë pas here kopje të Prospektit të ndryshuar ose Prospektit plotësues që menaxherët mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme.

4.3 Mungesa e Njoftimeve

Nga data e kësaj Marrëveshjeje deri në (duke përfshirë) Datën e Mbylljes, Emetuesi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Joint Lead Managers, nuk bën:

4.3.1 asnjë njoftim publik që mund të pritet te ketë një efekt negativ në tregtueshmërinë e Notave; ose

4.3.2 asnjë komunikim që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të cenojë aftësinë e Menaxherit për të ofruar ligjshmërisht ose shesë Notat në pajtim me dispozitat e parashikuara në grafik.

4.4 Dhënia e Notave

Emetuesi merr masa që janë të arsyeshme dhe të pranueshme për Joint Lead Managers për të siguruar që Nota e Përkohshme Globale, Nota e Përhershme Globale dhe çdo Notë Definitive jepet tek Agjenti Fiskal për certifikim në formën e kërkuar ose në pajtim me Marrëveshjen e Agjencisë.

4.5 Renditja dhe tregtimi

Emetuesi bën të gjitha përpjekjet për të realizuar që Notat të pranohen në renditje në Listën Zyrtare të FSA-së dhe për të tregtuar në Tregun e Rregulluar të Bursës së Londrës dhe për të ruajtur këtë pranim/renditje deri sa asnjë nga notat të mos ketë mbetur; me kusht që, nëse nuk është praktike ose do të ishte e vështirë për të realizuar këtë pranim/renditje, Emetuesi do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të realizuar dhe bërë pranimin e sipërpërmendur për renditje, tregtim dhe/ose kuotim për Notat nga ata autoritete të tjerë kompetentë, bursa dhe/sisteme kuotimi që (me aprovimin e Joint Lead Managers) mund të vendosë dhe më tej Emetuesi do të jetë përgjegjës për çdo tarifë të shkaktuar në lidhje me të.

4.6 Përdorimi i shumave

Emetuesi nuk:

4.6.1 përdor drejtpërdrejt ose jo shumat e ofrimit të Notave për një qëllim që do të shkelte, sipas rastit, sanksionet ekonomike të SHBA-së ose ligjin për Praktikat e Huaja Korruptive të SHBA-së të vitit 1977; ose

4.6.2 jep hua, investon, kontribuon ose ofron ndryshe shumat nga Notat për ose në përfitim të një Objekti të Sanksioneve përkatëse.

4.7 Mosekzistenca e detyrimit të mirëbesimit

Emetuesi njeh dhe bie dakord që secili Menaxher po vepron vetën në bazë të një detyrimi kontraktual me Emetuesin me një bazë të zakonshme në lidhje me emetimin, ofrimin dhe shitjen e Notave (duke përfshirë në lidhje me përcaktimin e termave të emetimit, ofrimit dhe shitjes së Notave) dhe jo si një këshilltar financiar ose një i besuar i emetuesit ose një personit tjetër. Po ashtu, Emetuesi njeh që Menaxherët nuk këshillojnë Emetuesin ose ndonjë person tjetër në lidhje me çështjet ligjore, tatimore, të investimeve, llogarive ose rregullatore në një juridiksion. Emetuesi konsultohet me këshilltarët e tij në lidhje me këto çështje dhe është përgjegjës për të bërë hetimet e tij të pavarura dhe vlerësimet e veprimeve të parashikuara, dhe Menaxherët nuk kanë përgjegjësi detyrim ndaj emetuesit në lidhje me këto. Emetuesi po ashtu njeh dhe bie dakord që çdo rishikim nga Menaxherët e emetuesit, emetimi, ofrimi dhe shitja e Notave, termat e Notave dhe çështje të tjera në lidhje me to do të bëhen vetëm në përfitim të Menaxherëve dhe nuk do të jenë në emër të Emetuesit ose ndonjë personi tjetër. Për sa më sipër nuk ndikon mbi detyrimet e Joint Lead Menagers për të bërë rekomandime për emetuesin në lidhje me çmimet dhe caktimet e ofertës në pajtim me rregullat e zbatueshme të FSA.

5. KUFIZIMET E SHITJES

Secila nga palët në këtë Marrëveshje përfaqëson, garanton dhe merr përsipër sipas parashikimit në grafik.

6. ZHDËMTIM

6.1 Zhdëmtimi nga Emetuesi

Emetuesi merr përsipër para çdo menaxheri që nëse Menaxheri ose një Palë në lidhje me Menaxherin shkakton një Humbje nga ose në lidhje me, apo bazuar në:

6.1.1 Keqpërfaqësimi: çdo pasaktësi ose pasaktësi e pretenduar e çdo përfaqësimi dhe garancie nga Emetuesi në këtë Marrëveshje (në datën e kësaj Marrëveshjeje ose në çdo datë kur konsiderohet të përsëritet); ose

6.1.2 Shkelja: çdo shkelje ose shkelja e pretenduar nga Emetuesi i një prej detyrimeve të tij ne këtë Marrëveshje;

Emetuesi i paguan Menaxherit me kërkesë nje shumë të barabartë me këtë humbje. Asnjë

menaxher nuk ka detyrimin ose detyrë, qoftë si në mirëbesim apo i besuar për ndonjë prej Palëve të tij Përkatëse, apo tjetër, për të marrë këto pagesa ose në emër të një personi tjetër për një shumë të paguar atij në bazë të kësaj Klauzole.

7. TARIFAT DHE SHPENZIMET

7.1 Menaxhimi i kombinuar dhe komisioni përkatës

Emetuesi, në Datën e Mbylljes, i paguan Joint Lead Managers [per llogari të Menaxherëve]2 një komision të kombinuar menaxhimi dhe marreveshjes se zotimit prej 0.17 për qind të shumës së plotë principale të Notave. Ky Komision zbritet nga Çmimi i Emetimit.

7.2 Kostot dhe shpenzimet

Masat për pagesën e shpenzimeve të Emetuesit dhe tarifat dhe shpenzimet e Joint Lead Managers përcaktohen në letrën e mandatit të datës 2 mars 2010 ndërmjet emetuesit dhe Joint Lead Managers.

7.3 Tatimet

[Të gjitha pagesat në lidhje me detyrimet e Emetuesit sipas kësaj Marrëveshjeje janë të lira dhe të pastra pa mbajtje apo zbritje për ose për llogari të një tatimi, detyrimi, vlerësimi apo detyrimi qeveritar i cilësdo natyre të ngarkuar vendosur vjelë mbajtur apo vlerësuar në emër të Republikës së Shqipërisë ose një nënndarjeje politike të saj apo një autoriteti në që ka kompetencë për të tatuar, përveç kur ndalimi, ose zbritja e këtyre kërkohet me ligj. Në atë rast Emetuesi paguan ato shuma shtesë që rezultojnë në marrjen nga Menaxheri përkatës të atyre shumave që do të merreshin prej tij nëse kjo mbajtje apo zbritje nuk do të kërkohej]3.

7.4 Detyrimet e Pullës

Emetuesi paguan të gjitha detyrimet e pullës, regjistrimit ose të tjera dhe detyrime (duke përfshirë interesin dhe gjobat për të ose në lidhje me te) që mund të jenë të pagueshme për ose në lidhje me krijimin dhe emetimin e Notave dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të Emetimit, dhe emetuesi zhdëmton çdo Menaxher ndaj çdo pretendimi, kërkese, veprimi, detyrimi, dëmi, kostoje, humbjeje ose shpenzimi (duke përfshirë pa kufizim, tarifat ligjore) që ai mund të shkaktojë si rezultat ose që rrjedhin nga ose në lidhje me mospagesën apo vonesën në këtë pagesë.

8. MBYLLLJA

8.1 Mbyllja

Në pajtim me klauzolën 8.3 (Kushtet Paraprake), mbyllja e emetimit te Notave kryhet në datën e Mbylljes, dhe për pasojë:

8.1.1 Dhënia e Notave të Përkohshme dhe të Përhershme Globale: Emetuesi jep Notat e Përkohshme dhe të Përhershme Globale, të nënshkruara rregullisht në emër të Emetuesit dhe certifikuara në pajtim me Marrëveshjen e Agjencisë tek një depozitues i përbashkët i caktuar për këtë qëllim nga Euroclear dhe Clearstream, Luxembourg për kredi në Datën e Mbylljes në llogaritë Euroclear dhe Clearstream, Luxembourg me këtë depozitues të përbashkët, dhe

8.1.2 Pagesa e shumave të emetimit neto: përkundrejt kësaj dhënieje, Menaxherët realizojnë pagesën e shumave neto për emetimin e Notave (që janë Çmimi i Emetimit minus komisionin e menaxhimit përkatës prej 0.17 për qind të shumës së plotë principale të Notave) për Emetuesin me transferta kredie në Euro për të njëjtën date valute ne llogarine që Emetuesi u ka caktuar për kete qellim Joint Lead Managers.

8.2 Mbyllja e shtyrë

Emetuesi dhe Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve) mund të bjerë dakord të shtyjë Datën e Mbylljes në një datë tjetër jo më vonë se [•] 2010, ku të gjitha referencat në të tek Data e Mbylljes interpretohen sikur janë në datën e mëvonshme.

8.3 Kushtet paraprake

Menaxherët do të jenë vetëm nën detyrimin e nënshkrimit dhe pagesës për Notat nëse:

8.3.1 Dokumentet mbyllëse: Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve) marrin në (ose, në rastin e provave të përmendura në nënparagrafin (d), në ose përpara) Ditën e Mbylljes:

a) Mendimet ligjore: mendimet ligjore të Datës së Mbylljes drejtuar Menaxherëve dhe Agjentit Fiskal nga Ministri i Drejtësisë, këshilltarët ligjorë të emetuesit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit shqiptar, Wolf Theiss, këshilltarët ligjorë të Menaxherëve në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit shqiptar dhe Clifford Chance LLP, këshilltarët ligjorë të Menaxherëve në Angli sipas ligjit anglez, në një formë të pranueshme për Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve);

b) Certifikata e mbylljes: një certifikatë përmbyllëse me datë të Datës së Mbylljes, drejtuar Menaxherëve dhe nënshkruar nga një firmatarë i autorizuar rregullisht në emër të emetuesit në formën e rënë dakord që deklaron që në Datën e Mbylljes, (i) përfaqësimet dhe garancitë që gjenden në klauzolën 3.1 janë të vërteta dhe të sakta në lidhje me faktet dhe rrethanat ekzistuese, (ii) nuk ka pasur ndryshim negativ

ose ndonjë zhvillim që ka një ndryshim të mundshëm negativ në gjendjen financiare, politike ose ekonomike ose në gjendjen e përgjithshme të Emetuesit që është material në kontekstin e emetimit të Notave dhe (iii) Emetuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet dhe ka realizuar kushtet që duhet të arrihen ose përmbushen në pajtim me këtë Marrëveshje në ose para Datës së Mbylljes;

c) Autorizimet dhe aprovimet: kopje të certifikuara të vërteta të dokumenteve të mëposhtëm: (i) mendim nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në lidhje me emetimin e Notave; (ii) Prokurë nga Kryeministri (nënshkruar nga Ministri i Punëve të Jashtme) që autorizon Ministrin e Financave për të filluar bisedimet në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Emetimit dhe Notave; (iii) aprovimin nga Këshilli i Ministrave në lidhje me këtë Marrëveshje, Dokumentet e Emetimit dhe Notat; dhe (iv) rafitikimin nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë të (projektit të formës së miratuar të] kësaj Marrëveshjeje, Dokumenteve të Emetimit dhe Notave; [dhe]

d) Pranimi i agjentit të njoftimeve: prova që personi i përmendur në klauzolën 15.4 (dorëzimi i njoftimit) ka rënë dakord të pranojë njoftimet në mënyrën e caktuar atje dhe

e) Letrat vleresuese te kreditit te vendit: letra te seciles prej Standard &Poor's Rating Services nje dege e McGraw-Hill Companies, Inc dhe Moody's Investors Service, qe konfirmojne kreditin e Notave.

8.3.2 Dokumentimi i emetimit: Dokumentet e Emetimit nënshkruhen në ose para Datës së Mbylljes nga ose në emër të të gjitha palëve;

8.3.3 Mungesa e ndryshimit negativ material: nuk ka pasur, që nga 31 dhjetor 2009 asnjë ndryshim negativ ose zhvillim që ka një mundësi për ndryshim negativ në gjendjen financiare, politike ose ekonomike ose në çështjet e përgjithshme të emetuesit që është materiale në kontekstin e emetimit të Notave;

8.3.4 Mungesa e ndryshimit negativ të vlerësimit: që nga data e kësaj Marrëveshjeje, asnjë agjenci e njohur ndërkombëtarisht, në lidhje me titujt e borxheve të emetuesit, nuk ka nxjerrë ndonjë njoftim (a) që zbret këto tituj, (b) që tregon se ajo ka ndër mend të zbresë ose po shyrton mundësinë për të zbritur këto tituj ose (c) tregon që ka ndër mend të vlerësojë këto tituj pa deklaruar që ka ndër mend t'i rrisë ata;

8.3.5 Saktësia e përfaqësimeve: përfaqësimet dhe garancitë e emetuesit në këtë Marrëveshje janë të vërteta dhe të sakta në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe në secilën datë në të cilën ato konsiderohen të përsëriten dhe do të ishin të vërteta dhe të sakta nëse do të përsëriteshin në Datën e Mbylljes me referencë në faktet dhe rrethanat ekzistues, dhe

8.3.6 Listimi dhe tregtimi: Joint Lead Managers marrin konfirmimin në ose para Datës së Mbylljes që Notat, në pajtim me nënshkrimin, certifikimin dhe dhënien e Notës së Përhershme dhe Përkohshme Globale, janë pranuar në Listën Zyrtare të FSA-së dhe pranuar për tregtim në Tregun e Rregulluar të Bursës së Londrës, me kusht që Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve), në diskrecionin e tyre, mund të heqin dorë nga përmbushja e ndonjë prej kushteve të përcaktuara në klauzolën 8.3.

9. PËRFUNDIMI

9.1 E drejta e menaxherëve për përfundimin

Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve) mund të bëjnë një njoftim prishjeje për Emetuesin në çdo kohë para pagesës së shumave neto për emetimin e Notave ndaj emetuesit në Datën e Mbylljes nëse:

9.1.1 Pasaktësia e përfaqësimit: çdo përfaqësim dhe garanci nga emetuesi në këtë Marrëveshje është ose del e pavërtetë ose e pasaktë në datën e kësaj Marrëveshjeje ose në datën në të cilën mendohet se përsëritet;

9.1.2 Shkelja e detyrimit: emetuesi nuk përmbush detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

9.1.3 Mospërmbushja e parakushteve: secila prej kushteve të Klauzolës 8.3 (Kushtet paraprake) nuk përmbushet ose hiqet dorë nga Joint Lead Managers (në emër të Menaxherëve) në Datën e Mbylljes; ose

9.1.4 Forca madhore: që nga data e kësaj Marrëveshjeje, sipas mendimit të Joint Lead Managers, një ndryshim në kushtet kombëtare ose ndërkombëtare, financiare, politike apo ekonomike ose kurset e këmbimit të monedhave ose kontrolli i kurseve që sipas mendimit të tyre do të dëmtonte materialisht suksesin e ofrimit dhe shpërndarjes së Notave në veprimet më Notat në tregun dytësor.

9.2 Pasojat

Me dhënien e një njoftimi për prishje në pajtim me Klauzolën 9.1 (E drejta e Menaxherit për Zgjidhje) dhe në pajtim me klauzolën 9.3 (Ruajtja):

9.2.1 Lirimi i emetuesit: Emetuesi lirohet nga përmbushja e detyrimeve të tij në pajtim me klauzolat 2.1 (Detyrimi për të emetuar) dhe nënklauzola 8.1.1 (Dhënia e Notave të Përkohshme dhe të Përhershme Globale); dhe

9.2.2 Lirimi i Menaxherëve: Menaxherët lirohen nga detyrimet e tyre përkatëse të klauzolës 2.2 (Detyrimi për abonim) dhe nënklauzola 8.1.2 (Pagesa e shumave neto të emetimit).

9.3 Ruajtja

Një përmbushje në pajtim me klauzolën 9.2 (Pasojat) nuk ndikojnë në detyrimet e tjera të palëve në këtë Marrëveshje dhe nuk cenon detyrimet e mbledhura.

10. MBETJA NË FUQI

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje vazhdojnë të mbeten plotësisht në fuqi pavarësisht të përfundimit të masave të përcaktuara këtu për emetimin e Notave dhe pavarësisht nga ndonjë hetim nga një palë në këtë Marrëveshje.

11. KOHA

Çdo datë ose periudhë e përcaktuar këtu mund të shtyhet zgjatet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet palëve por, në lidhje me datën ose periudhën e përcaktuar si fillim ose shtyrë apo zgjatur, koha mund të jetë e rëndësishme.

12. NJOFTIMET

12.1 Adresat për njoftime

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe në anglisht (me letër ose faks) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

12.1.1 Emetuesi: nëse i drejtohet Emetuesit, në:

Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Nr 1
Tirana
Shqipëri]
Fax: +355 422 28494
Attention: z. Ridvan Bode, Minister i Financave

12.1.2 Joint Lead Managers: nëse i drejtohet Joint Lead Managers, tek ata në:

Deutsche Bank AG, London Branch
Winchester House
1 Great Winchester Street
London EC2N 2DB
Tel: +44 (0) 207 545 4361
Faks: +44 (0) 207 545 4455
Në vëmendje të: Syndicate Desk

dhe

J.P. Morgan Securities Ltd.
125 London Wall
London EC2Y 5AJ

Tel: +44 (0) 207 779 2468
Faks: +44 (0) 207 067 8128
Në vëmendje të: Head of Syndicate Desk

Me kopje drejtuar:

Fax: +44 (0) 207 325 8240
Në vëmendje të: Kreu i EMEA Debt Capital Markets Group - Legal

12.2 Hyrja në fuqi

Çdo njoftim ose komunikim i dërguar në përputhje me paragrafin 12.1 (Adresat për njoftime) do të hyjë në fuqi, me marrjen nga marrësi, megjithatë, me kusht që çdo njoftim ose komunikim i tillë që do të hynte në fuqi pas orës 4 pasdite në ndonjë ditë specifike, nuk do të hyjë në fuqi deri në orën 10.00 paradite në ditën e punës që bie menjëherë pas kësaj date, në vendin e marrësit.

13. LIGJI RREGULLUES

Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me të rregullohet nga ligji anglez.

14. ARBITRAZHI

14.1 Arbitrazhi

Ne perputhje me Klauzolen 14.5 (opsionet e Manaxhereve), ndonje mosmarreveshje (nje “mosmarreveshje”) e lidhur nga kjo marreveshje ose nga zbatimi i saj (perfshire nje mosmarreveshje lidhur me ekzistencen, vlefshmerine ose perfundimin e kesaj marreveshjeje ose ndonje detyrim jo kontraktor i lindur nga kjo marreveshje apo zbatimi i saj) apo pasojat e mosmarrjes parasysh, i referohen arbitrazhit në

pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar (LCIA), dhe këto rregulla konsiderohen të përfshira nëpërmjet referencës në këtë kusht.

14.2 Formimi i gjykatës së arbitrazhit, selia dhe gjuha e arbitrazhit

14.2.1 Formimi i gjykatës së arbitrazhit: Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra, secili prej të cilëve nuk ka interes në mosmarrëveshje dhe nuk ka lidhje me asnjë palë dhe është një jurist me eksperiencë në veprimet e titujve ndërkombëtare. Emetuesi dhe Menaxheret do te caktojne secili një arbitër, të cilët se bashku, caktojnë Kryetarin e Gjykatës. Nëse një mosmarrëveshje, pretendim apo shkak për padi përfshin më shumë se dy palë, palët përpiqen të pozicionohen në dy anë (d.m.th. paditës dhe i paditur) ku secili cakton një arbitër sikur të ishin dy palë në mosmarrëveshje, pretendim apo shkak për padi. nëse kjo vendosja dhe caktim nuk bahet për tridhjetë (30) ditë kalendarike pasi pala paditëse bën kërkesën për arbitrazh, ose nëse një Kryetar nuk është zgjedhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga zgjedhja e arbitrit të dytë, Gjykata e Arbitrazhit e Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar cakton tre arbitra ose kryetarin, sipas rastit. Palët dhe gjykata e Arbitrazhit mund të caktojë arbitra nga shtetasit e çdo vendi, pavarësisht nëse një palë është shtetas i atij vendi. Arbitrat nuk kanë autoritet për të dhënë vendime zhdëmtimi si dënim dhe në asnjë rast nuk mund të vendosë apo bëjë konstatime në kundërshtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

14.2.2 Selia e arbitrazhit: Selia e arbitrazhit është Londra, Angli dhe të gjitha seancat janë në Londër, Angli.

14.2.3 Gjuha e arbitrazhit: Gjuha e arbitrazhit është anglishtja.

14.3 Tarifat

Tarifat e arbitrazhit (duke përjashtuar përgatitjen e çdo pale, udhëtimin, tarifat e avokatëve dhe koston e ngjashme) mbulohet në pajtim me vendimin e arbitrave. Vendimi i arbitrave është përfundimtar, detyrues dhe i ekzekutueshëm për palët dhe vendimi mbi çdo vendim arbitrazhi mund të konfirmohet në çdo gjykatë që juridiksion mbi të.

14.4 Rekursi në Gjykatë

Për qëllimet e arbitrazhit në pajtim me kushtin 18 (Arbitrazhi), Emetuesi dhe Zotëruesit e Notave përjashtojnë juridiksionin e Gjykatave sipas seksioneve 45 dhe 69 të ligjit të arbitrazhit të vitit 1996.

14.5 Opsioni i Manaxhereve

Ne çdo kohe perpara se nje Menaxher te kete emeruar nje arbiter per te zgjidhur ndonje mosmarreveshje ne perputhje me klauzolen 14.1 (Arbitrazhi), çdo Menaxher, me vullnetin e tij, mund te vendose, duke njoftuar me shkrim Emetuesin, qe kjo mosmarreveshje te paraqitet perpara gjykatave angleze ose perpara ndonje gjykate te ndonje jurudiksioni tjeter, siç pershkruhet me hollesisht ne klauzolen 15.3 (Te drejtat e Menaxhereve per te filluar procedime jashte Anglise). Si rezultat i ndonje zgjedhjeje te tille, asnje gjykate arbitrazhi nuk do te kete juridiksion lidhur me ndonje mosmarreveshje.

15. Gjykatat angleze

Në rast se një Zotërues Note emeton një njoftim në pajtim me Kushtin 14.5 (Opsioni i Menaxhereve), zbatohen dispozitat e mëposhtme në këtë kusht 15 (Gjykatat Angleze).

15.1 Juridiksioni

Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur ndonjë “Mosmarrëveshje” që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me këtë

15.2 Forumi i përshtatshëm

Palët bien dakord që gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme dhe të duhura për të zgjidhur ndonjë Mosmarrëveshje/t dhe për pasojë, që ato nuk do të argumentojnë për të kundërtën.

15.3 Te drejtat e menaxherëve për të filluar procedime jashtë Anglisë

Kushti 15 (Gjykatat Angleze) është vetëm në interes të Menaxherëve. Si rezultat, asgjë në kushtet 13 (Ligji rregullues), 14 (Arbitrazhi) ose 15 (Gjykatat angleze) nuk pengon Agjentët Pagues të nisin procedime në lidhje me një Mosmarrëveshje ("Procedimet") në ndonjë gjykatë tjetër me juridiksion. Në masën e lejuar me ligj, Menaxherët mund të nisin procedime të njëkohshme në disa juridiksione.

15.4 Dorëzimi i dokumenteve:

Emetuesi bie dakord që dokumentet që fillojnë procedime dhe çdo dokument tjetër që kërkohet të jepet në lidhje me ato procedime mund të njoftohet duke u dorëzuar tek Emetuesi në Law Debenture Corporate Services Limited at 5th Floor, 100 Wood Street, London EC2V 7EX, England. Ne rast se per ndonje arsye, nje person i tille nuk eshte ose pushon se qeni efektivisht i emeruar per te pranuar dorezimin e dokumentave ne emer te Emetuesit, Emetuesi cakton nje person tjeter ne Angli per te pranuar sherbimet e procedimit ne emer te tij. Ne rast se nje person i tille nuk emerohet brenda 30 diteve, çdo Menaxher do te

kete te drejten te emeroje nje person te tille, duke njoftuar me shkrim Emetuesin. Asgje ne kete paragraf nuk kufizon te drejten e ndonje Menaxheri te kryeje procedimet kunder Emetuesit ne ndonje forme tjeter te lejuar nga ligji.

15.5 Miratimi për zbatim etj .

Ne perputhje me kufizimet e shprehura ne klauzolen 15.6 (Heqja dore nga imuniteti) Emetuesi jep pëlqimin përgjithësisht në lidhje me çdo procedim për të dhënë ndonjë ndihmë ose çështje të një procesi në lidhje me këto Procedime, duke përfshirë (pa kufizim) bërjen, zbatimin ose ekzekutimin kundrejt çdo lloj prone (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i saj i synuar) të ndonjë urdhri ose vendimi që është bërë ose është dhënë në këto procedime.

15.6 Heqja dorë nga imuniteti

Në masën që Emetuesi në ndonjë juridiksion ka te drejten të pretendojë për vete ose për asetet apo të ardhurat e tij imunitet nga procedimi, ekzekutimi, konfiskimi (qoftë në ndihmë të ekzekutimit, para vendimit apo ndryshe) ose nga ndonjë proces tjetër ligjor dhe në masën që ky imunitet (qoftë i pretenduar apo jo) mund t'i atribuohet në çdo juridiksion të tillë Emetuesit ose aseteve apo të ardhurave të tij, Emetuesi bie dakord të mos pretendojë dhe të heqë dorë në mënyrë të pakthyeshme nga ky imunitet në masën e plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni [me kusht që Emetuesi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me (i) "godinat e misionit" të tashme ose të ardhshme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, "godinat e misionit" të tashme ose të ardhshme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, ose të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj; ose (ii) çdo pronë e paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e paragrafit 1-3, neni 3 i ligjit shqiptar nr.8743, datë 22.02.2001 "Mbi pronat e paluajtshme të shtetit";

16. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA

Një person që nuk është palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtë në bazë të ligjit për kontratat (Të Drejtat e Palëve të Treta) 1999 për t'i dhënë fuqi çdo termi të kësaj Marrëveshjeje.

17. KOPJET

Kjo Marrëveshje mund të realizohet në disa kopje dhe nga palë të ndryshme në kopje të ndryshme, secila prej të cilave e realizuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinale, dhe të gjitha prej tyre të nënshkruara në këtë mënyrë do të përbëjnë të njëjtën marrëveshje detyruese ndërmjet palëve.

Në dëshmi të kësaj firmat e përfaqësuesve të autorizuar rregullisht të palëve të saj Marrëveshjeje në ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

SKEDULI
KUFIZIME SHITJEJE

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Çdo Menaxher eshte ne dijeni se asnje perfaqesim nuk eshte bere nga emetuesi ose ndonje Menaxher qe ndonje veprim eshte kryer ose do te kryhet ne ndonje vend ose juridiksion nga Emetuesi apo menaxheri, veprim i cili do te lejonte nje oferte publike te Notave apo posedim apo shperndarje e Prospektit, Porspektit paraprak, Prezantimet e investitoreve ose ndonje materiali tjeter ne ndonje vend apo juridiksion ku eshte kerkuar nje veprim i tille. Çdo Menaxher merr përsipër para emetuesit që ai, sipas njohurisë dhe besimit të tim më të mirë, do të respektojë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në çdo vend ose juridiksion në të cilin i blen, ofron, shet ose jep Nota ose ka në zotërimin e tij ose shpërndan Prospektusin ose ndonjë material tjetër përkatës, në çdo rast me shpenzimet e veta.

2. SHTETET E BASHKUARA

2.1 Mosregjistrimi sipas ligjit të titujve

Notat nuk janë dhe nuk do të regjistrohen sipas ligjit të titujve dhe nuk mund të ofrohen apo shiten brenda Shteteve të Bashkuara, përveç se në pajtim me ndonjë përjashtim, ose në një transaksion jo në pajtim me kërkesat e regjistrimit të ligjit të titujve.

2.2. Respektimi nga emetuesi i ligjit të titujve të Shteteve të Bashkuara

Emetuesi përfaqëson, garanton dhe merr përsipër për secilin Menaxher që as ai dhe as ndonjë prej filialeve të tij (duke përfshirë një person që vepron në emër të Emetuesit ose të një prej filialeve të tij, i cili per te menjanuar çdo dyshim, nuk do te perfshije ndonje Menaxher) ka ofruar apo shitur ose do të ofrojë ose shesë ndonjë Notë në çdo rrethanë që do të kërkonte regjistrimin e ndonjë prej Notave sipas ligjit të titujve ose kualifikimeve të Veprimit të Njëanshëm si një detyrim zhdëmtimi në bazë të ligjit të Zhdëmtimit për Besimet të Shteteve të Bashkuara të vitit 1939 dhe veçanërisht as Emetuesi dhe asnjë prej filialeve të tij apo personave që veprojnë në emër të tyre nuk është përfshirë dhe nuk do të përfshihet në përpjekje që synon shitjen në lidhje me Notat.

2.3 Respektimi nga Menaxherët i ligjit të titujve të Shteteve të Bashkuara

Secili Menaxher përfaqëson, garanton dhe merr përsipër para Menaxherit që ai nuk ka ofruar dhe nuk ka shitur dhe nuk do të ofrojë apo shesë ndonjë Notë që përfshihet brenda pjesës së Shteteve të Bashkuara, përveç se në pajtim me Rregullin 903 të Rregullores S sipas ligjit të titujve dhe, përkatësisht, që as ai dhe as filialet e tij (duke përfshirë çdo person që vepron në emër të këtij Menaxheri apo të filialeve të tyre) nuk është përfshirë dhe nuk do të përfshihet në përpjekje që synojnë shitje në lidhje me Notat.

2.4 Respektimi nga Menaxherët i rregulloreve të Thesarit të Shteteve të Bashkuara

Secili Menaxher përfaqëson, garanton dhe merr përsipër para Menaxherit që

2.4.1 Kufizimet në oferta etj.: përveç se në masën e lejuar nga Rregullorja e Thesarit të Shteteve të Bashkuara §1.163-5(c)(2)(i)(D) ("D Rregullat"):

a) Asnjë ofertë për Shtetet e Bashkuara apo persona në Shtete të Bashkuara: nuk ka ofruar dhe shitur dhe gjatë periudhës së kufizuar nuk do të shesë dhe ofrojë ndonjë Notë një personi që është brenda Shteteve të Bashkuara apo zotërimeve të tij apo tek një person në Shtetet e Bashkuara; dhe

b) Mosdhënie e Notave definitive në Shtetet e Bashkuara: nuk ka dhënë dhe nuk do të japë në formë definitive brenda Shteteve të Bashkuara ose zotërimeve të tij ndonjë Notë që është shitur gjatë periudhës së kufizuar.

2.4.2 Procedura të brendshme: ka, dhe gjatë gjithë periudhës së kufizuar do të ketë, në fuqi procedura të projektuara në mënyrë të arsyeshme për të siguruar që punonjësit ose agjentët e tij që janë përfshirë drejtpërdrejt në shitjen e Notave janë të ndërgjegjshme që Notat nuk mund të ofrohen ose shiten gjatë periudhës së kufizuar një personi që është brenda Shteteve të Bashkuara ose zotërimeve të tij ose një personi të Shteteve të Bashkuara, përveç kur lejohet nga D Rregullat; dhe

2.4.3 Dispozita shtesë nëse personi i Shteteve të Bashkuara: nëse është një person i Shteteve të

Bashkuara, ai i përfton Notat për qëllime të rishitjes në lidhje me emetimin e tyre origjinal dhe, nëse a ii mban Notat për llogari të vet, do ta bëjë këtë vetën në pajtim me Rregulloren e Thesarit të Shteteve të Bashkuara §1.163-5(c)(2)(i)(D) ("D) (6).

Dhe në lidhje me çdo filial të këtij Menaxheri që përfton Nota nga ky menaxher për qëllimin e ofrimit ose shitjes së këtyre Notave gjatë periudhës së kufizuar, ky Menaxher merr përsipër para Emetuesit që ai do të marrë nga ky filial për interes të Emetuesit përfaqësimet, garancitë dhe detyrimet që gjenden në nënklauzolën 2.4.1, 2.4.2 dhe 2.4.3. Çdo Menaxher merr persiper qe, nese ai hym ne ndonje marreveshje kontraktuale te ndryshme nga kjo Marreveshje, per shitjen ose shperndarjen e Notave, keto marreveshje do te permbajne përfaqësimet, garancitë dhe detyrimet që gjenden në nënklauzolën 2.4.1, 2.4.2 dhe 2.4.3.

2.5 Interpretimi

Termat e përdorur në klauzolat 2.2 dhe 2.3 më sipër kanë kuptimet që u janë dhënë nga Rregullorja S sipas ligjit të titujve. Termat e përdorur në klauzolën 2.4 më sipër kanë kuptimet e dhëna nga Kodi i të Ardhurave të Brendshme të Shteteve të Bashkuara te 1986 me ndryshimet, dhe rregulloret e Thesarit te Shteteve te Bashkuara te nxjera në bazë të tij, duke përfshirë D Rregullat.

3. MBRETËRIA E BASHKUAR

Çdo Menaxher përfaqëson, garanton dhe merr përsipër kundrejt emetuesit dhe Menaxherit tjetër që:

3.1 Përmirësimi financiar: ai ka komunikuar ose marrë masa për të komunikuar dhe do të komunikojë dhe marrë masa për të komunikuar çdo ftesë apo shtysë për t'u përfshirë në aktivitet investimesh (brenda kuptimit të seksionit 21 të FSMA-së) të marrë prej saj në lidhje me emetimin ose shitjen e Notave në rrethanat që seksionet 21(1) të FSMA-së nuk zbatohen për Emetuesin.

3.2 Përputhja e përgjithshme: ka respektuar dhe do të respektojë të gjitha dispozitat e zbatueshme të FSMA-së në lidhje me çdo gjë të bërë në lidhje me Notat, nga ose përndryshe në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar.

4. REPUBLIKA ITALIANE

a) Oferta e Notave nuk eshte regjistruar ne perputhje me legjislacionin italian per letrat me vlere, dhe per rrjedhim, çdo Menaxher, ka paraqitur dhe rene dakord se nuk ka ofruar apo shitur, dhe nuk do te ofroje apo shese, ndonje Note ne Republiken Italiane me nje oferte publike dhe kjo shitje e Notave ne Republiken Italiane do te kryhet ne perputhje me te gjitha ligjet dhe rregulloret italiane mbi letrat me vlere, taksat, kontrollit te kursit te kembimit, etj.

b) Ndonje oferte, shitje ose levrim i Notave apo shperndarje e kopjve te ketij Prospekti Baze, apo e ndonje dokumenti tjeter qe lidhet me Notat ne Republiken Italiane, duhet:

c) te behet nga kompanite e investimeve, bankat apo ndermjetesit financiare qe jane te lejuara te kryejne veprimtari te tilla ne Republiken Italiane ne perputhje me Dekretin Legjislativ Nr.385 te dates 1 shtator 1993, Dekretin Legjislativ Nr.58 te dates 24 shkurt 1998, Rregullores Nr.16190 te dates 29 tetor 2007 (ne çdo rast, sipas amendimeve) te CONSOB-it, si edhe te ligjeve dhe rregulloreve te tjera te zbatueshme; dhe

d) ne perputhje me ndonje kerkese tjeter te zbatueshme ose kufizim qe mund te jete vendosur nga CONSOB-i apo Banka e Italise.

NËNSHKRIMET
REPUBLIKA E SHQIPËRISË PERFAQESUAR NGA KESHILLI I MINISTRAVE QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE

Nga:.....

DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH
Nga:..... Nga:.....

J.P. MORGAN SECURITIES LTD.
Nga:.....

[MENAXHERË TË TJERË]
Nga:.....

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

EURO [•]
[•] PËR QIND. NOTA[3] TË KËRKUESHME [•]
MARRËVESHJE E AGJENCISË FISKALE

KJO MARRËVESHJE është bërë më [•] 2010

_____

NDËRMJET

1. REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE] ("Emetuesi");

2. DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH si agjenti fiskal ("Agjenti Fiskal"); dhe

3. DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH si agjent pagues (së bashku me Agjentin Fiskal, "Agjentët Pagues").

DUKE MARRË PARASYSH

A) Se Emetuesi ka autorizuar krijimin dhe emetimin e euro [•] në një shumë të përgjithshme principali prej [•] për qind të notave të kërkueshme [•] ("Notat").

B) Notat do të jenë në formën e obligacionit në shumën prej euro [50,000 dhe shumëfishat integralë të 1,000 euro mbi këtë shumë deri në dhe duke përfshirë 99,000 euro. Asnjë Notë në një formë Definitive nuk do të emetohet me një vlerë mbi €99,000]. Notat do të jenë fillimisht në formën e një note të përkohshme globale ("Nota e Përkohshme Globale"), interesa në të cilat do të jenë të këmbyeshme për interesa në një notë të përhershme globale ("Nota e Përhershme Globale") në rrethanat e përcaktuara në Notën e Përkohshme Globale. Për rrjedhojë, Nota e Përhershme Globale do të jetë e këmbyeshme për notat definitive ("Nota Definitive"), me kupona interesi ("Kuponat") bashkëlidhur, vetëm në disa rrethana të kufizuara të përcaktuara në Notën e Përhershme Globale. Emetuesi, në lidhje me Notat e përfaqësuara në atë masë nga Notat e Përhershme Globale, do të hyjë në një aktmarrëveshje të datës [•] 2010 (të ndryshuar ose të plotësuar herë pas here, "Akt Marrëveshje").

C) Emetuesi dhe Agjentët Pagues dëshirojnë të nënshkruajnë disa marrëveshje që ata kanë bërë në lidhje me Notat.

Është rënë dakord si më poshtë:

1. Interpretimi

1.1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

"Clearstream, Luksemburg" nënkupton Clearstream Banking, shoqëri anonime, Luksemburg;

"Kushtet" nënkuptojnë Termat dhe Kushtet e Notave (që përcaktohen në skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje dhe ndryshohen herë pas here në përputhje me termat e tyre) dhe çdo referencë ndaj një "Kushti" të renditur është referencë ndaj dispozitës korresponduese të renditur të saj;

"€", "EURO" ose "Eurot" nënkupton monedhën e prezantuar në fillim të fazës së tretë të bashkimit monetar dhe ekonomik europian dhe që përcaktohet në nenin 2 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 974/98 të 3 majit 1998 mbi prezantimin e euros, të ndryshuar;

"Euroclear" nënkupton Euroclear Bank

"Data e këmbimit" nënkupton ditën e parë pas skadimit të 40 ditëve pas lëshimit të Notave;

"Agjenti Fiskal" dhe "Agjenti Pagues" përfshijnë çdo pasardhës të tyre të emëruar herë pas here në përputhje me paragrafin 11 (Ndryshimet në Agjentët Pagues) dhe "Agjenti Pagues" nënkupton secilin prej Agjentëve Pagues;

"Dita Bankare Lokale" nënkupton një ditë (përveç të shtunës ose të dielës) në të cilën bankat tregtare janë të hapura për punë (duke përfshirë praktika në këmbimin valutor dhe depozitat në monedhë të huaj) në qytetin në të cilin Agjenti Fiskal ka Selinë e tij të Përcaktuar dhe në të cilin operon Sistemi TARGET;

"Kohë Lokale" nënkupton kohën në qytetin në të cilin Agjenti Fiskal ka selinë e tij të përcaktuar;

"Zotërues i Notave" nënkupton Zotëruesit e Notave për kohën në vazhdim;

"Agjent Zëvendësues" nënkupton Agjentin Fiskal;

"Agjent i Kërkuar Pagues" nënkupton çdo Agjent Pagues (që mund të jetë Agjenti Fiskal) që është Agjenti Pagues i vetëm i mbetur me Selinë e tij të Përcaktuar në ndonjë qytet ku një bursë në të cilën janë

[3] Shenim i Perkthyesit: Termi “Nota” i referohet Instrumentit te Titullit te Borxhit

regjistruar notat kërkon që të ketë një Agjent Pagues;

"Zyrë e caktuar" nënkupton, në lidhje me çdo Agjent Pagues:

a) Zyrën e përcaktuar me emrin në skedulin 6 (Zyrat e Caktuara të Agjentëve Pagues); ose

b) Ndonjë zyrë tjetër që Agjenti Pagues mund të specifikojë në përputhje me paragrafin 11.8 (Ndryshime në Zyrat e Caktuara);

1.2 Kuptimi i termit " i pashlyer"

Për qëllim të kësaj marrëveshje (por pa cenuar statusin e saj për ndonjë qëllim tjetër), një Notë do të bëhet "e pashlyer " nëse nuk ka ndodhur një ose më shumë nga ngjarjet e mëposhtme:

1.2.1 Është kompensuar plotësisht ose është blerë sipas Kushtit 5(c) (Kompensimi dhe Blerja-Blerja), dhe në çdo rast është anuluar në përputhje me Kushtin 5(d) (Kompensimi dhe Blerja - Anulimi);

1.2.2 Data e kërkueshme për kompensimin e saj të plotë ka ardhur dhe të gjitha shumat e kërkueshme në lidhje me një Notë të tillë (duke përfshirë të gjithë interesin e shtuar) janë marrë nga Agjenti Fiskal dhe mbeten të disponueshme për pagesë;

1.2.3 Të gjitha pretendimet për principalin dhe interesin në lidhje me një Notë të tillë janë anuluar sipas kushtit 9 (Parashkrimi);

1.2.4 Është dëmtuar ose deformuar ose supozohet të jetë humbur, vjedhur ose shkatërruar dhe është zëvendësuar sipas kushtit 10 (Zëvendësimi i Notave dhe Kuponave); ose

1.2.5 Vetëm për qëllimet e Skedulit 5 (Dispozitat për mbledhjet e Zotëruesve të Notave) mbahet nga ose nga ndonjë person në interes të Emetuesit;

Megjithatë, me kusht që për qëllimet e (i) përcaktimit të së drejtës për të marrë pjesë dhe votuar në çdo mbledhje të Zotëruesve të Notave ose të drejtës për të nënshkruar ose autorizuar nënshkrimin e ndonjë Rezolute me Shkrim, (ii) Kushti 12 (Mbledhjet e Zotëruesve të Notave) dhe skeduli 5 (Dispozitat për Mbledhjet e Zotëruesve të Notave), (iii) Kushti 13 (Komiteti i Zotëruesve të Notave) dhe (iv) Kushti 8 (Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve), ato Nota (nëse ka) që mbahen në rrethana ku Emetuesi ka kompetencën për të drejtuar hedhjen e votave në lidhje me këto Nota, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi (përveç kur dhe derisa të pushojë së mbajturi), nuk do të merren në konsideratë dhe do të konsiderohen të mbeten të pashlyera. Pa cenuar përgjithësimin e fjalisë së mëparshme, Emetuesi do të konsiderohet të ketë kompetencën për të drejtuar hedhjen e votave në lidhje me një Notë, nëse Nota mbahet nga ose në emër të Emetuesit ose nga ose në emër të ndonjë personi që zotërohet ose kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Emetuesi ose nga ndonjë shërbim të sektorit publik të Emetuesit, ku:

a) "instrumentalitet i sektorit publik" nënkupton Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, çdo departament, ministri ose agjenci tjetër e qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose çdo korporatë, trust, institucion financiar ose subjekt tjetër të zotëruar ose kontrolluar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë; dhe

b) "kontroll" nënkupton kompetencën, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet zotërimit të garancive të votimit ose interesave të tjera të pronësisë ose ndryshe, për të drejtuar menaxhimin ose zgjedhur ose caktuar një shumicë të bordit të drejtuesve ose personave të tjerë që përmbushin funksione të ngjashme në vend të se përveç bordit të drejtuesve të një korporate, trusti, institucioni ose subjekti financiar.

1.3 Paragrafët dhe skedulet

Çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj një paragrafi, Nënparagrafi ose skeduli, nëse nuk deklarohet ndryshe, është një referencë ndaj një paragrafi ose nënparagrafi të saj ose një skeduli të bashkëlidhur.

1.4 Principali dhe interesi

Në këtë Marrëveshje, çdo referencë ndaj principalit ose interesit përfshin çdo shumë shtesë të pagueshme në lidhje me të sipas kushteve.

1.5 Termat e përkufizuar në kushtet

Termat dhe shprehjet e përdorura por të papërkufizuara në të kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre në kushtet.

1.6 Statutet

Çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj ndonjë legjislacioni (qoftë legjislacioni parësor ose rregulloret ose ndonjë legjislacion tjetër ndihmës i bërë sipas legjislacionit parësor) interpretohet si referencë ndaj një statuti, instrumenti statutor, urdhri ose rregulloreje të tillë ndërsa ato mund të kenë qenë ose herë has here mund të ndryshohen ose rimiratohen.

1.7 Titujt

Titujt dhe nëntitujt janë për lehtësi reference dhe nuk cenojnë interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. EMËRIMI I AGJENTËVE PAGUES

2.1 Emërimi

Emetuesi emëron çdo Agjent Pagues si agjentin e tij në lidhje me Notat për qëllimet e specifikuara në këtë Marrëveshje dhe në kushtet.

2.2 Pranimi i emërimit

Çdo Agjent Pagues pranon emërimin e tij si agjent i Emetuesit në lidhje me Notat dhe bie dakord të respektojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Disa detyrime

Detyrimet e Agjentit Pagues jane disa, dhe jo te bashkuara.

3. NOTAT

3.1 Nota e Përkohshme Globale

Nota e Përkohshme Globale:

3.1.1 do të jetë kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 1 (Forma e Notës së Përkohshme Globale); dhe

3.1.2 do të ekzekutohet me dorë ose me faks nga ose në emër të Emetuesit dhe do të vërtetohet me dorë nga ose në emër të Agjentit Fiskal.

3.2 Nota e Përhershme Globale

Nota e Përhershme Globale do të:

3.2.1 jetë kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 2 (Forma e Notës së Përhershme Globale); dhe

3.2.2 ekzekutohet me dorë ose me faks nga ose në emër të Emetuesit dhe do të vërtetohet me dorë nga ose në emër të Agjentit Fiskal.

3.3. Notat definitive

Secila Notë definitive do të:

3.3.1 jetë kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 3 ((Forma e Notës Definitive dhe Kuponit)dhe do të ketë bashkëlidhur Kupona kryesisht në formën e përcaktuar në këtë Marrëveshje;

3.3.2 jetë e shtypur në kushte sigurie, në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme ligjore dhe të bursës;

3.3.3 ketë një numër unik vërtetimi të printuar në të;

3.3.4 ekzekutohet me dorë ose me faks nga ose në emër të Emetuesit dhe të vërtetohet me dorë nga ose në emër të Agjentit Fiskal; dhe

3.3.5 të jetë në ndonjë formë tjetër në përputhje me formatin e specifikuar herë pas here nga International Capital Market Association (Shoqata Ndërkombëtare e Tregut Kapital) ose ndonjë organ pasues të saj.

3.4 Nënshkrimet

Çdo nënshkrim në një Notë do të jetë i një personi që në kohën e krijimit dhe emetimit të Notave është një nënshkrues i autorizuar për këtë qëllim i Emetuesit pavarësisht se ky person për ndonjë arsye (duke përfshirë vdekjen) ka pushuar së qeni një nënshkrues i autorizuar në kohën kur është dorëzuar kjo Notë.

3.5 Disponueshmëria

Emetuesi do të kujdeset që Nota e pavërtetuar e Përhershme Globale të vihet në dispozicion ose to the order të Agjentit Fiskal jo më vonë se 10 ditë para Datës së Shkëmbimit. Nëse Emetuesit i kërkohet të dorëzojë Nota Definitive sipas termave të Notës së Përhershme Globale, Emetuesi do të kujdeset që EURO [•] në shumën e përgjithshme principale të Notave të pavërtetuara Definitive të vihen në dispozicion ose me urdhër të Agjentit Fiskal sa më parë që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 30 ditë pasi Zotëruesi i Notës së Përhershme Globale të ketë kërkuar shkëmbimin e saj për Notat Definitive. Emetuesi gjithashtu do të kujdeset që këto Nota të Përkohshme Globale, Nota të Përhershme Globale, Nota dhe Kupona Definitive që kërkohen t'i japin mundësinë Agjentit Zëvendësues të përmbushë detyrimet e tij sipas paragrafit 5 (Notat dhe Kuponat Zëvendësuese) për t'u vënë në dispozicion ose herë pas here, me urdhër të Agjentit të Zëvendësimit.

3.6 Detyrat e Agjentit Fiskal dhe Agjentit Zëvendësues

Agjenti Fiskal dhe Agjenti Zëvendësues, secili, do të mbajë në kontroll kujdestari të gjitha Notat e Pavërtetuara të Përkohshme Globale, Nota të Përhershme Globale, Nota dhe Kupona Definitive të dorëzuara atij në përputhje me paragrafin 3.5 (Disponueshmëria) dhe do të sigurojë që ato të vërtetohen (në

rastin e Notave të Përkohshme Globale, Notave të Përhershme Globale, dhe Notave Definitive) dhe të dorëzohen vetëm në përputhje me termat e saj, Kushteve dhe Notës së Përkohshme Globale (sipas rastit) të Notës së Përhershme Globale.

3.7 Autoriteti për të vërtetuar

Agjenti Fiskal dhe Agjenti Zëvendësues, secili, është i autorizuar nga Emetuesi të vërtetojë Notën e Përkohshme Globale dhe Notën e Përhershme Globale, çdo zëvendësim të tyre dhe çdo Notë Definitive nga nënshkrimi i ndonjë prej zyrtarëve të tij ose çdo personi tjetër të autorizuar rregullisht për këtë qëllim nga Agjenti Fiskal ose (sipas rastit) nga Agjenti Zëvendësues.

4. DORËZIMI I NOTËS SË PËRHERSHME GLOBALE DHE NOTAVE DEFINITIVE

4.1 Dorëzimi i Notës së Përhershme Globale

Në bazë të marrjes nga Agjenti Fiskal të Notës së Përhershme Globale në përputhje me paragrafin 3.5 (Disponueshmëria), Agjenti Fiskal, kundrejt prezantimit ose (sipas rastit) dorëzimit ndaj tij ose, me urdhrin e tij, të Notës së Përkohshme Globale dhe në përputhje me termat e saj, do të vërtetojë dhe i dorëzojë Zotëruesit të Notës së Përkohshme Globale Notën e Përhershme Globale në shumën e përgjithshme të principalit të kërkuar nga termat e Notës së Përkohshme Globale, ose nëse Nota e Përhershme Globale tashmë është emetuar në shkëmbim për vetëm ndonjë pjesë të Notës së Përkohshme Globale, do të sigurojë që kjo shumë e përgjithshme e principalit të shënohet në skedul në Notën e Përhershme Globale dhe të sigurojë nënshkrimin e këtij shënimi në emër të tij.

4.2 Shkëmbimi i Notës së Përkohshme Globale dhe Notës së Përhershme Globale

Në çdo rast në të cilin Nota e Përhershme Globale dorëzohet sipas paragrafit 4.1 (Dorëzimi i Notës së Përhershme Globale) ose është bërë një shkëmbim i mëtejshëm i interesave në Notën e Përkohshme Globale për interesa në Notën e Përhershme Globale, Agjenti Fiskal do të sigurojë që në skedulet përkatëse të Notës së Përkohshme Globale dhe Notës së Përhershme Globale të shënohet shuma e përgjithshme e principalit të interesave në Notën e Përhershme Globale të dorëzuar ("shuma përkatëse e principalit"), shuma e re e përgjithshme e principalit të Notës së Përhershme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj plus shuma përkatëse e principalit) dhe shuma e mbetur e principalit të Notës së Përkohshme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj minus shumën përkatëse të principalit) dhe do të sigurojë nënshkrimin e secilit prej këtyre shënimeve në emër të tij. Agjenti Fiskal do të anulojë ose sigurojë anulimin e Notës së Përkohshme Globale kur dhe nëse ai ka bërë shkëmbim të plotë të saj për interesa në Notën e Përhershme Globale.

4.3 Dorëzimi i Notave Definitive

Në bazë të marrjes nga Agjenti Fiskal të Notave Definitive në përputhje me paragrafin 3.5 (Disponueshmëria), Agjenti Fiskal, kundrejt prezantimit ose (sipas rastit) dorëzimit ndaj tij ose me urdhër të tij, të Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale dhe në përputhje me termat e saj, do të vërtetojë dhe dorëzojë Notat Definitive në shumën e kërkuar të përgjithshme të principalit për Zotëruesin e Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale; megjithatë, me kusht që çdo Notë Definitive në kohën e dorëzimit të saj të ketë bashkëlidhur vetëm ato Kupona që do të sigurojnë që as nuk humbin, as nuk pësojnë rritje ndaj Zotëruesit të tyre.

4.4 Shkëmbimi i Notave të Përkohshme/të Përhershme Globale për Notat Definitive

Në çdo rast në të cilin Notat Definitive dorëzohen në shkëmbim për Notat e Përkohshme/të Përhershme Globale, Agjenti Fiskal do të sigurojë që në skedulin e Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale të shënohet shuma e përgjithshme e principalit të Notave Definitive të dorëzuara ("shuma përkatëse e principalit") dhe shuma e mbetur e principalit të Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj minus shumën përkatëse të principalit) dhe do të sigurojë nënshkrimin e çdo shënimi të tillë në emër të tij. Agjenti Fiskal do të anulojë ose sigurojë anulimin e Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale kur dhe nëse ka bërë shkëmbimin e plotë të tyre për Notat Definitive.

5. NOTAT DHE KUPONA ZËVENDËSUESE

5.1 Dorëzimi i Zëvendësimeve

Në bazë të marrjes së Notave të Përkohshme Globale, Notave të Përhershme Globale, Notave dhe Kuponave Definitive të mjaftueshme zëvendësuese, në përputhje me paragrafin 3.5 (Disponueshmëria), Agjenti Zëvendësues, me dhe në përputhje me udhëzimet e Emetuesit (udhëzimet e të cilit, mund të përfshijnë pa kufizim termat në lidhje me pagesat e shpenzimeve dhe evidencat, garancinë dhe dëmshpërblimin) do të vërtetojë (nëse është e nevojshme) dhe dorëzojë një Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë Definitive ose si zëvendësim për ndonjë Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë ose Kupon Definitiv që është i dëmtuar ose i deformuar ose që dyshohet të jetë shkatërruar, vjedhur ose humbur; megjithatë, me kusht që Agjenti Zëvendësues të mos dorëzojë

ndonjë Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë ose Kupon Definitiv si zëvendësim për ndonjë Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë ose Kupon Definitiv që është e dëmtuar ose e deformuar ndryshe sesa ndaj dorëzimit të tyre dhe nuk do të emetojë ndonjë Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë ose Kupon Definitive zëvendësuese, derisa kërkuesi t'i ketë dhënë Agjentit Zëvendësues ato të dhëna dhe dëmshpërblime që Emetuesi dhe/ose Agjenti Zëvendësues mund të kërkojë dhe të ketë paguar ato kosto dhe shpenzime që mund të lindin në lidhje me këtë zëvendësim.

5.2 Zëvendësimet që duhet të numërtohen

Çdo Notë e Përkohshme Globale, Notë e Përhershme Globale, Notë ose Kupon Zëvendësuese të dorëzuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të mbajë një vërtetim unik (sipas rastit) ose numër serial.

5.3 Anulimi i Notave të dëmtuara ose të deformuara

Agjenti Zëvendësues do të anulojë çdo Notë të Përkohshme Globale, Notë të Përhershme Globale, Notë ose Kupon Definitive të dëmtuar ose të deformuar që i është dorëzuar atij në lidhje me të cilin është paraqitur një zëvendësim.

5.4 Njoftimi

Agjenti Zëvendësues njofton Emetuesin dhe çdo Agjent tjetër Pagues për dorëzimin nga ana e tyre të ndonjë Note të Përkohshme Globale, Note të Përhershme Globale, Note ose Kuponi Definitiv zëvendësuese, duke specifikuar vërtetimin ose numrin serial të tyre dhe vërtetimin ose numrin serial (nëse ka një të tillë dhe nëse është bërë i njohur) të Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale, Notës ose Kuponit Definitiv që ai zëvendëson dhe konfirmon se Nota e Përkohshme Globale, Nota e Përhershme Globale, Nota ose Kuponi Definitiv që ai zëvendëson është anuluar dhe (nëse kjo ndodh) është shkatërruar në përputhje me paragrafin 8.8 (Shkatërrimi).

6. PAGESAT PËR AGJENTIN FISKAL

6.1 Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal

Me qëllim që të parashikojë pagesën e principalit dhe interesit në lidhje me Pagesat kur këto bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme, Emetuesi do t'i paguajë Agjentit fiskal në ose para datës që është një Ditë Bankare Lokale para datës në të cilën kjo pagesë bëhet e kërkueshme, një shumë të barabartë me shumën e principalit dhe/ose (sipas rastit) të interesit që bëhet i pagueshëm në lidhje me Notat në këtë datë.

6.2 Mënyra dhe koha e pagesës

Çdo shumë e pagueshme sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal) paguhet në mënyrë të pakushtëzuar nga transferta e kredisë në Euro dhe në të njëjtën ditë, lirisht të transferueshme, shlyer fonde jo më vonë se ora 10.00 paradite (koha e Europës Qendrore) në ditën përkatëse në këtë llogari me atë bankë që Agjenti Fiskal mund të specifikojë herë pas here me njoftim për Emetuesin për këtë qëllim. Para orës 10.00 paradite (Koha Lokale) në Ditën e dytë Bankare Lokale para datës së kërkueshme të secilës pagesë nga ai sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal), Emetuesi do të sigurojë që banka që kryen pagesën për të konfirmon me teleks të testuar ose mesazh SWIFT të vërtetuar për Agjentin Fiskal udhëzimet e pagesës në lidhje me këtë pagesë.

6.3 Përjashtimi i të drejtave të mbajtjes dhe interesit

Agjenti Fiskal do të jetë i autorizuar të trajtojë çdo shumë të paguar atij sipas këtij paragrafi 6 (Pagesat për Agjentin Fiskal) në të njëjtën mënyrë si shumat e tjera të paguara për të si bankier nga klientët e tij; megjithatë me kusht që:

6.3.1 të mos ushtrojë kundër Emetuesit ndonjë të drejtë mbajtjeje, të drejtë kompensimi ose pretendim të ngjashëm në lidhje me të; dhe

6.3.2 nuk do të jetë përgjegjës ndaj ndonjë personi për interes mbi të.

Asnjë shumë financiare e mbajtur nga ndonjë Agjent Pagues nuk duhet të veçohet përveç rasteve kur kërkohet me ligj.

6.4 Aplikimi nga Agjenti Fiskal

Agjenti Fiskal do të aplikojë çdo shumë të paguar atij si më poshtë, në përputhje me paragrafin 1 (Pagesat për Zotëruesit e Notave) dhe nuk do të jetë i detyruar të shlyejë ndonjë shumë të tillë nëse detyrimi për pagesat përkatëse nuk anulohet sipas kushtit 9 (Parashkrimi), dhe në këtë rast ai do të riimbursojë, me kërkesën me shkrim të Emetuesit, atë pjesë të kësaj shume që ka lidhje me këtë pagesë duke e paguar këtë me transfertë kredie në euro në atë llogari me bankën që Emetuesi, me anë të njoftimi për Agjentin Fiskal, ka specifikuar për këtë qëllim.

7. PAGESAT PËR ZOTËRUESIT E NOTAVE

7.1 Pagesat nga Agjentët Pagues

Secili Agjent Pagues që vepron nëpërmjet Zyrës së tij të Caktuar do të bëjë pagesat e principalit dhe interesit në lidhje me Notat në përputhje me kushtet (dhe në rast të Notës së Përkohshme Globale ose

Notës së Përhershme Globale, në përputhje me termat e tyre); megjithatë me kusht që:

7.1.1 Nëse ndonjë Notë ose Kupon Definitiv është paraqitur ose dorëzuar për pagesë për ndonjë Agjent Pagues dhe ky Agjent Pagues ka paraqitur një zëvendësim të tyre ose është njoftuar se ato janë zëvendësuar, ky Agjent Pagues do të njoftojë menjëherë Emetuesin për këtë paraqitje ose dorëzim dhe nuk do të kryejë pagesën ndaj tij derisa të udhëzohet për këtë nga Emetuesi dhe të ketë marrë shumën që duhet të paguhet në këtë mënyrë;

7.1.2 Agjenti Fiskal nuk është i detyruar (por do të ketë të drejtë) të bëjë pagesa të principalit ose interesit në lidhje me Kuponat, nëse nuk ka marrë shumën e plotë të ndonjë pagese të kërkueshme për të sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal);

7.1.3 Secili Agjent Pagues anulon çdo Notë ose Kupon Definitiv kundrejt dorëzimit që ka bërë pagesën e plotë dhe në rastin e një Agjenti Pagues të ndryshëm nga Agjenti Fiskal, do të dorëzojë çdo Notë ose Kupon Definitiv të anuluar në këtë mënyrë nga ai për ose me urdhër të Agjentit Fiskal;

7.1.4 Në rast të pagesës së principalit ose interesit kundrejt paraqitjes së Notës së Përkohshme Globale ose Notës së Përhershme Globale, Agjenti Pagues përkatës do të sigurojë që në skedulin e Notës së Përkohshme Globale ose (sipas rastit) të Notës së Përhershme Globale, të shënojë shumën e kësaj pagese dhe në rast të pagesës së principalit, shumën e mbetur të principalit të Notës së Përhershme Globale ose (sipas rastit) të Notës së Përhershme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj minus shumën e principalit në atë kohë të paguar) dhe do të sigurojë nënshkrimin e një shënimi të tillë në emër të tij; dhe

7.1.5 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, secili Agjent Pagues ka të drejtën të bëjë një zbritje ose mbajtje të ndonjë pagese që ai bën sipas kësaj Marrëveshjeje për ose në llogari të ndonjë takse, tatimi ose detyrimi të tashëm ose të ardhshëm nëse dhe në shkallën e kërkuar nga ligji i zbatueshëm, dhe në këtë rast Agjenti Pagues e kryen një pagesë të tillë pasi të jetë bërë kjo zbritje apo mbajtje dhe raporton për autoritetet përkatëse shumën e mbajtur ose zbritur në këtë mënyrë dhe (ii) interesi do te paguhet jashte Shteteve te Bashkuara ose pronave te saj.

7.2 Përjashtimi i të drejtave të mbajtjes dhe komisioneve

Asnjë Agjent Pagues nuk do të përjashtojë ndonjë të drejtë mbajtjeje, të drejtë kompensimi ose pretendim të ngjashëm ndaj ndonjë personi të cilit ai i bën ndonjë pagesë sipas paragrafit 7.1 (Pagesat nga Agjentët Pagues) në lidhje me të, dhe as ndonjë komision ose shpenzim nuk do të faturohet nga ai për ndonjë person në lidhje me të.

7.3 Riimbursimi nga Agjenti Fiskal

Nëse një Agjent Pagues i ndryshëm nga Agjenti Fiskal bën ndonjë pagesë në përputhje me paragrafin 7.1 (Pagesat nga Agjentët Pagues):

7.3.1 ai do të njoftojë Agjentin Fiskal për shumën e paguar në këtë mënyrë nga ai, çertifikatën ose numrin serial (nëse ka) të Notës së Përhershme Globale, Notës së Përhershme Globale, Notës ose Kuponit Definitive kundrejt paraqitjes ose dorëzimit të të cilës është bërë pagesa e principalit, ose të Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale ose Notës Definitive kundrejt paraqitjes ose dorëzimit të të cilës është bërë pagesa e interesit, dhe numrin e Kuponave me maturim kundrejt paraqitjes ose dorëzimit të të cilave është bërë pagesa e interesit; dhe

7.3.2 Në bazë të dhe në masën e pajtueshmërisë nga Emetuesi me paragrafin 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal) (qoftë në kohën e kërkueshme apo jo), Agjenti Fiskal do të paguajë atë Agjent Pagues nga fondet e marra nga ai sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal), nga transferta e kredisë në Euro dhe në të njëjtën ditë, lirisht të transferueshme, shlyer fonde në këtë llogari me bankën që ky Agjent Pagues, me anë të një njoftimi për Agjentin Fiskal, ka specifikuar për atë qëllim një shumë të barabartë me shumën e paguar në këtë mënyrë nga ai Agjent Pagues.

7.4 Caktimi i fondeve nga Agjenti Fiskal

Nëse Agjenti Fiskal kryen ndonjë pagesë në përputhje me paragrafin 7.1 (Pagesat nga Agjentët Pagues), ai do të jetë i autorizuar të caktojë ose mbajë për llogari të vet nga fondet e marra nga ai sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet t'i paguajë Agjentit Fiskal) një shumë të barabartë me shumën e paguar në këtë mënyrë nga ai.

7.5 Riimbursimi nga Emetuesi

Në bazë të nënparagrafëve 7.1.1 dhe 7.1.2 (Pagesat nga Agjentët Pagues), nëse një Agjent Pagues bën një pagesë në lidhje me Notat në ose datës së kërkueshme për këtë pagesë sipas kushteve në një kohë në të cilën Agjenti Fiskal nuk ka marrë shumën e plotë të pagesës përkatëse të kërkueshme për të sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal) dhe Agjenti Fiskal nuk është i aftë nga fondet e marra nga ai sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal) të riimbursojë këtë Agjent Pagues për këtë (qoftë me pagesë sipas paragrafit 7.3 (Riibursimi nga Agjenti Fiskal) ose caktim

apo mbajtje fondesh sipas paragrafit 7.4 (Caktimi i fondeve nga Agjenti Fiskal), Emetuesi herë pas here sipas kërkesës do t'i paguajë Agjentit Fiskal për llogari të këtij Agjenti Pagues:

7.5.1 shumën e paguar në këtë mënyrë nga ky Agjent Pagues dhe që nuk i është riimbursuar atij; dhe

7.5.2 interesin mbi këtë shumë nga data në të cilën ky Agjent Pagues ka bërë këtë pagesë deri në datën e riimbursimit të kësaj shume, plus një shume të mjaftueshme për të dëmshpërblyer këtë Agjent Pagues ndaj çdo kostoje, humbjeje ose shpenzimi që lind si rezultat i bërjes së kësaj pagese dhe mosmarrjes së riimbursimit të kësaj shume;

Megjithatë, me kusht që çdo pagesë e bërë sipas nënparagrafit 7.5.1 të përmbushë pro tanto detyrimet e Emetuesit ose sipas paragrafit 6.1 (Emetuesi që duhet të paguajë Agjentin Fiskal).

7.6 Interesi

Interesi do të rritet për qëllim të nënparagrafit 7.5.2 (Riimbursimi nga Emetuesi) (si pas dhe para vendimit) i barabarte me koston e Agjetnit Pagues per financimin e pageses plus 1% / vit, sipas certifikimit te Agjentit Fiskal. Ky interes do te llogaritet ne menyre te perditshme sipas tarifes vjetore.

7.7 Pagesa të pjesshme

Nëse në një kohë të caktuar dhe për ndonjë arsye, një Agjent Pagues bën një pagesë të pjesshme në lidhje me Notën e Përkohshme Globale, Nota e Përhershme Globale ose ndonjë Notë ose Kupon Definitiv të paraqitur atij për pagesë, ky Agjent Pagues do të shkruajë mbi të një deklaratë që tregon shumën dhe datën e kësaj pagese.

8. DETYRA TË NDRYSHME TË AGJENTËVE PAGUES

8.1 Të dhënat

Agjenti Fiskal:

8.1.1 mban të dhëna të Notës së Përkohshme Globale dhe Notës së Përhershme Globale dhe të të gjitha Notave dhe Kuponave Definitive të dorëzuara sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe të kompensimit, pagesës, anulimit, dëmtimit, deformimit, shkatërrimit, vjedhjes, humbjes ose zëvendësimit të dyshuar (dhe në rast të Notës së Përkohshme Globale, shkëmbimi i interesave të saj për interes në Notën e Përhershme Globale dhe në rast të Notës së Përhershme Globale, shkëmbimi i saj për Notat Definitive); megjithatë, me kusht që asnjë e dhënë nuk duhet të mbahet për numrat serialë të Kuponave, me përjashtim të numrave serialë të Kuponave për të cilat janë dorëzuar zëvendësime sipas paragrafit 5 (Notat dhe Kuponat Zëvendësuese) dhe Kuponat e pamaturuara që mungojnë në kohën e kompensimit ose anulimit në ndonjë formë tjetër të Notave përkatëse Definitive dhe për çdo pagesë të mëtejshme ndaj këtyre Kuponave;

8.1.2 mban të dhëna të të gjitha vërtetimeve të marra nga ai në përputhje me paragrafin 8.3 (Vërtetimi) ose dispozitat e Notës së Përkohshme Globale dhe të të gjitha konfirmimeve të marra nga ai në përputhje me paragrafin 8.4 (Anulimi); dhe

8.1.3 i vendos këto të dhëna në dispozicion për inspektim, në çdo kohë të arsyeshme, nga Emetuesi dhe Agjentë të tjerë Pagues.

8.2 Informacioni nga Agjentët Pagues

Agjentët pagues do t'i vënë në dispozicion Agjentit Fiskal atë informacion që mund të kërkohet për mbajtjen e të dhënave të përmendura në paragrafin 8.1 (Të Dhënat).

8.3 Vërtetimet

Çdo Agjent Pagues do të kopjojë menjëherë për Emetuesin dhe në rast të një Agjenti Pagues të ndryshëm nga Agjenti Fiskal, Agjenti Fiskal, çdo vërtetim të marrë nga ai në përputhje me dispozitat e Notës së Përkohshme Globale.

8.4 Anulimi

Emetuesi mund t'i dorëzojë herë pas here Agjentit Fiskal Nota dhe Kupona Definitive të pamaturuara në lidhje me to për anulim, dhe më pas Agjenti Fiskal do të anulojë këto Nota dhe Kupona Definitive. Për më tepër, Emetuesi mund të sigurojë herë pas here dorëzimin për Agjentin Fiskal të Notës së Përkohshme Globale ose Notës së Përhershme Globale me udhëzimet për të anuluar një shumë të specifikuar të përgjithshme principali të Notave të përfaqësuara nga ai (udhëzime që do të shoqërohen nga konfirmimi nga Euroclear ose Clearstream, Luksemburg që Notat të cilat kanë një shumë të tillë të përgjithshme principali mund të anulohen), më pas Agjenti Fiskal do të sigurojë që në skedulin e Notës së Përkohshme Globale ose (sipas rastit) në Notën e Përhershme Globale, të shënohet shuma e përgjithshme e principalit të Notave të anuluara në këtë mënyrë dhe shuma e mbetur e principalit të Notës së Përkohshme Globale ose (sipas rastit) të Notës së Përhershme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj minus shumën e përgjithshme të principalit të Notave të anuluara) dhe do të sigurojë nënshkrimin e këtij shënimi në emër të tij.

8.5 Notat dhe Kuponat Definitive specifike

Në rastin më të parë të mundshëm (dhe në çdo rast brenda tre muajve) pas çdo date pagese interesi në lidhje me Notat, pas çdo date në të cilën Notat janë anuluar në përputhje me paragrafin 8.4 (Anulimi) dhe pas çdo date në të cilën Notat bëhen të pagueshme për kompensim në përputhje me Kushtet, Agjenti Fiskal do të njoftojë Emetuesin dhe Agjentët e tjerë Pagues (mbi bazën e informacionit që i është vënë në dispozicion) për numrin e çdo Note ose Kuponi Definitiv kundrejt dorëzimit të të cilës është bërë pagesa dhe për numrin e çdo Note Definitive ose (sipas rastit) Kuponi që nuk është dorëzuar ende për pagesë.

8.6 Përcjellja e komunikimeve

Agjenti Fiskal do të përcjellë menjëherë për Emetuesin një kopje të një njoftimi ose komunikimi të drejtuar Emetuesit nga çdo Zotërues Notash, që është marrë nga Agjenti Fiskal.

8.7 Publikimi i njoftimeve

Agjenti Fiskal, me dhe në përputhje me udhëzimet e Emetuesit të marra të paktën 10 ditë para datës së publikimit të propozuar, do të kujdeset për publikimin e çdo njoftimi që duhet t'i jepet Zotëruesve të Notave dhe do t'i japë një kopje të tyre çdo Agjenti tjetër Pagues, Euroclear, Clearstream, Luksemburg dhe çdo autoriteti kompetent, sistemi burse dhe/ose kuotimi me anë të të cilit Notat janë pranuar për regjistrim, tregtim dhe/ose kuotim.

8.8 Shkatërrimi

Agjenti Fiskal mund të shkatërrojë Notën e Përkohshme Globale pas anulimit të saj në përputhje me Paragrafin 4.2 (Shkëmbimi i Notës së Përkohshme Globale dhe Notës së Përhershme Globale) dhe Notës së Përkohshme/të Përhershme Globale pas anulimit të saj në përputhje me paragrafin 4.4 (Shkëmbimi i Notës Globale [Të Përkohshme/të Përhershme] për Notat Definitive) dhe Notës së Përkohshme Globale dhe Notës së Përhershme Globale dhe çdo Note ose Kuponi Definitiv të dorëzuar për ose të anuluar nga ai në përputhje me nënparagrafin 7.1.3 (Pagesat nga Agjentët Pagues) ose të anuluar nga ai në përputhje me paragrafin 5.3 (Anulimi i Notave të dëmtuara ose të deformuara) ose paragrafin 8.4 Anulimi), dhe në këtë rast ai do t'i japë Emetuesit një çertifikatë të shkatërrimit që specifikon çertifikatën ose numrat serialë (nëse ka) të Notës së Përkohshme Globale ose (sipas rastit)] të Notës së Përhershme Globale ose Notave Definitive dhe numrin e Kuponave të shkatërruara.

8.9 Dokumentet e disponueshme për inspektim

Emetuesi do t'i japë secilit Agjent Pagues:

8.9.1 kopje të vërtetuara të kësaj marrëveshjeje dhe Akt Marrëveshjeje; dhe

8.9.2 ato dokumente të tjera që mund të kërkohen herë pas here nga Bursa e Londrës për t'u vënë në dispozicion të Zyrës së Caktuar të Agjentit Pagues që ka Zyrën e tij të Caktuar në Londër.

Secili prej Agjentëve Pagues do të vërë në dispozicion për inspektim gjatë orëve normale të punës në Zyrën e tij të Caktuar dokumentet e përmendura më sipër dhe në bazë të kërkesës së arsyeshme, do të lejojë marrjen e kopjeve të këtyre dokumenteve.

8.10 Çertifikatat e votimit dhe udhëzimet për votimin në bazë të numrit të anëtarëve.

Çdo Agjent Pagues, me kërkesë të çdo Zotëruesi Notash, do të lëshojë certifikata votimi dhe udhëzime për votimin në bazë të numrit të anëtarëve në një formë dhe mënyrë që pajtohen me dispozitat e skedulit 5 (Dispozitat për takimet e Zotëruesve të Notave) (me përjashtim të rasteve që nuk do të kërkohet emetimi i tyre më pak se 48 orë para kohës së vendosur për çdo mbledhje të parashikuar në të). Çdo Agjent Pagues do të mbajë të dhëna të plota të certifikatave të votimit dhe udhëzimeve për votimin në bazë të numrit të anëtarëve të lëshuara nga ai dhe do t'i japë emetuesit jo më pak se 24 orë para kohës së caktuar për çdo mbledhje, të dhëna të plota të të gjitha certifikave të votimit dhe udhëzimeve për votimin në bazë të numrit të anëtarëve të lëshuara nga ai në lidhje me këtë mbledhje.

9. TARIFAT DHE SHPENZIMET

9.1 Tarifat

Emetuesi do t'i paguajë Agjentit Fiskal për llogari të Agjentëve Pagues ato tarifa që janë rënë dakord vecmas ndërmjet Emetuesit dhe Agjentit Fiskal [dhe të regjistruara me shkresën e datës [•] 2010 nga Agjenti Fiskal për Emetuesin] në lidhje me shërbimet e Agjentëve Pagues sipas kësaj Marrëveshjeje (plus çdo taksë të zbatueshme mbi vlerën e shtuar).

9.2 Shpenzimet Fillestare

Sipas kërkesës, Emetuesi do të riimbursojë Agjentin Fiskal për të gjitha shpenzimet e shkaktuara nga ai në negocimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas kërkesës, do të riimbursojë çdo Agjent Pagues për të gjitha shpenzimet (duke përfshirë pa kufizim, tarifat ligjore dhe çdo shpenzim për publikimin, reklamimin, komunikimin, korrierin, postimin dhe shpenzime të tjera jashtë fondit) të lindura në lidhje me shërbimet tij sipas kësaj Marrëveshjeje (plus çdo taksë të zbatueshme mbi vlerën e shtuar)[të ndryshme nga ato kosto dhe shpenzime që janë rënë dakord veçmas të riimbursohen nga tarifat e pagueshme sipas paragrafit 9.1 (Tarifat).

9.3 Taksat

Emetuesi do të paguajë të gjitha taksat e pullave, regjistrimit dhe taksa dhe tatime të tjera (duke përfshirë çdo interes dhe penalitet mbi to ose në lidhje me to) që janë të pagueshme pas ose në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Emetuesi do të dëmshpërblejë çdo Agjent Pagues sipas kërkesës kundër çdo pretendimi, kërkese, veprimi, përgjegjësie, dëmtimi, kostoje, humbjeje ose shpenzimi (duke përfshirë pa kufizim, tarifat ligjore dhe çdo taksë të zbatueshme mbi vlerën e shtuar) që lind si rezultat ose që lind nga ose në lidhje me çdo paaftësi pagese ose vonesë në pagimin e tyre. Të gjitha pagesat nga Emetuesi sipas këtij paragrafi 9 (Tarifat dhe Shpenzimet) ose paragrafit 10.4 (Dëmshpërblimi në favor të Agjentëve Pagues) do të bëhen të lira dhe të çliruara, dhe pa mbajtje ose zbritje për ndonjë taksë, tatim, detyrim ose pagesë qeveritare të çfarëdolloj natyre të vendosur, vjelur, mbledhur, mbajtur ose caktuar nga Republika e Shqipërisë ose ndonjë nënndarje politike ose autoritet i saj ose në të që ka pushtetin për të tatuar, nëse kjo mbajtje ose zbritje nuk kërkohet me ligj. Në këtë rast, Emetuesi do të paguajë këto shuma shtesë që do të rezultojnë në marrjen nga Agjenti përkatës pagues të atyre shumave që do të ishin marrë nga ai nëse nuk do të ishte kërkuar asnjë mbajtje ose zbritje e tillë.

10. TERMAT E CAKTIMIT

10.1 Të drejtat dhe kompetencat

Secili Agjent Pagues, në lidhje me shërbimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje:

10.1.1 përveç rasteve kur urdhërohet nga një gjykatë e juridiksionit kompetent ose kërkohet ndryshe me ligj dhe pavarësisht ndonjë njoftimi pronësie, trusti ose interesi tjetër në të, çdo shënim mbi të se çdo njoftimi të ndonjë humbjeje ose vjedhjeje të mëparshme të saj, por në bazë të nënparagrafit 7.1.1 (Pagesat nga Agjentët Pagues), mund të trajtojë Zotëruesin e një Note të Përkohshme Globale, Note të Përhershme Globale, Note ose Kuponi definitiv si zotëruesin e saj absolut për të gjitha qëllimet dhe për rrjedhojë të bëjë pagesat në lidhje me to;

10.1.2 të supozojë që termat e Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale dhe çdo Note dhe Kuponi Definitiv të emetuar, janë të sakta;

10.1.3 të referojë çdo çështje në lidhje me zotërimin e Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale ose çdo Note ose Kuponi Definitiv ose mjaftueshmërinë e çdo të dhëne të paraqitur në lidhje me zëvendësimin e Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale ose çdo Note ose Kuponi Definitiv për Emetuesin për përcaktimin nga Emetuesi dhe të mbështetet në përcaktimin e bërë në këtë mënyrë;

10.1.4 të mbështetet në dhe do të mbrohet nga çdo përgjegjësi për të vepruar në bazë të termave të një njoftimi, komunikimi ose dokumenti tjetër që besohet nga ai të jetë origjinal dhe nga pala e duhur; dhe

10.1.5 të angazhojë dhe paguajë për konsulencë ose shërbime të një avokati ose ekspertëve të tjerë konsulenca ose shërbimet e të cilëve ai i çmon të nevojshme dhe mbështetet në këtë konsulencë të marrë (dhe ky Agjent Pagues do të mbrohet dhe nuk do të ketë përgjegjësi ndaj Emetuesit në lidhje me çdo veprim të marrë ose që lejohet të merret në përputhje me këtë konsulencë dhe në mirëbesim) dhe

10.1.6 te veproje si agjent i Emetuesit dhe te mos kete nevoje te shqetesohet per interesat e mbajtesve te Notave.

10.2 Masa e detyrave

Çdo Agjent Pagues do të jetë i detyruar të kryejë detyrat e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe detyra të tjera që janë domosdoshmërisht të shoqëruara me të dhe nuk do te kete detyra te nenkuptuara. Asnjë Agjent Pagues nuk do të:

10.2.1 jetë nën detyrën e administratorit të besuar ose nën ndonjë detyrim tjetër ose të ketë ndonjë marrëdhënie ndërmjetësimi ose besimi për ose me ndonjë person të ndryshëm nga Emetuesi; ose

10.2.2 të jetë përgjegjës në lidhje me ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Notës së Përkohshme Globale, Notës së Përhershme Globale ose ndonjë Note ose Kuponi Definitiv ose ndonjë veprimi ose mosveprimi të një personi tjetër (duke përfshirë pa kufizim çdo Agjent tjetër Pagues).

10.3 Liria për të kryer transaksione

Çdo Agjent Pagues mund të blejë, mbajë dhe shesë Nota dhe Kupona dhe mund të hyjë në transaksione (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë depozitë, trust ose transaksion ndërmjetësues) me ndonjë Zotërues të Notave ose Kuponave ose me ndonjë person tjetër në të njëjtën mënyrë sikur të mos ishte emëruar si agjent i Emetuesit në lidhje me Notat.

10.4 Dëmshpërblimi në favor të Agjentëve Pagues

Emetuesi do të dëmshpërblejë çdo Agjent Pagues dhe zyrtaret, drejtuesit ose punonjesit e tij ndaj çdo pretendimi, kërkese, veprimi, përgjegjësie, dëmtimi, kostoje, humbjeje ose shpenzimi (duke përfshirë pa kufizim tarifat ligjore dhe çdo taksë të zbatueshme mbi vlerën e shtuar) që shkakton [të ndryshme nga

ato kosto dhe shpenzime që miratohen veçmas për t'u riimbursuar nga tarifat e pagueshme sipas paragrafit 9.1 (Tarifat) dhe] përveç për shkak të pakujdesisë së vet ose, mosplotësimit të detyrave ose mashtrimit, si rezultat i ose që lindin nga ose në lidhje me veprimin e tij si agjent i Emetuesit në lidhje me Notat. Pavarësisht nga sa më sipër, në asnjë rrethanë Agjenti Pagues nuk do të jetë përgjegjës ndaj Emetuesit ose çdo pale tjetër të kësaj Marrëveshjeje për ndonjë humbje rrjedhuese (që është humbje e biznesit, klientelës, mundësisë për fitim), edhe nëse ka informuar për mundësinë e kësaj humbjeje ose dëmtimi. Dëmshpërblimi në përmbajtje të këtij paragrafi 10.4 do të vazhdojë edhe pas përfundimit ose skadimit të kësaj Marrëveshjeje.

10.5 Kufizimet e pergjegjesisë

Agjentet Pagues nuk jane pergjegjes per humbjet e shkaktuara nga ngjarje jashte kontrollit te tyre te arsyeshem, perfshire defektet, nderprerjet ose gabimet ne transmetimin e informacionit, te shkaktuara nga makineri ose sisteme ose nderprerjet e komunikimit, operacione ne kushte anormale, ose raste te Forcës Madhore.

Agjentet Pagues nuk do te jene, nen asnje rrethane, pergjegjes ndaj Emetuesit ne kontrate, gabim (perfshire neglizhim) ose ndryshe per cdo humbje pasuese, te vecante, direkte ose spekulative, ose deme (perfshire por je vetem humbje te biznesit, vullnetit te mire, mundesise ose fitimit) te cilat vijne si pasoje ose ne lidhje me kete Marreveshje edhe pse ka patur keshillim per mundesine e ketyre demve ose humbjeve.

10.6 Dëmshpërblimi në favor të Emetuesit

Çdo Agjent Pagues do të dëmshpërblejë individualisht Emetuesin ndaj çdo pretendimi, kërkese, veprimi, përgjegjësie, dëmtimi, kostoje, humbjeje ose shpenzimi (duke përfshirë pa kufizim tarifa ligjore dhe çdo taksë të zbatueshme mbi vlerën e shtuar) që lind nga pakujdesia ose sjellja e papërshtatshme e këtij Agjenti Pagues ose e zyrtarëve, drejtuesve ose punonjësve të tij.

10.7 Vazhdimësia e dëmshpërblimeve

Dëmshpërblimet e përfshira në këtë Marrëveshje do të vazhdojnë edhe pas përfundimit ose skadimit të kësaj Marrëveshjeje.

11. NDRYSHIMET NË AGJENTËT PAGUES

11.1 Dorëheqja

Çdo Agjent Pagues mund të heqë dorë nga emërimi i tij pas një njoftimi prej jo më pak se 30 ditësh para për Emetuesin (me një kopje, në rastin e një Agjenti Pagues të ndryshëm nga Agjenti Fiskal, për Agjentin Fiskal); megjithatë, me kusht që:

11.1.1 nëse kjo dorëheqje nuk do të kishte hyrë në fuqi ndryshe më pak se 30 ditë para ose pas datës së maturitetit ose një date tjetër për kompensimin e Notave ose ndonjë date të pagesës së interesit në lidhje me Notat, ajo nuk do të hyjë në fuqi deri në ditën e tridhjetë pas kësaj date; dhe

11.1.2 në rastin e Agjentit Fiskal ose një Agjenti të Kërkuar Pagues, kjo dorëheqje nuk do të hyjë në fuqi derisa të jetë emëruar rregullisht një pasardhës në përputhje me paragrafin 11.4 (Agjentë shtesë dhe pasardhës) ose paragrafin 11.5 (Agjentët Pagues mund të emërojnë pasardhësit) dhe njoftimi i këtij emërimi t'i jetë dhënë Zotëruesve të Notave.

11.2 Revokimi

Emetuesi mund të revokojë emërimin nga ana e tij të ndonjë Agjenti Pagues me një njoftim jo më pak se 30 ditë para për atë Agjent Pagues (me një kopje në rastin e një Agjenti pagues të ndryshëm nga Agjenti Fiskal, për Agjentin Fiskal); megjithatë, me kusht që në rastin e Agjentit Fiskal ose ndonjë Agjenti të kërkuar Pagues, ky revokim nuk do të hyjë në fuqi derisa një pasardhës të jetë emëruar rregullisht në përputhje me paragrafin 11.5 (Agjentët Pagues mund të emërojnë pasardhës) dhe njoftimi i këtij emërimi t'i jetë dhënë Zotëruesve të Notave.

11.3 Përfundimi automatik

Emërimi i një Agjenti Pagues do të përfundojë menjëherë nëse (a) ky Agjent Pagues bëhet i paaftë për të vepruar, (b) një palë e siguruar merr në zotërim, ose një marrës, menaxher ose zyrtar tjetër i ngjashëm është emëruar, të të gjithë ose një pjese të sipërmarrjes, aseteve dhe të ardhurave të këtij Agjenti Pagues, (c) ky Agjent Pagues pranon me shkrim paaftësinë e tij paguese ose paaftësinë për të paguar borxhet e tij kur ato bëhen të pagueshme, (d) një administrator ose likuidues i këtij Agjenti Pagues ose i të gjithë ose një pjese të sipërmarrjes, aseteve dhe të ardhurave të këtij Agjenti Pagues emërohet (ose është bërë aplikimi për një emërim të tillë), (e) ky Agjent Pagues merr masa për një rirregullim ose shtyrje të ndonjë prej detyrimeve të tij ose bën një përcaktim ose rregullim ose përbërje të përgjithshme me ose për interesin e kreditorëve të tij ose deklaron një moratorium në lidhje me ndonjë nga situatat e të qenurit në

borxh, (f) është bërë një urdhër ose ka kaluar një rezolutë efektive për shpërndarjen e këtij Agjenti Pagues ose (g) ndodh një ngjarje që ka një efekt të ngjashëm në ndonjë nga pikat e mësipërme. Nëse emërimi i Agjentit Fiskal ose ndonjë Agjenti të kërkuar Pagues përfundon në përputhje me fjalinë pararendëse, Emetuesi do të emërojë menjëherë një pasardhës në përputhje me paragrafin 11.4 (Agjentët shtesë dhe pasardhës).

11.4 Agjentët shtesë dhe pasardhës

Emetuesi mund të emërojë një agjent fiskal pasardhës dhe agjent pagues shtesë ose pasardhës dhe do t'i japë menjëherë njoftim për ndonjë prej këtyre emërimeve Agjentëve vazhdues Pagues dhe Zotëruesve të Notave, dhe më pas Emetuesi, Agjentët vazhdues Pagues dhe agjenti fiskal ose agjenti pagues shtesë ose pasardhës, do të fitojnë dhe i nënshtrohen të drejtave dhe detyrimeve të njëjta midis tyre sikur të kishin hyrë në një marrëveshje në formën *mutatis mutandis* të kësaj Marrëveshjeje.

11.5 Agjentët Pagues mund të emërojnë pasardhës

Nëse Agjenti Fiskal ose ndonjë Agjent i Kërkuar Pagues jep njoftim për dorëheqjen e tij në përputhje me paragrafin 11.1 (Dorëheqja) dhe deri në ditën e dhjetë para skadimit të këtij njoftimi një pasardhës nuk është emëruar rregullisht në përputhje me paragrafin 11.4 (Agjentët shtesë dhe pasardhës), Agjenti Fiskal ose (sipas rastit) Agjenti i Kërkuar Pagues, pas konsultimit me Emetuesin siç është e zbatueshme në rrethana të caktuara, mund të emërojë vetë si pasardhësin e tij ndonjë institucion financiar të njohur dhe me përvojë dhe t'i japë njoftim për këtë emërim Emetuesit, Agjentëve të mbetur Pagues dhe Zotëruesve të Notave, dhe më pas Emetuesi, Agjentët e mbetur Pagues dhe ky pasardhës do të marrin dhe i nënshtrohen të drejtave dhe detyrimeve të njëjta midis tyre sikur të kishin hyrë në një marrëveshje në formën mutatis mutandis të kësaj Marrëveshjeje.

11.6 Lirimi

Pas çdo dorëheqjeje ose revokimi që hyn në fuqi sipas Paragrafit 11.1 (Dorëheqja) ose 11.2 (Revokimi) ose çdo përfundimi që hyn në fuqi sipas paragrafit 11.3 (Përfundimi automatik), Agjenti Pagues përkatës do të:

11.6.1 lirohet dhe shkarkohet nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç se do të vazhdojë të ketë të drejtën e përfitimit dhe në bazë të paragrafit 9.3 (Taksat), paragrafit 10 (Termat e Emërimit) dhe paragrafit 11 (Ndryshimet në Agjentët Pagues));

11.6.2 në rastin e Agjentit Fiskal, do t'i japë Emetuesit dhe pasardhësit të tij një kopje të vërtetuar me origjinalin dhe të përditësuar nga një zyrtar ose nënshkrues i autorizuar i Agjentit Fiskal, të të dhënave të mbajtura nga ai në përputhje me paragrafin 8.1 (Të Dhënat; dhe

11.6.3 menjëherë (pas pagesës ndaj tij të ndonjë shume të kërkueshme për të në përputhje me paragrafin 9 (Tarifat dhe Shpenzimet) [ose paragrafit 10.4 (Dëmshpërblimi në favor të Agjentëve Pagues)] do të transferojë të gjitha paratë dhe letrat me vlerë (duke përfshirë çdo Notë të paemetuar të mbajtur nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo dokumenti të mbajtur nga ai sipas paragrafit 8.9 (Dokumentet e disponueshme për inspektim)) për pasardhësin e tij dhe, pas njoftimit të përshtatshëm, të ofrojë asistencë të arsyeshme për pasardhësin e tij për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.7 Shkrirja

Çdo subjekt ligjor në të cilin çdo Agjent Pagues shkrihet ose shndërrohet ose çdo subjekt ligjor që rezulton nga ndonjë shkrirje ose shndërrim në të cilin ky Agjent Pagues është palë ose çdo subjekt ligjor të cilit çdo Agjent Pagues i shet të gjithë ose kryesisht të gjithë trustin e korporatës së tij dhe biznesin e agjencisë] në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm, do të jetë pasardhësi i këtij Agjenti Pagues pa ndonjë formalitet të mëtejshëm, dhe më pas Emetuesi, Agjentët e tjerë pagues dhe ndonjë pasardhës i tillë do të fitojë dhe i nënshtrohet të drejtave dhe detyrimeve të njëjta midis tyre sikur të kishin hyrë në një marrëveshje në formën mutatis mutandis të kësaj Marrëveshjeje. Njoftimi i një shkrirjeje ose shndërrimi të tillë do t'i jepet menjëherë nga ky pasardhës Emetuesit, Agjentëve të tjerë Pagues dhe Zotëruesve të Notave.

11.8 Ndryshimet në Zyrat e Përcaktuara

Nëse ndonjë Agjent pagues vendos të ndryshojë Zyrën e tij të Caktuar (që mund të kryhet vetëm brenda të njëjtit qytet nëse nuk është marrë miratimi paraprak me shkrim i Emetuesit), ai do të njoftojë Emetuesin (me një kopje për Agjentët e tjerë Pagues) për adresën e Zyrës së re të Caktuar duke deklaruar datën në të cilën realizohet ky ndryshim, dhe kjo datë nuk do të jetë më pak se 30 ditë pas datës së këtij njoftimi. Emetuesi, me shpenzimet e veta dhe jo më pak se 14 ditë para datës në të cilën duhet të ndodhë ky ndryshim (nëse emërimi i Agjentit përkatës Pagues duhet të përfundojë sipas ndonjë prej dispozitave të mësipërme të këtij paragrafi 11 (Ndryshime në Agjentët Pagues) në ose para datës së këtij ndryshimi) do të

njoftojë në lidhje me këtë Zotëruesit e Notave.

12. NJOFTIMET

12.1 Adresat për njoftime

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim (me letër ose faks) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

12.1.1 nëse i dërgohet Emetuesit, në adresën:

Ministria e Financave
Blv. "Deshmoret e Kombit", Nr 1
Tirana
Albania
Faks: +355 422 28494 [•]

Në vëmendje të: Z. Ridvan Mode, Minister i Financave

12.1.2 nëse i drejtohet një Agjenti Pagues, i dërgohet atij në adresën ose numrin e faksit të specifikuar kundrejt emrit të tij në skedulin 6 (Zyrat e Caktuara të Agjentëve Pagues) (ose në rastin e një Agjenti Pagues që fillimisht nuk ka qenë palë e kësaj Marrëveshjeje, të specifikuar me njoftim për palët e kësaj Marrëveshjeje në kohën e emërimit të tij) në vëmendje të personit ose departamentit të specifikuar në të;

ose, në çdo rast, në ndonjë adresë ose numër faksi tjetër ose në vëmendje të ndonjë personi ose departamenti tjetër që marrësi me anë të një njoftimi paraprak ndaj dërguesit ka specifikuar për këtë qëllim.

12.2 Hyrja në fuqi

Çdo njoftim ose komunikim i dërguar në përputhje me paragrafin 12.1 (Adresat për njoftime) do të hyjë në fuqi, nëse dërgohet me letër ose faks me marrjen nga marrësi, megjithatë, me kusht që çdo njoftim ose komunikim i tillë që do të hynte në fuqi pas orës 4. 00 pasdite në ndonjë ditë specifike, nuk do të hyjë në fuqi deri në orën 10.00 paradite në ditën e punës që bie menjëherë pas kësaj date, në vendin e marrësit.

12.3 Njoftime për Zotëruesit e Notave

Çdo njoftim i kërkuar për t'iu dhënë Zotëruesve të Notave sipas kësaj Marrëveshjeje do të jepet në përputhje me Kushtet dhe me shpenzimet e Emetuesit; megjithatë, me kusht që, për aq kohë që të gjitha Notat përfaqësohen nga Nota e Përkohshme Globale dhe/ose Nota e Përhershme Globale, njoftimet për Zotëruesit e Notave do të jepen në përputhje me termat e Notës së Përkohshme Globale dhe/ose Notës së Përhershme Globale.

12.4 Njoftimet në gjuhën angleze

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në gjuhën angleze ose do të shoqërohen nga një përkthim i vërtetuar i tyre në gjuhën angleze. Çdo përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze sipas kësaj Marrëveshjeje do të vërtetohet si përkthim i saktë dhe i vërtetuar nga një përkthyes profesionist i kualifikuar ose nga ndonjë person tjetër kompetent.

13. LIGJI DREJTUES

Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me të rregullohet nga ligji anglez.

14. ARBITRAZHI

14.1 Arbitrazhi

Në pajtim me kushtin 14.5 (Opsioni i Agjenteve Pagues), çdo mosmarrëveshje ("Mosmarrëveshje") që rrjedh nga ose në lidhje me Notat (duke përfshirë çdo detyrim jokontraktor që rrjedh nga ose në lidhje me Notat) i referohet arbitrazhit në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar (LCIA), dhe këto rregulla konsiderohen të përfshihen nëpërmjet referencës në këtë Kusht.

14.2 Formimi i gjykatës së arbitrazhit, selia dhe gjuha e arbitrazhit

Formimi i gjykatës së arbitrazhit: Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra, secili prej të cilëve nuk ka interes në mosmarrëveshje dhe nuk ka lidhje me asnjë palë dhe është një jurist me eksperiencë në veprimet e titujve ndërkombëtare. Secila palë cakton një arbitër të cilët caktojnë Kryetarin e Gjykatës. Nëse një mosmarrëveshje, pretendim apo shkak për padi përfshin më shumë se dy palë, palët përpiqen të pozicionohen në dy anë (d.m.th, paditës dhe i paditur) ku secili cakton një arbitër sikur të ishin dy palë në mosmarrëveshje, pretendim apo shkak për padi. nëse kjo vendosja dhe caktim nuk bahet për tridhjetë (30) ditë kalendarike pasi pala paditëse bën kërkesën për arbitrazh, ose nëse një Kryetar nuk është zgjedhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga zgjedhja e arbitrit të dytë, Gjykata e Arbitrazhit e Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar cakton tre arbitra ose kryetarin, sipas rastit. Palët dhe gjykata e

Arbitrazhit mund të caktojë arbitra nga shtetasit e çdo vendi, pavarësisht nëse një palë është shtetas i atij vendi. Arbitrat nuk kanë autoritet për të dhënë vendime zhdëmtimi si dënim dhe në asnjë rast nuk mund të vendosë apo bëjë konstatime në kundërshtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

14.2.2 Selia e arbitrazhit: Selia e arbitrazhit është Londra, Angli dhe të gjitha seancat janë në Londër, Angli.

14.2.3 Gjuha e arbitrazhit: Gjuha e arbitrazhit është anglishtja.

14.3 Tarifat

Tarifat e arbitrazhit (duke përjashtuar përgatitjen e çdo pale, udhëtimin, tarifat e avokatëve dhe koston e ngjashme) mbulohet në pajtim me vendimin e arbitrave. Vendimi i arbitrave është përfundimtar, detyrues dhe i ekzekutueshëm për palët dhe vendimi mbi çdo vendim arbitrazhi mund të konfirmohet në çdo gjykatë që juridiksion mbi të.

14.4 Rekursi në Gjykatë

Për qëllimet e arbitrazhit në pajtim me kushtin 14 (Arbitrazhi), Emetuesi dhe Zotëruesit e Notave përjashtojnë juridiksionin e Gjykatave sipas seksioneve 45 dhe 69 të Ligjit të Arbitrazhit të vitit 1996.

14.5 Opsioni i Agjenteve Pagues

Ne çdo kohe, perpara se nje Agjent Pagues te kete emeruar nje arbiter qe te zgjidhe mosmarreveshjet lidhur me nenin 14.1 (Arbitrazhi), Agjenti Pagues, si opsion te vetem te tijin mund te zgjedhe permes nje lajmerimi me shkrim qe kjo Mosmarreveshje do te degjohet nga gjykata angleze ose nga cilado gjykate me kompetence juridiksioni, siç eshte pershkruar me ne detaje ne nenin 15.3 (E drejta e Llogarimbajtesit per ta çuar proceduren jashte Anglise). Pas keasj zgjedhje, gjyqi i arbitrazhit nuk do te kete juridiksion lidhur me mosmarreveshjen.

15. GJYKATA ANGLEZE

Në rast se një Agjent Pagues leshon një njoftim në pajtim me kushtin 14.5 (Opsioni i Agjent Pagues), zbatohen dispozitat e mëposhtme në këtë kusht 15 (Gjykatat Angleze).

15.1 Juridiksioni

Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur ndonjë mosmarrëveshje (një "Mosmarrëveshje"), që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj Marrëeshjeje ose ndonjë detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje) ose pasojat e pavlefshmërisë së saj.

15.2 Forumi i përshtatshëm

Palët bien dakord që gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme dhe të duhura për të zgjidhur ndonjë Mosmarrëveshje dhe për pasojë, që ato nuk do të argumentojnë për të kundërtën.

15.3 Të Drejtat e Agjentëve Pagues për të filluar procedime jashtë Anglisë

Paragrafi 15 (Gjykatat Angleze) është vetëm në interes të Agjentëve Pagues. Si rezultat, asgjë në këtë paragraf 14 (Ligji dhe Juridiksioni) nuk pengon Agjentët Pagues të nisin procedime në lidhje me një Mosmarrëveshje ("Procedimet") në ndonjë gjykatë tjetër me juridiksion. Në masën e lejuar me ligj, Agjentët Pagues mund të nisin Procedime të njëkohshme në disa juridiksione.

15.4 Dorëzimi i dokumenteve

Emetuesi bie dakord që dokumentet mbi të cilat fillohet një Procedim dhe çdo dokument tjetër që kërkohet të dërgohet në lidhje me ato Procedime mund t'i dërgohet atij duke iu dërguar Emetuesit tek Law Debenture Corporate Sevices Limited, kati i 5, 100 wood Street, London EC2V 7EX, Angli. Nëse ky person nuk është ose pushon së qenuri i caktuar efektivisht për të pranuar dhënien e njoftimit në emër të Emetuesit, Emetuesi, në bazë të një kërkese me shkrim të një Agjenti Pagues të drejtuar për Emetuesin dhe të dorëzuar Emetuesit, do të caktojë një person tjetër në Angli për të pranuar dhënien e njoftimit në emrin e tij dhe nëse ky caktim nuk bëhet brenda 15 ditëve, çdo Agjent Pagues do të ketë të drejtë të caktojë këtë person me anë të një njoftimi me shkrim të drejtuar Emetuesit dhe të dorëzuar Emetuesit. Asgjë në këtë paragraf nuk cenon të drejtën e ndonjë Agjenti Pagues për të dhënë njoftim në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar me ligj. Ky paragraf zbatohet për Procedimet në Angli dhe për Procedimet në vende të tjera.

15.5 Miratimi për zbatim etj.

Subjekt i kufizimeve te shprehura ne nenin 15.6 (Dorezimi i Imunitetit) Emetuesi jep pëlqimin përgjithësisht në lidhje me çdo Procedim për të dhënë ndonjë ndihmë ose çështje të një procesi në lidhje me këto Procedime, duke përfshirë (pa kufizim) bërjen, zbatimin ose ekzekutimin kundrejt çdo lloj prone (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i saj i synuar) të ndonjë urdhri ose vendimi që është bërë ose është dhënë në këto Procedime.

15.6 Heqja dorë nga imuniteti

Në masën që Emetuesit në ndonjë juridiksion t'i takoje të pretendojë për vete ose për asetet apo të ardhurat e tij imunitet nga procedimi, ekzekutimi, konfiskimi (qoftë në ndihmë të ekzekutimit, para

vendimit apo ndryshe) ose nga ndonjë proces tjetër ligjor dhe në masën që ky imunitet (qoftë i pretenduar apo jo) mund t'i atribuohet në çdo juridiksion të tillë Emetuesit ose aseteve apo të ardhurave të tij, Emetuesi bie dakord të mos pretendojë dhe të heqë dorë në mënyrë të pakthyeshme nga ky imunitet në masën e plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni, ne qofte se Emetuesi nuk e dorezon imunitetitn ne lidhje me: (i) "premisat e misionit" siç sanksionon Konventa e Vjenes mbi Marredheniet Diplomatike, firmosur ne 1961, "premisat konsullore" te sotme apo te ardhshme siç sanksionon Konventa e Vjenes mbi Marredheniet Konsullore firmosur ne 1963 ose ndryshe e perdorur nga nje diplomat apo mision diplomatik i Shqiperise ose cdo agjenci apo sherbim i tij: ose (ii) cdo pasuri e patundshme qe bie nen detyrimet e paragrafit 1 deri 3, neni 3, paragarafi i ligjit shqiptar nr.8743, date 22 shkurt 2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

16. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA

Një person që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje nuk ka asnjë të drejtë sipas Ligjit të vitit 1999 të Kontratave (Të Drejtat e Palëve të Treta) për të zbatuar ndonjë term të kësaj Marrëveshjeje.

17. MODIFIKIMI

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të një miratimi të mëtejshëm ndërmjet palëve të saj dhe pa pëlqimin e Zotëruesve të Notave.

18. KOPJET

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në disa kopje , secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale. Çdo palë mund të hyjë në këtë Marrëveshje duke nënshkruar ndonjë prej këtyre kopjeve.

Në dëshmi të kësaj përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të palëve të saj e kanë nënshkruar në ditën dhe vitin e shkruar në fillim më parë.

SKEDULI 1
FORMULARI I NOTËS SË PËRKOHSHME GLOBALE

ÇDO PERSON NGA SHTETET E BASHKUARA QË KA KËTË DETYRIM DO T'I NËNSHTROHET KUFIZIMEVE SIPAS LIGJIT AMERIKAN TË TAKSËS MBI TË ARDHURAT, DUKE PËRFSHIRË KUFIZIMET E PARASHIKUARA NË SEKSIONET 165(J) DHE 1287(A) TË KODIT TË TË ARDHURAVE TË BRENDSHME.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EURO [•]
[•] për qind e Notave të kërkueshme [•]

NOTË E PËRKOHSHME GLOBALE

1. HYRJE

Kjo Notë e Përkohshme Globale emetohet në lidhje me EURO [•] [•] për qind të notave të

kërkueshme [•] ("Notat") e Republikës së Shqipërisë , perfaqesuar nga Keshilli i Ministrave që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave] ("Emetuesi"). Notat i nënshtrohen një marrëveshjeje të agjencisë fiskale të datës [•] 2010 (e ndryshuar ose e plotësuar herë pas here, "Marrëveshja e Agjencisë Fiskale") dhe bëhen ndërmjet Emetuesit [Deutsche Bank AG, London Branch] si agjent fiskal ("Agjenti Fiskal", shprehje që përfshin çdo agjent fiskal pasardhës të emëruar herë pas here në lidhje me Notat) dhe agjentë të tjerë pagues të caktuar në këtë Marrëveshje (së bashku me Agjentin Fiskal, "Agjentët Pagues", shprehje që përfshin çdo agjent pagues shtesë ose pasardhës që paguan agjentët herë pas here në lidhje me Notat).

2. REFERENCAT NDAJ KUSHTEVE

Çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj "Kushteve" është referencë ndaj termave dhe kushteve të Notave të planifikuara për Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale dhe çdo referencë ndaj një "Kushti" të numërtuar është referencë ndaj dispozitës së saj korresponduese të numërtuar. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Kushtet do të kenë të njëjtat kuptime kur përdoren në këtë Notë të Përkohshme Globale.

3. ZOTIMI PËR TË PAGUAR

3.1 Pagesa për Zotëruesin

Për vlerat e marra, Emetuesi zotohet t'i paguajë Zotëruesit të kësaj Note të Përkohshme Globale shumën e principalit prej

[EURO shuma]
([SHUMA DHE MONEDHA NË FJALË, EURO])

më [•] ose në një datë ose data më të hershme kur kjo të bëhet e pagueshme në përputhje me Kushtet dhe për të paguar interes mbi këtë shumë të principalit në pagesa të prapambetura në datat dhe normën e specifikuar në Kushtet, së bashku me ndonjë shumë shtesë të pagueshme në përputhje me Kushtet, të gjitha në bazë të dhe në përputhje me Kushtet; megjithatë, me kusht që një interes i tillë të jetë i pagueshëm vetëm:

3.1.1 në rast të interesit që bëhet i pagueshëm para Datës së Shkëmbimit (që përcaktohet më poshtë) në masën që një çertifikatë ose çertifikatat e lëshuara nga Euroclear Bank S.A./N.V. ("Euroclear") dhe/ose Clearstream Banking, shoqëria anonime, Luksemburg ("Clearstream, Luxembourg") e datës jo më parë se data në të cilën ky interes bëhet i pagueshëm dhe kryesisht në formën e përcaktuar në Skedulin III (Formulari i Euroclear/Clearstream, Vërtetimi i Luksemburgut) të kësaj Marrëveshjeje, dorëzohet/dorëzohen në Zyrën e Caktuar (siç përcaktohet në Kushtet) të Agjentit Fiskal; ose

3.1.2 në rast të interesit që bëhet i pagueshëm në çdo kohë, në masën që Emetuesi nuk ka mundur të sigurojë shkëmbimin për një notë të përhershme globale të asaj pjese të Notës së Përkohshme Globale në lidhje me të cilën ky interes është grumbulluar, dhe nese ky interes do te paguhet jashte SHBA dhe pronave te saj.

3.2 Shuma e Principalit

Shuma e principalit e Notave të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale do të jetë shuma e deklaruar në paragrafin 3.1 (Pagesa për Zotëruesin) mbi, ose nëse është më e ulët, shuma e principalit që është regjistruar më vonë nga ose në emër të Emetuesit në kolonën përkatëse në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimi dhe Anulimi i Notave).

4. NEGOCIUESHMËRIA

Kjo Notë e Përkohshme Globale është e negociueshme dhe, për rrjedhojë, titulli për këtë Notë të Përkohshme Globale do të kalojë me anë të dorëzimit.

5. SHKËMBIMI

Në ose pas datës pas skadimit të 40 ditëve nga data e emetimit të kësaj Note Globale ("Data e Shkëmbimit"), Emetuesi do të sigurojë (në rast të shkëmbimit të parë) dorëzimin e një note të përhershme globale ("Nota e Përhershme Globale") kryesisht në formën e përcaktuar në Skedulin 2 (Formulari i Notës së Përhershme Globale) për Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale për Zotëruesin e kësaj Note të Përkohshme Globale ose (në rast të ndonjë shkëmbimi të mëpasshëm) një rritje në shumën e principalit të Notës së Përhershme Globale në përputhej me termat e saj kundrejt:

5.1 paraqitjes dhe (në rast të shkëmbimit përfundimtar) dorëzimit të kësaj Note Globale për ose me urdhër të Agjentit Fiskal; dhe

5.2 marrjes nga Agjenti Fiskal të një certifikate të lëshuar nga Euroclear dhe/ose Clearstream, Luksemburg, e datës jo më parë se Data e Shkëmbimit dhe kryesisht në formën e përcaktuar në Skedulin III (Formulari i Euroclear/Clearstream, Vërtetimi i Luksemburgut) i kësaj Marrëveshjeje.

Shuma e principalit e Notave të përfaqësuara nga Nota e Përhershme do të jetë e barabartë me

shumën e përgjithshme të shumave të principalit në çertifikat e lëshuara nga Euroclear dhe/ose Clearstream, Luksemburg dhe e marrë nga Agjenti Fiskal; megjithatë, me kusht që në asnjë rrethanë shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga Nota e Përhershme Globale nuk do të tejkalojë shumat fillestare të principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale.

6. SHËNIMET

Në çdo rast në të cilin:

6.1 Nota e Përhershme Globale është dorëzuar ose shuma e principalit të Notave e përfaqësuar në këtë mënyrë është rritur në përputhje me termat e saj në shkëmbim të një pjese tjetër të kësaj Note Globale; ose

6.2 Notat e përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale duhet të anulohen në përputhje me Kushtin 5(d) (Kompensimi dhe Blerja -Anulimi),

Emetuesi do të sigurojë që (a) shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga Nota e Përhershme Globale, shuma e principalit të kësaj rritjeje ose (sipas rastit) shuma e përgjithshme e principalit të këtyre Notave dhe (b) shuma e mbetur e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit e Notave të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale minus totalin e shumave të përmendura në (a)) regjistrohen në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimi dhe Anulimi i Notave) të kësaj Marrëveshjeje, dhe më pas shuma e principalit të Notave të përfaqësuar nga kjo Notë e Përkohshme Globale do të regjistrohet për çdo qëllim në variantin më të fundit.

7. PAGESAT

7.1 Regjistrimi i Pagesave

Pas çdo pagese që bëhet në lidhje me Notat e përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale, Emetuesi do të sigurojë që të dhënat e kësaj pagese të regjistrohen në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimi dhe Anulimi i Notave) të kësaj Marrëveshjeje dhe në rast të ndonjë pagese principali, shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale do të zbritet nga shuma e principalit e paguar në këtë mënyrë.

7.2 Përmbushja e detyrimeve të Emetuesit

Pagesat e kërkueshme në lidhje me Notat për kohën në vazhdim të përfaqësuara nga kjo Notë e Përkohshme Globale do të bëhen për Zotëruesin e kësaj Note të Përkohshme Globale dhe secila pagesë e bërë në këtë mënyrë do të përmbushë detyrimet e Emetuesit në lidhje me të. Çdo pamundësi për të bërë regjistrimet e përmendura më sipër nuk do të cënojë këtë përmbushje detyrimesh.

8. KUSHTET E ZBATUESHME

Derisa kjo Notë e Përkohshme Globale të jetë shkëmbyer siç parashikohet në këtë Marrëeshje ose të jetë anuluar në përputhje me Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale, Zotëruesi i kësaj Note të Përkohshme Globale do t'i nënshtrohet Kushteve dhe, në bazë të asaj që parashikohet ndryshe në të, do të gëzojë të drejta dhe përfitime të njëjta sipas Kushteve sikur Zotëruesi të ishte Zotërues i Notave në formë definitive kryesisht në formën e përcaktuar në Skedulin 3 (Formulari i Notës Definitive) të Marrëveshjes së Agjencisë Fiskale dhe kuponatkupona e ngjashme të interesit në shumën prej EURO [50,000 dhe shumefisha integrale prej EUR 1,000 deri ne dhe duke perfshire EUR 99,000] dhe në një shumë të përgjithshme të principalit të barabartë me shumën e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale.

9. NJOFTIMET

Pavarësisht Kushtit 15 (Njoftimet), ndërsa të gjitha Notat përfaqësohen nga kjo Notë e Përkohshme Globale (ose nga kjo Notë e Përkohshme Globale dhe Nota e Përhershme Globale) dhe kjo Notë e Përkohshme Globale (ose kjo Notë e Përkohshme Globale dhe Nota e Përhershme Globale) është/janë depozituar pranë një depozitari të përbashkët për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg, njoftimet për Zotëruesit e Notave mund të jepen me dërgimin e njoftimit përkatës për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg, dhe në çdo rast, këto njoftime do të konsiderohen t'i jenë dhënë Zotëruesve të Notave në përputhje me Kushtin 15 (Njoftimet) në datën e dërgimit për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg.

10. VËRTETIMI

Kjo Notë e Përkohshme Globale nuk do të jetë e vlefshme për ndonjë qëllim derisa të jetë vërtetuar për dhe në emër të Deutsche Bank AG, London Branch si agjent fiskal.

11. LIGJI RREGULLUES

Kjo Notë e Përkohshme Globale dhe çdo detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me të rregullohen nga ligji anglez.

NË DËSHMI TË KËSAJ nënshkruhet nga një person i autorizuar rregullisht në emër të Emetuesit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, PERFAQESUAR NGA KESHILLI I MINISTRAVE, QË

VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE

Nga: .....
(i autorizuar sipas rregullave)
LËSHUAR më [•]
VËRTETUAR për dhe në emër të
DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH
si agjent fiskal
pa rekurs, garanci ose përgjegjësi
Nga: .....
(i autorizuar sipas rregullave)

SKEDULI I
PAGESAT, SHKËMBIMI DHE ANULIMI I NOTAVE

Data e pagesës, disbursimi ose anulimi	**Shuma e interesit në atë kohë të paguar**	**Shuma e principalit e Notës së Përhershme Globale në atë kohë të dorëzuar ose nga e cila Nota e Përhershme Globale në atë kohë është rritur**	**Shuma e përgjithshme e principalit të Notave në atë kohë të anuluara**	**Shuma e principalit e mbetur e kësaj Note të Përhershme Globale**	**Nënshkrimi i Autorizuar**

SKEDULI II
FORMULARI I VËRTETIMIT TË ZOTËRUESVE TË LLOGARIVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EURO [•]
[•] për qind e Notave të kërkueshme [•] (Instrumenti i Investimit)

Vërtetohet se në këtë datë dhe përveç sa përcaktohet më poshtë, Obligacionet e sipërcituara të mbajtura nga ju për llogarinë tonë (a) zotërohen nga persona që nuk janë qytetarë ose rezidentë të Shteteve të Bashkuara, ortakërive kombëtare, korporatave të brendshme ose ndonjë prone apo trusti të ardhurat e të cilave i nënshtrohen taksimit Federal mbi të ardhurat të Shteteve të Bashkuara pavarësisht nga burimi i tij ("personat nga Shtetet e Bashkuara"), (b) zotërohen nga person(persona) nga Shtetet e Bashkuara që (i) janë degë të huaja të një institucioni financiar amerikan (siç përcaktohet në Seksionin 1.165-12(c)(1)(iv) të Rregulloreve të Thesarit Amerikan) ("institucionet financiare") që blejnë për llogari të tyre ose për rishitje, ose (ii) që blejnë Obligacione/Letra me Vlerë nëpërmjet degëve të huaja të institucioneve financiare amerikane dhe që mbajnë obligacione nëpërmjet këtyre institucioneve financiare amerikane në këtë datë (dhe në çdo rast (i) ose (ii), secili prej këtyre institucioneve financiare amerikane bie dakord, në emër të tij ose nëpërmjet agjentit të tij, që ju mund të kështilloni Emetuesin ose agjentin e Emetuesit që ai të respektojë kërkesat e Seksionit 165(j)(3)(A), (B) ose (C) të Kodit të të Ardhurave të Brendshme të vitit 1986, të ndryshuar, dhe rregulloreve sipas kësaj Marrëveshjeje), ose (c) zotërohen nga Shtetet e Bashkuara ose institucion (institucione) financiare të huaja ose amerikane, për qëllime të rishitjes gjatë periudhës së kufizuar (që përcaktohet në Seksionin 1.163-5(c)(2)(i)(D)(7)) të Rregullores Amerikane të Thesarit, dhe për më tepër, nëse zotëruesi i Obligacioneve është një institucion i huaj ose amerikan financiar i përshkruar në paragrafin (c) (qoftë nëse është përshkruar apo jo në paragrafin (a) ose (b)), vërtetohet më tej se ky institucion financiar nuk ka blerë Obligacionet për qëllime të rishitjes drejtpërdrejt ose tërthorazi për një person nga Shtetet e Bashkuara ose për një person brenda Shteteve të Bashkuara ose zotërimeve të saj.

Nëse Obligacionet janë të kategorisë së parashikuar në Seksionin 230.903(b)(3) të Rregullores S sipas Ligjit të Obligacioneve të vitit 1933, të ndryshuar ("Ligji"), atëherë vërtetohet gjithashtu se përveç sa përcaktohet më poshtë, Obligacionet zotërohen në përfitim nga (1) person (persona) joamerikanë ose (2) person (persona) amerikanë që kanë blerë Obligacionet në tranzaksione që nuk kërkojnë regjistrim sipas Ligjit. Siç përdoret në këtë paragraf, termi "person nga Shtetet e Bashkuara" ka kuptimin që i është dhënë nga Rregullorja S sipas Ligjit.

Siç përdoret në këtë Marrëveshje, "Shtetet e Bashkuara" nënkuptojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (duke përfshirë Shtetet dhe Distriktin e Kolumbias); dhe "zotërimet" e saj përfshijnë Porto Rikon,

Ishujt e Virgjër Amerikanë, Guam, Samoa Amerikane, Wake Island dhe Ishujt e Mariana Veriore.

Ne ndërmarrim t'iu kështillojmë menjëherë me anë të teleksit të testuar në ose para datës në të cilën synoni të paraqisni vërtetimin tuaj në lidhje me Obligacionet e mbajtura nga ju për llogarinë tonë në përputhje me procedurat tuaja operuese, nëse ndonjë deklaratë e zbatueshme në këtë Marrëveshje nuk është e saktë në këtë datë, dhe në mungesë të ndonjë njoftimi të tillë mund të supozohet se ky vërtetim zbatohet që nga ajo datë.

Ky vërtetim përjashton dhe nuk është i lidhur me EURO [•] të këtij interesi në Obligacionet e mësipërme në lidhje me të cilat ne nuk jemi të aftë të vërtetojmë dhe për të cilat pranojmë se shkëmbimi dhe dorëzimi i Obligacioneve definitive (ose nëse është e mundur, ushtrimin e ndonjë të drejte ose mbledhje interesi) nuk mund të bëhet derisa ne ta vërtetojmë këtë.

Ne pranojmë që ky vërtetim kërkohet në lidhje me disa ligje tatimore dhe nëse është e zbatueshme, disa ligje mbi obligacionet, të Shteteve të Bashkuara. Në këtë kuadër, nëse procedimet administrative ose ligjore fillohen ose mund të fillojnë në lidhje me të cilat ky vërtetim është ose do të ishte i lidhur, ne iu autorizojmë në mënyrë të parevokueshme të lëshoni këtë vërtetim për ndonjë palë të interesuar në këto procedime.

Datë:
[emri i Zotëruesit të llogarisë]
si ose si agjent për,
zotëruesi (zotëruesit) përfitues të Obligacioneve
me të cilat ka lidhje ky vërtetim.
Nga: .....
Nënshkruesi i autorizuar

SKEDULI III
FORMULARI I EUROCLEAR/CLEARSTREAM, VËRTETIMI I LUKSEMBURGUT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

EURO [•]
[•] për qind e Notave të kërkueshme [•](Instrumenti i Investimit)

Vërtetohet se bazuar vetëm në vërtetimet që kemi marrë me shkrim, me teleks të testuar ose me transmetim elektronik nga organizatat anëtare që shfaqen në të dhënat tona si persona që kanë të drejtën e një pjese të shumës së principalit të përcaktuar më poshtë ("Organizatat tona Anëtare") kryesisht për qëllimin e përcaktuar në notën e përkohshme globale të emetuar në lidhje me obligacionet , në këtë datë, EURO [•] shuma e principalit e Obligacioneve të sipërcituara (a) zotërohet nga persona që nuk janë qytetarë ose rezidentë të Shteteve të Bashkuara, ortakërive kombëtare, korporatave të brendshme ose ndonjë prone apo trusti të ardhurat e të cilave i nënshtrohen taksimit Federal të Shteteve të Bashkuara mbi të ardhurat, pavarësisht nga burimi i tij ("personat nga Shtetet e Bashkuara") (b) zotërohen nga persona nga Shtetet e Bashkuara që (i) janë degë të huaja të institucioneve financiare amerikane (siç përcaktohet në Seksionin 1.165-12(c)(1)(iv) të Rregulloreve të Thesarit Amerikan) ("institucionet financiare") që blejnë për llogari të tyre ose për rishitje, ose (ii) që blejnë Obligacione/Letra me Vlerë nëpërmjet degëve të huaja të institucioneve financiare amerikane dhe që mbajnë obligacione nëpërmjet këtyre institucioneve financiare amerikane në këtë datë (dhe në çdo rast (i) ose (ii), secili prej këtyre institucioneve financiare amerikane ka rënë dakord në emër të tij ose nëpërmjet agjentit të tij, që ne mund të këshillojmë Emetuesin ose agjentin e Emetuesit që ai të respektojë kërkesat e Seksionit 165(j)(3)(A), (B) ose (C) të Kodit të të Ardhurave të Brendshme të vitit 1986, të ndryshuar, dhe rregulloreve sipas kësaj Marrëveshjeje), ose (c) zotërohet nga Shtetet e Bashkuara ose institucione financiare të huaja ose amerikane për qëllime të rishitjes gjatë periudhës së kufizuar (që përcaktohet në Seksionin 1.163-5(c)(2)(i)(D)(7)) të Rregullores të Thesarit Amerikan, dhe për qëllimin e mëtejshëm që institucionet e huaja ose amerikane financiare të përshkruara në paragrafin (c) (qoftë nëse janë përshkruar apo jo në paragrafin (a) ose (b)), vërtetohet më tej që ata nuk kanë blerë Obligacione për qëllime të rishitjes drejtpërdrejt ose tërthorazi për një person nga Shtetet e Bashkuara ose për një person brenda Shteteve të Bashkuara ose zotërimeve të saj.

Nëse Obligacionet janë të kategorisë së parashikuar në Seksionin 230.903(b)(3) të Rregullores S sipas Ligjit të Obligacioneve të vitit 1933, të ndryshuar ("Ligji"), atëherë vërtetohet gjithashtu në lidhje me shumën e principalit të Obligacioneve të përcaktuara më sipër se, përveç sa përcaktohet më poshtë, ne kemi marrë me shkrim me anë të teleksit të testuar ose me transmetim elektronik nga Organizatat tona Anëtare të autorizuara për një pjesë të kësaj shume të principalit, vërtetime në lidhje me këtë pjesë kryesisht për qëllimin e përcaktuar në notën e përkohshme globale të emetuar në lidhje me Obligacionet.

Ne vërtetojmë më tej (1) se ne nuk po ju vëmë në dispozicion me këtë Marrëveshje për shkëmbim (ose nëse është e mundur, ushtrimin e ndonjë të drejte ose mbledhje interesi) ndonjë pjesë të obligacionit të përkohshëm global të përjashtuar në këto vërtetime dhe (2) që nga kjo datë ne nuk kemi marrë njoftim nga ndonjë prej Organizatave tona Anëtare me qëllim që deklaratat e bëra nga këto Organizata Anëtare në lidhje me ndonjë pjesë të seksionit të paraqitur me këtë Marrëveshje për shkëmbim (ose nëse është e mundur, ushtrimin e ndonjë të drejte ose mbledhjeje interesi) nuk janë më të vërteta dhe nuk mund të mbështeten që nga kjo datë.

Në pranojmë që ky vërtetim kërkohet në lidhje me disa ligje tatimore dhe nëse është e zbatueshme, disa ligje mbi obligacionet, të Shteteve të Bashkuara. Në këtë kuadër, nëse procedimet administrative ose ligjore fillohen ose mund të fillojnë në lidhje me të cilat ky vërtetim është ose do të ishte i lidhur, ne iu autorizojmë në mënyrë të parevokueshme të lëshoni këtë vërtetim për ndonjë palë të interesuar në këto procedime.

Datë:
Euroclear Bank
ose
Clearstream Banking, shoqëri anonime, Luksemburg
Nga: .....
Nënshkrues i autorizuar

SKEDULI 2
FORMULARI I NOTËS SË PËRHERSHME GLOBALE

ÇDO PERSON NGA SHTETET E BASHKUARA QË KA KËTË DETYRIM DO T'I NËNSHTROHET KUFIZIMEVE SIPAS LIGJIT AMERIKAN TË TAKSËS MBI TË ARDHURAT,

DUKE PËRFSHIRË KUFIZIMET E PARASHIKUARA NË SEKSIONET 165(j) DHE 1287(a) TË KODIT TË TË ARDHURAVE TË BRENDSHME.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EURO [•]
[•] për qind e Notave të kërkueshme [•]

NOTA E PËRHERSHME GLOBALE

1. HYRJE

Kjo Notë Globale emetohet në lidhje me EURO [•] [•] për qind të Notave të kërkueshme [•] ("Notat") të Republikës së Shqipërisë, perfaqesuar nga Keshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit te Financave] ("Emetuesi"). Notat (në masën që përfaqësohen nga kjo Notë Globale) përfitojnë nga një aktmarrëveshje të datës [•] 2010 (të ndryshuar ose të plotësuar herë pas here, "Aktmarrëveshja") të lidhur nga Emetuesi dhe i nënshtrohen një marrëveshjeje të agjencisë fiskale të datës [•] 2010 (të ndryshuar ose të plotësuar herë pas here , "Marrëveshja e Agjencisë Fiskale") dhe të bërë ndërmjet Emetuesit [Deutsche Bank AG, London Branch] si agjent fiskal ("Agjenti Fiskal", shprehje që përfshin çdo agjent fiskal pasardhës të emëruar herë pas here në lidhje me Notat) dhe agjentë të tjerë pagues të caktuar në këtë Marrëveshje (së bashku me Agjentin Fiskal, "Agjentët Pagues", shprehje që përfshin çdo agjent pagues shtesë ose pasardhës i emëruar herë pas here në lidhje me Notat).

2. REFERENCA NDAJ KUSHTEVE

Çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj "Kushteve" është referencë ndaj termave dhe kushteve të Notave të përcaktuara në Skedulin II (Termat dhe Kushtet e Notave) të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo referencë ndaj një "Kushti" të numërtuar është referencë ndaj dispozitës së saj korresponduese të numërtuar. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Kushtet do të kenë të njëjtat kuptime kur përdoren në këtë Notë Globale.

3. ZOTIMI PËR TË PAGUAR

3.1 Pagesa për Zotëruesin

Për vlerën e marrë, Emetuesi zotohet t'i paguajë Zotëruesit të kësaj Note Globale në lidhje me çdo Notë të përfaqësuar nga kjo Notë Globale, shumën e tij të principalit më [•] ose në një datë ose data më të hershme kur kjo mund të bëhet e pagueshme në përputhje me Kushtet dhe për të paguar interes mbi secilën prej këtyre Notave në datat dhe mënyrën e specifikuar në Kushtet, së bashku me ndonjë shumë shtesë të pagueshme në përputhje me Kushtet, të gjitha në bazë të dhe në përputhje me Kushtet.

3.2 Shuma e Principalit

Shuma e principalit e Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale do të jetë shuma e principalit e regjistruar fillimisht nga ose në emër të Emetuesit në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimt kundrejt Notës së Përkohshme Globale, Dorëzimi i Notave Definitive dhe Anulimi i Notave), ose nëse është më e ulët, shuma e principalit që është regjistruar më vonë nga ose në emër të Emetuesit në kolonën përkatëse në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimi kundrejt Notës së Përkohshme Globale, Dorëzimi i Notave Definitive dhe Anulimi i Notave).

4. NEGOCIUESHMËRIA

Kjo Notë Globale është e negociueshme dhe për rrjedhojë, titulli për këtë Notë Globale do të kalojë me anë të dorëzimit.

5. SHKËMBIMI

Kjo Notë Globale do të bëhet e shkëmbyeshme tërësisht por jo pjesërisht vetëm dhe me kërkesë të Zotëruesit të kësaj Note Globale, për Notat në formë definitive ("Notat Definitive ") kryesisht në formën e përcaktuar në Skedulin 3 (Formulari i Notës Definitive) për Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale nëse ka ndodhur ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) Euroclear Bank S.A./N.V. ("Euroclear") ose Clearstream Banking, shoqëri anonime, Luksemburg ("Clearstream, Luxembourg") nuk operon për një periudhë të vazhdueshme prej 14 ditësh (përveç se për arsye të festave zyrtare) ose njofton mbi një synim për të ndërprerë punën përfundimisht; ose

b) ndodh ndonjë prej rrethanave të përshkruara në Kushtin 8 (Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve).

6. DORËZIMI I NOTAVE DEFINITIVE

Kurdoherë që kjo Notë Globale duhet të shkëmbehet për Nota Definitive, Emetuesi do të sigurojë dorëzimin e menjëhershëm të këtyre Notave Definitive, të vërtetuara rregullisht dhe me kupona interesi ("Kuponat") bashkëlidhur, në një shumë të përgjithshme principalit të barabartë me shumën e principalit të

Notave të përfaqësuara kjo Notë Globale për Zotëruesin e kësaj Note Globale kundrejt dorëzimit të kësaj Note Globale për ose me urdhër të Agjentit Fiskal brenda 30 ditëve të kërkesës së Zotëruesit për këtë shkëmbim.

7. PAMUNDËSIA PËR TË DORËZUAR NOTAT DEFINITIVE OSE PËR TË SHLYER

Nëse:

c) Notat Definitive nuk janë dorëzuar në përputhje me paragrafin 6 (Dorëzimi i Notave Definitive) më sipër deri në orën 5.00 pasdite (koha e Londrës) në ditën e tridhjetë pasi Zotëruesi të ketë kërkuar shkëmbimin e kësaj Note Globale për Notat Definitive; ose

d) Kjo Notë Globale (ose ndonjë pjesë e saj) është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme në përputhje me Kushtet ose data për kompensimin përfundimtar të kësaj Note Globale ka ardhur dhe në çdo rast, pagesa e plotë e shumës së principalit të kërkueshme me të gjithë interesin e shtuar mbi të nuk është bërë për Zotëruesin në përputhje me termat e kësaj Note Globale në datën e kërkueshme për pagesë,

atëherë, kjo Notë Globale (duke përfshirë detyrimin për të dorëzuar Notat Definitive) do të bëhet e pavlefshme në orën 5 pasdite (koha londineze) në ditën e tridhjetë (në rastin e (a) ose në orën 5.00 pasdite (koha londineze) në atë datë të kërkueshme (në rastin e (b) dhe Zotëruesi i Notës Globale nuk do të ketë të drejta të mëtejshme sipas kësaj Marrëveshjeje (por pa cenuar të drejtat që Zotëruesi i kësaj Note Globale ose të tjerë mund të kenë sipas Aktmarrëvshjes). Aktmarrëveshja është depozituar pranë Zyrës së Caktuar të Agjentit Fiskal dhe një kopje e saj mund të kontrollohet në Zyrën e Caktuar të secilit Agjent Pagues.

8. SHËNIMET ZBRITESE

Në çdo rast në të cilin:

e) Një pagesë e principalit është bërë në lidhje me këtë Notë Globale;

f) Notat Definitive janë dorëzuar; ose

g) Notat e përfaqësuara nga kjo Notë Globale duhet të anulohen në përputhje me Kushtin 5(d) (Kompensimi dhe Blerja- Anulimi),

b) Emetuesi do të sigurojë që (i) shuma e kësaj pagese dhe shuma e përgjithshme e principalit të këtyre Notave dhe (ii) shuma e mbetur e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të saj minus totalin e shumave të përmendura në pikën (i) më lart) regjistrohen në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimet kundrejt Notës së Përkohshme Globale, Dorëzimit të Notave Definitive dhe Anulimi i Notave) të kësaj Marrëeshjeje, dhe më pas shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale do të regjistrohet për çdo qëllim në variantin më të fundit.

9. SHËNIMET NGJITESE

9.1 Shkëmbimi fillestar

Nëse kjo Notë Globale u emetua fillimisht në shkëmbim vetëm të një pjese të një note të përkohshme globale që përfaqëson Notat, atëherë referencat në këtë Notë Globale ndaj shumës së principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale do të interpretohen si referenca ndaj shumës së principalit të Notave të përfaqësuara nga pjesa e notës së përkohshme globale në shkëmbim për të cilën kjo Notë Globale u emetua fillimisht, që Emetuesi do të sigurojë se është regjistruar në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimet kundrejt Notës së Përkohshme Globale, Dorëzimi i Notave Definitive, Anulimi i Notave) të kësaj Marrëveshjeje, dhe më pas shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale për çdo qëllim do të regjistrohet në variantin më të fundit.

9.2 Shkëmbimi i Mëpasshëm

Nëse në ndonjë kohë të mëpasshme çdo pjesë e mëtejshme e një note të tillë të përkohshme globale shkëmbehet për një interes në këtë Notë Globale, shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale do të rritet nga shuma e një pjese të tillë të mëtejshme dhe Emetuesi do të sigurojë që shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale (që do të jetë shuma e mëparshme e principalit të Notave të përfaqësuar nga kjo Notë Globale plus shumën e kësaj pjese të mëtejshme) të shënohet në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimet kundrejt Notave të Përkohshme Globale, Dorëzimi i Notave Definitive dhe Anulimi i Notave) të saj, në të cilin shuma e principalit të kësaj Note Globale për të gjitha qëllimet do të jetë ajo e regjistruar në kohën më të fundit

10. PAGESAT

10.1 Regjistrimi i Pagesave

Pas çdo pagese që bëhet në lidhje me Notat e përfaqësuara nga kjo Notë Globale, Emetuesi do të sigurojë që të dhënat e kësaj pagese të shënohen në Skedulin I (Pagesat, Shkëmbimi kundrejt Notave të Përkohshme Globale, Dorëzimi i Notave Definitive dhe Anulimi i Notave,) të saj dhe në rast të çdo pagese principali, shuma e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale do të zbritet nga shuma e principalit të paguar në këtë mënyrë.

10.2 Përmbushja e Detyrimeve të Emetuesit

Pagesat e kërkueshme në lidhje me Notat për kohën në vazhdim, të përfaqësuara nga kjo Notë Globale, do të bëhen për Zotëruesin e kësaj Note Globale dhe çdo pagesë e bërë në këtë mënyrë do të përmbushë detyrimet e Emetuesit në lidhje me të. Çdo pamundësi për të regjistruar të dhënat e lartpërmendura, nuk cënon këtë përmbushje detyrimesh.

11. KUSHTET E ZBATUESHME

Derisa kjo Notë Globale të jetë shkëmbyer siç parashikohet në këtë Marrëveshje ose të anulohet në përputhje me Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale, Zotëruesi i kësaj Note Globale do t'i nënshtrohet Kushteve dhe në bazë të asaj që parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të jetë i autorizuar për të drejta dhe përfitime të njëjta sipas Kushteve sikur të ishte Zotërues i Notave dhe Kuponave Definitive përkatëse në shumën prej EURO [50,000 dhe shumefisha integrale prej EUR 1,000 deri ne dhe duke perfshire EUR 99,000] dhe në një shumë të përgjithshme të principalit të barabartë me shumën e principalit të Notave të përfaqësuara nga kjo Notë Globale.

12. NJOFTIMET

Pavarësisht nga Kushti 15 (Njoftimet), ndërsa të gjitha Notat përfaqësohen nga kjo Notë Globale (ose nga kjo Notë Globale dhe një notë e përkohshme globale) dhe kjo Notë Globale (se kjo Notë Globale dhe një notë e përkohshme globale) depozitohet pranë një depozitari të përbashkët për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg, njoftimet për Zotëruesit e Notave mund të jepen me anë të dorëzimit të njoftimit përkatës për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg, dhe në çdo rast, këto njoftime do të konsiderohen t'i jenë dhënë Zotëruesve të Notave në përputhje me Kushtin 15 (Njoftimet) në datën e dorëzimit për Euroclear dhe Clearstream, Luksemburg.

13. VËRTETIMI

Kjo Notë Globale nuk do të jetë e vlefshme për ndonjë qëllim derisa të jetë vërtetuar për dhe në emër të [Deutsche Bank AG, London Branch] si agjent fiskal.

14. LIGJI RREGULLUES

Kjo Notë Globale dhe çdo detyrim jokontraktor që lind nga ose në lidhje me të rregullohen nga ligji anglez.

Në dëshmi të kësaj nënshkruar nga një person i autorizuar rregullisht në emër të Emetuesit Republika e Shqipërisë perfaqesuar nga Keshilli i Ministrave që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave

Nga : .....

(i autorizuar sipas rregullave)

LËSHUAR më [•]

VËRTETUAR për dhe në emër të

[DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH]

Si agjent fiskal

Pa rekurs, garanci ose përgjegjësi

Nga:…… (i autorizuar sipas rregullave)

SKEDULI I

PAGESAT, SHKËMBIMET KUNDREJT NOTAVE TË PËRKOHSHME GLOBALE, DORËZIMI I NOTAVE DEFINITIVE DHE ANULIMI I NOTAVE

Data e pagesës, shkëmbimit, disbursimit ose anulimit	**Shuma e interest në atë kohë të paguar**	**Shuma e principalit e Notës së Përhershme Globale në atë kohë të shkëmbyer**	**Shuma e përgjithshme e principalit e Notave Definitive në atë kohë të dorëzuara**	**Shuma e përgjithshme e principalit të Notave në atë kohë të anuluara**	**Shuma e re e principalit të Notës Globale**	**Nënshkrimi i autorizuar**

SKEDULI II
TERMAT DHE KUSHTET E NOTAVE
[duhet të përcaktohen]

SKEDULI 3
FORMULARI I NOTËS DHE KUPONIT DEFINITIVE

[në anën e perparme të notës:]
€[•]

ÇDO PERSON NGA SHTETET E BASHKUARA QË KA KËTË DETYRIM DO T'I NËNSHTROHET KUFIZIMEVE SIPAS LIGJIT AMERIKAN TË TAKSËS MBI TË ARDHURAT, DUKE PËRFSHIRË KUFIZIMET E PARASHIKUARA NË SEKSIONET 165(j) DHE 1287(a) TË KODIT TË TË ARDHURAVE TË BRENDSHME.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EURO [•]
[•] për qind e Notave të kërkueshme [•]

Kjo Notë është një prej serive të notave ("Notat") në shumën prej €[•] dhe në shumën e përgjithshme të principalit prej €[•] të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, perfaqesuar nga Keshilli i Ministrave që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave] ("Emetuesi").

Emetuesi, për vlerën e marrë, premton t'i paguajë Zotëruesit shumën e principalit prej

€[•]
([SHUMA DHE MONEDHA NË FJALË] EURO)

më [•], në ose në këtë datë ose data të mëparshme ndërsa mund të bëhet e pagueshme në përputhje me kushtet e bashkëlidhura në këtë Marrëveshje ("Kushtet"), dhe për të paguar interesin mbi këtë shumë të

principalit në pagesa të prapambetura në datat dhe normën [normat] e specifikuara në Kushtet, së bashku me një shumë shtesë të pagueshme në përputhje me Kushtet, të gjitha në bazë të dhe në përputhje me Kushtet.

Interesi është i pagueshëm mbi shumën e mësipërme të principalit në normën prej [•] për qind në vit, të pagueshme çdo vit në pagesa të prapambetura më [dita dhe muaji] çdo vit, të gjitha në bazë të dhe në përputhje me Kushtet.

Kjo Notë dhe kuponat e interesit në lidhje me të nuk do të jenë të vlefshme për ndonjë qëllim derisa kjo Notë të jetë vërtetuar për dhe në emër të [Deutsche Bank AG, London Branch] si agjent fiskal.

NË DËSHMI TË KËSAJ nënshkrimi me faks i një personi të autorizuar rregullisht në emër të Emetuesit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PERFAQESUAR NGA KESHILLI I MINISTRAVE QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE

Nga: .....
(i autorizuar sipas rregullave)

LËSHUAR më [•] 2010
VËRTETUAR për dhe në emër të
DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH
si agjent fiskal
pa rekurs, garanci ose përgjegjësi
Nga: .....
(i autorizuar sipas rregullavet)
[Në anën e prapme të Notës:]

TERMAT DHE KUSHTET
që përcaktohen në Skedul

[Në fund të Termave dhe Kushteve:]

AGJENTI FISKAL DHE PAGUES
Deutsche Bank AG, London Branch
Winchester House
1 Great Winchester Street
London EC2M 2PP

Formulari i Kuponit

[Në anën e përparme të Kuponit:]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
€[•] [•] për qind e notave të kërkueshme [•]

Kupona për €[shuma e pagesës së interesit] i kërkueshëm më [•].

Kjo shumë është e pagueshme në bazë të termave dhe kushteve ("Kushtet") e firmosura në Shënimin me të cilin ka lidhje kjo Kupon (që janë detyruese për Zotëruesin e këtij Kuponi) qoftë nëse është apo jo për kohën në vazhdim, bashkëlidhur kësaj Note), kundrejt prezantimit dhe dorëzimit të këtij Kuponi në zyrën e caktuar për kohën në vazhdim të ndonjë prej agjentëve të treguar në anën e prapme të këtij Kuponi (ose çdo pasardhësi ose agjenti shtesë të caktuar herë pas here në përputhje me Kushtet).

ÇDO PERSON NGA SHTETET E BASHKUARA QË KA KËTË DETYRIM DO T'I NËNSHTROHET KUFIZIMEVE SIPAS LIGJIT AMERIKAN TË TAKSËS MBI TË ARDHURAT, DUKE PËRFSHIRË KUFIZIMET E PARASHIKUARA NË SEKSIONET 165(j) DHE 1287(a) TË KODIT TË TË ARDHURAVE TË BRENDSHME.

[në anën e prapme të Kuponit:]

Agjenti Fiskal dhe Pagues : Deutsche Bank AG, London Branch, Winchester House, 1 Great Winchester Street, London EC2M 2PP.

SKEDULI 4
TERMAT DHE KUSHTET E NOTAVE

SKEDULI 5
DISPOZITAT PËR MBLEDHJEN E ZOTËRUESVE TË NOTAVE

1. Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe Kushte, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

"Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve " nënkupton, në lidhje me çdo Mbledhje, një dokument në gjuhën angleze të lëshuar nga një Agjent Pagues:

a) që vërteton se disa Nota të specifikuara ("Notat e depozituara") janë depozituar pranë këtij

Agjenti Pagues (ose, me urdhrin e tij, në një bankë ose depozitar tjetër) ose janë bllokuar në një llogari me sistem kleringu dhe nuk do të zhbllokohen deri jo më parë se:

i) përfundimi i Mbledhjes; dhe

ii) dërgimi pranë këtij Agjenti Pagues jo më pak se 48 orë para kohës së caktuar për Mbledhjen (ose nëse Mbledhja është shtyrë, në kohën e caktuar për rifillimin e saj) të marrjes për Notat e depozituara ose bllokuara dhe njoftimin në lidhje me to nga ai Agjent Pagues për Emetuesin;

b) që vërteton se depozitari i secilës Notë të depozituar ose një person i autorizuar rregullisht në emër të tij ka udhëzuar Agjentin përkatës Pagues që votat të cilat i atribuohen kësaj Note të depozituar duhet të hidhen në një mënyrë të caktuar në secilën rezolutë që duhet të vendoset në Mbledhje dhe që, gjatë periudhës prej 48 orësh para kohës së caktuar për Mbledhjen, këto udhëzime nuk mund të ndryshohen ose revokohen;

c) që rendit numrin e përgjithshëm dhe (nëse janë në formë përfundimtare) numrat e çertifikatave të Notave të depozituara, duke bërë dallimin për secilën rezolutë midis atyre në lidhje me të cilat janë dhënë udhëzime për të votuar pro ose kundër rezolutës; dhe

d) që autorizon një individ ose individë të caktuar për të votuar në lidhje me Notat e depozituara në përputhje me këto udhëzime;

"Kryetari" nënkupton në lidhje me ndonjë Mbledhje, individin që zgjidhet Kryetar në përputhje me paragrafin 7 (Kryetari);

"Rezoluta e Jashtëzakonshme" nënkupton një rezolutë të kaluar në një Mbledhje të thirrur dhe zhvilluar rregullisht në përputhje me këtë Skedul nga një shumicë prej të paktën :

i) në rastin e një Çështjeje të Rezervuar, 75 për qind e shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera; ose

ii) në rastin e një çështjeje të ndryshme nga një Çështje e Rezervuar, $66^{2/3}$ për qind të shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera që përfaqësohen në atë mbledhje.

"Mbledhje" nënkupton një mbledhje të Zotëruesve të Notave (qoftë të mbledhura në fillim ose të rifilluara pas një shtyrjeje);

"Përfaqësues" nënkupton, në lidhje me ndonjë Mbledhje, një person të caktuar për të votuar sipas një Udhëzimi për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve, të ndryshëm nga:

a) çdo personi të tillë caktimi i të cilit është revokuar dhe në lidhje me të cilin Agjenti Fiskal është njoftuar me shkrim për këtë revokim në kohën që është 48 orë para kohës së vendosur për këtë Mbledhje; dhe

b) çdo person i tillë i caktuar për të votuar në një Mbledhje që është shtyrë për mungesë të një kuorumi dhe që nuk është ricaktuar për të votuar në Mbledhje kur ajo të rifillojë;

"Fraksion Përkatës" nënkupton:

e) për çdo çështje të ndryshme nga votimi për një Rezolutë të Jashtëzakonshme, dhjetë për qind.;

a) për votimin mbi ndonjë Rezolutë të Jashtëzakonshme të ndryshme nga ajo në lidhje me një Çështje të Rezervuar, pesëdhjetë për qind;

b) për votimin mbi ndonjë Rezolutë të Jashtëzakonshme në lidhje me një Çështje të Rezervuar, shtatëdhjet e pesë për qind; dhe

c) për votimin mbi çështje që kërkojnë unanimitet, njëqind për qind;

megjithatë, me kusht që në rastin e një Mbledhjeje që ka rifilluar pas një shtyrjeje për mungesë të një kuorum, ajo nënkupton:

iii) për çdo çështje të ndryshme nga votimi për një çështje që kërkon unanimitet ose një Rezolutë të Jashtëzakonshme në lidhje me një Çështje të Rezervuar, fraksionin e shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera të përfaqësuara ose të mbajtuara nga Votuesit aktualisht të pranishëm në Mbledhje; dhe

iv) për votimin mbi ndonjë Rezolutë të Jashtëzakonshme në lidhje me një Çështje të Rezervuar, njëzet e pesë për qind;

"Çështje e Rezervuar" nënkupton, siç parashikohet në paragrafin [22] (çështjet që kërkojnë unanimitet), çdo propozim:

a) për ndryshimin e datës ose metodës së përcaktimit të datës, për pagesën e principalit, interesit ose çdo shumë tjetër në lidhje me Notat, për të zvogëluar ose anuluar shumën e principalit, interesit ose çdo shumë tjetër të pagueshme në ndonjë datë në lidhje me Notat ose ndryshimin e metodës së llogaritjes së shumës së principalit, interesit ose çdo shumë tjetër të pagueshme në lidhje me Notat në ndonjë datë;

b) për ndryshimin e monedhës në të cilën çdo shumë e kërkueshme në lidhje me Notat është e pagueshme ose vendin në të cilin duhet të bëhet një pagesë;

c) për ndryshimin e kuorumit të kërkuar në çdo mbledhje të Zotëruesve të Notave ose shumicës së kërkuar për të kaluar një Rezolutë të Jashtëzakonshme, Rezoluta me Shkrim ose çdo rezolutë tjetër e Zotëruesve të Notave ose numri i përqindjes së votave të kërkuara për t'u hedhur ose numri ose përqindja e Notave të kërkuara për t'u mbajtur, në lidhje me marrjen e ndonjë vendimi ose veprimi nga ose në emër të Zotëruesve të Notave ose ndonjërit prej tyre;

d) për ndryshimin e këtij përkufizimi, përkufizimi i "Rezoluta e Jashtëzakonshme", përkufizimi i "pashlyer" ose përkufizimi i "Rezoluta me Shkrim";

e) për ndryshimin ose heqjen dorë nga dispozitat e Notave të përcaktuara në Kushtin 2 (Statusi); ose

f) për ndryshimin e ndonjë dispozite të Notave që përshkruan rrethanat në të cilat Notat mund të deklarohen të kërkueshme dhe të pagueshme para datës së tyre të planifikuar të maturitetit, të përcaktuar në Kushtin 8 (Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve);

"Votues" nënkupton, në lidhje me ndonjë Mbledhje, Zotëruesin e një Çertifikate Votuese, një Përfaqësues ose Zotërues të një Note Definitive që përgatit këtë Notë Definitive në Mbledhje;

"Çertifikatë Votimi" nënkupton, në lidhje me çdo Mbledhje, një çertifikatë në gjuhën angleze të lëshuar nga një Agjent Pagues dhe të caktuar me datë në të cilën është deklaruar :

a) se disa Nota të specifikuara ("Notat e Depozituara") janë depozituar pranë këtij Agjenti Pagues (ose me urdhrin e tij, në një bankë ose depozitar tjetër) ose janë bllokuar në një llogari me një sistem kleringu dhe nuk do të zhbllokohen deri jo më parë se:

i) përfundimi i Mbledhjes; dhe

ii) dorëzimi i kësaj çertifikate për këtë Agjent Pagues; dhe

b) që Zotëruesi i kësaj çertifikate është i autorizuar të marrë pjesë dhe votojë në Mbledhje në lidhje me Notat e depozituara;

"Rezoluta me Shkrim" nënkupton një rezolutë me shkrim të nënshkruar nga ose në emër të Zotëruesve prej të paktën 75 për qind të shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera në rastin e një Çështjeje të Rezervuar, ose $66^{2/3}$ për qind të shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera në rastin e një çështjeje të ndryshme nga një Çështje e Rezervuar. Çdo Rezolutë me Shkrim mund të përmbahet në një dokument ose disa dokumenta në të njëjtën formë, secili i nënshkruar nga ose në emër të një ose më shumë Zotëruesve të Notave;

"24 orë" nënkupton një periudhë 24 orëshe duke përfshirë të gjithë ose një pjesë të një dite kur bankat janë të hapura për punë në të dyja vendet ku duhet të zhvillohet Mbledhja përkatëse dhe në secilin prej vendeve ku Agjentët Pagues kanë Zyrat e tyre të Përcaktuara (duke mos marrë parasysh për këtë qëllim ditën në të cilën duhet të zhvillohet kjo Mbledhje) dhe kjo periudhë do të shtyhet në një periudhë ose në masën e nevojshme, në më shumë periudha 24 orëshe derisa të përfshihet sa më sipër e gjitha ose ndonjë pjesë e një dite në të cilën bankat janë të hapura për punë, siç u përmend më sipër; dhe

"48 orë" nënkupton 2 periudha të njëpasnjëshme 24 orëshe.

2. Nxjerrja e Çertifikatave të Votimit dhe Udhëzimeve për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve

Zotëruesi i një Note mund të marrë një Çertifikatë Votimi nga ndonjë Agjent Pagues ose të kërkojë që një Agjent Pagues të nxjerrë një Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve, duke depozituar këtë Notë pranë këtij Agjenti Pagues ose të kujdeset që kjo Notë (me pëlqimin e tij) të mbahet me urdhrin ose nën kontrollin e tij në një llogari me një system kleringu jo më vonë se 48 orë para kohës së caktuar për Mbledhjen Përkatëse. Një Çertifikatë Votimi ose Udhëzimi për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve do të jetë i vlefshëm deri në zhbllokimin e Notave të depozituara me të cilat ka lidhje. Për sa kohë që një Çertifikatë Votimi ose Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve është i vlefshëm, Zotëruesi i tyre (në rast të një Çertifikate Votimi) ose çdo Përfaqësues i caktuar në të (në rast të një Udhëzimi për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve) do të konsiderohet të jetë Zotëruesi i Notave me të cilat ka lidhje për të gjitha qëllimet në lidhje me Mbledhjen. Një Çertifikatë Votimi dhe një Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve nuk mund të jetë njëkohësisht i pashlyer në lidhje me të njëjtën Notë.

3. Referencat ndaj depozitimit/emetimit të Notave

Kur Notat përfaqësohen nga Nota e Përkohshme Globale ose Nota e Përhershme Globale ose mbahen në formë definitive brenda një sistemi kleringu, referencat ndaj depozitës ose zhbllokimit të

Notave do të interpretohen në përputhje me praktikat e zakonshme (duke përfshirë bllokimin e llogarisë përkatëse) të këtij sistemi kleringu.

4. Vlefshmëria e Udhëzimeve për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve

Një Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve do të jetë i vlefshëm vetëm nëse depozitohet në Zyrën e Caktuar të Agjentit Fiskal ose në ndonjë vend tjetër [të aprovuar] nga Agjenti Fiskal të paktën 24 orë para kohës së caktuar për Mbledhjen përkatëse ose Kryetari vendos ndryshe para se Mbledhja të procedojë. Nëse [Agjenti Fiskal] kërkon një kopje të noterizuar të secilit Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve dhe të dhëna të pranueshme të identitetit të secilit Përfaqësues të caktuar në të, do të paraqitet në Mbledhje. Agjenti Fiskal nuk do të jetë i detyruar të hetojë vlefshmërinë e ndonjë Udhëzimi për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve ose autoriteti të ndonjë Përfaqësuesi.

5. Zhvillimi i Mbledhjeve

Emetuesi mund të zhvillojë një Mbledhje në çdo kohë dhe do të jetë i detyruar për ta bërë këtë sipas kërkesës me shkrim të Zotëruesve të Notave që kanë të paktën 10 për qind të shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera.

6. Njoftimi

Një njoftim të paktën 21 ditë para (me përjashtim të ditës në të cilën është dhënë njoftimi dhe të ditës në të cilën duhet të zhvillohet Mbledhja) duke specifikuar datën, kohën dhe vendin e Mbledhjes do t'i jepet [nga Emetuesi] Zotëruesve të Notave dhe Agjentëve Pagues [(me një kopje për Emetuesin)]. Njoftimi përcakton tekstin e plotë të ndonjë resolute që duhet të propozohet dhe do të deklarojë që Notat mund të depozitohen ose me urdhër të çdo Agjenti Pagues për qëllim të marrjes së Çertifikatave të Votimit ose caktimin e Përfaqësuesve jo më vonë se 48 orë para kohës së caktuar për Mbledhjen.

7. Kryetari

Një individ (që mund por nuk është e nevojshme të jetë një Zotërues Notash) i emëruar me shkrim nga Emetuesi mund të caktohet si kryetar i çdo Mbledhjeje por nëse nuk është bërë një emërim i tillë ose nëse individi i caktuar nuk është i pranishëm brenda 15 minutave pas kohës së caktuar për Mbledhjen, personat e pranishëm do të zgjedhin një prej tyre si kryetar dhe nëse nuk mund ta bëjnë këtë, Emetuesi mund të caktojë një Kryetar. Kryetari i një Mbledhjeje të shtyrë nuk duhet të jetë i njëjti person siç ishte Kryetari i Mbledhjes fillestare.

8. Kuorumi

Kuorum në çdo Mbledhje do të jetë të paktën një Votues që përfaqëson ose mban jo më pak sesa Pjesën Përkatëse të shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera.

9. Shtyrja për mungesë të kuorumit

Nëse brenda 15 minutave pas kohës së caktuar për ndonjë Mbledhje, një kuorum nuk është formuar, atëherë:

në rast të një Mbledhjeje të kërkuar nga Zotëruesit e Notave, ajo do të shpërndahet; dhe

në rast të ndonjë Mbledhjeje tjetër, ajo do të shtyhet për një periudhë të tillë (që nuk do të jetë më pak se 14 ditë dhe jo më shumë se 42 ditë) dhe në atë vend që Kryetari cakton; megjithatë, me kusht që:

a) takimi do të shpërndahet nëse Emetuesi e vendos këtë; dhe

b) asnjë Mbledhje nuk mund të shtyhet më shumë se një herë për mungesë të një kuorumi.

10. Mbledhja e shtyrë

Kryetari, me pëlqimin e (dhe nëse urdhërohet nga) ndonjë Mbledhjeje, mund të shtyjë këtë Mbledhje herë pas here dhe nga vendi në vend, por asnjë çështje nuk ka përfunduar në ndonjë Mbledhje të shtyrë përveç çështjes që mund të kishte përfunduar në mënyrë të ligjshme në Mbledhje nga e cila ka ndodhur shtyrja .

11. Njoftimi pas shtyrjes

Paragrafi 6 (Njoftimi) zbatohet për çdo Mbledhje që duhet të rifillojë pas shtyrjes për mungesë të një kuorumi përveç kur:

a) një njoftim 10 ditor (me përjashtim të ditës në të cilën është dhënë njoftimi dhe të ditës në të cilën duhet të rifillojë Mbledhja) do të jetë i mjaftueshëm; dhe

b) njoftimi do të përcaktojë specifikisht kërkesat e kuorumit që zbatohen gjatë rifillimit të Mbledhjes.

Nuk do të jetë e nevojshme të jepet njoftim për rifillimin e një Mbledhjeje që është shtyrë për ndonjë arsye tjetër.

12. Pjesëmarrja

Personat e mëposhtëm mund të marrin pjesë dhe të flasin në Mbledhje:

a) Votuesit;

b) Përfaqësuesit e Emetuesit dhe Agjentit Fiskal;

c) Këshilltarët financiarë të Emetuesit;

d) Përfaqësuesi ligjor për Emetuesin dhe Agjentin Fiskal; dhe

e) Çdo person tjetër të miratuar nga Mbledhja.

13. Miratimin me ngritjen e dorës

Çdo çështje e paraqitur në një Mbledhje do të vendoset në rastin e parë me anë të ngritjes së dorës. Nëse një votim nuk kërkohet në mënyrë të vlefshme para ose në kohën që deklarohet rezultati, deklarata e Kryetarit që në një miratim me ngritje duarsh ka kaluar një rezolutë, të kaluar nga një shumicë e cilësuar, të hedhur poshtë ose të hedhur poshtë nga një shumicë e cilësuar do të jetë përfundimtare, pa provë të numrit të votave të hedhura për ose kundër rezolutës. Kur ka vetëm një Votues, ky paragraf nuk do të zbatohet dhe rezoluta do të vendoset menjëherë me anë të një votimi.

14. Zgjedhjet

Një kërkesë për një votim do të jetë e vlefshme nëse është bërë nga Kryetari, Emetuesi ose një ose më shumë Votues që përfaëqësojnë ose kanë jo më pak se një e pesëdhjeta e shumës së përgjithshme të principalit të Notave të pashlyera. Votimi mund të merret menjëherë ose pas kësaj shtyrjeje sipas urdhrit të Kryetarit, por çdo kërkesë votimi për zgjedhjen e Kryetarit ose mbi ndonjë çështje të shtyrjes do të merret në Mbledhje pa vonesë. Një kërkesë e vlefshme për një votim nuk pengon vazhdimin e Mbledhjes përkatëse për ndonjë punë tjetër që urdhëron Kryetari.

15. Votat

Secili Votues do të ketë:

a) me një ngritje duarsh, një votë; dhe

b) në një votim, numrin e votave të nxjerra duke ndarë shumën principale të përgjithshme të Notës (Notave) të pashlyera, të përfaqësuara ose të mbajtura nga ai nga njësia e monedhës në të cilën është caktuar shuma e Notave.

Në rast të një barazimi votash Kryetari do të ketë një votë.

Nëse termat e Udhëzimit për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve deklarojnë ndryshe, një Votues nuk do të jetë i detyruar të ushtrojë të gjitha votat për të cilat ai është i autorizuar ose të hedhë të gjitha votat që ai ushtron në të njëjtën mënyrë.

16. Vlefshmëria e Votave nga përfaqësuesi

Çdo votë nga një Përfaqësues në përputhje me Udhëzimin përkatës të Votimit Bazë të Numrit të Anëtarëve do të jetë e vlefshme edhe nëse ky Udhëzim për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve ose ndonjë udhëzim sipas të cilit ajo është dhënë, është ndryshuar, revokuar, me kusht që Agjenti Fiskal të mos jetë njoftuar me shkrim për këtë ndryshim, revokim deri në kohën që është 24 orë para kohës së vendosur për Mbledhjen përkatëse. Nëse nuk revokohet , çdo caktim i një Përfaqësuesi sipas një Udhëzimi për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve në lidhje me një Mbledhje, do të mbesë në fuqi në lidhje me ndonjë rifillim të kësaj Mbledhjeje pas një shtyrjeje; megjithatë, me kusht që asnjë caktim i tillë i Përfaqësuesit në lidhje me një Mbledhje të thirrur fillimisht që ishte shtyrë për mungesë të një kuorumi nuk do të mbetet në fuqi në lidhje me këtë Mbledhje kur ajo të rifillojë. Çdo person i caktuar për të votuar në këtë Mbledhje duhet të ricaktohet sipas një Përfaqësuesi të Udhëzimit për Votimin në Bazë të Numrit të Anëtarëve për të votuar në Mbledhje kur ajo të rifillojë.

17. Kompetencat

Një Mbledhje do të ketë kompetencë (të ushtrueshme nga Rezoluta e Jashtëzakonshme), pa cenuar ndonjë kompetencë tjetër të dhënë asaj ose ndonjë personi tjetër:

a) për të miratuar çdo çështje të Rezervuar;

b) për të miratuar çdo propozim nga Emetuesi për çdo modifikim, shfuqizim, ndryshim ose cenim të ndonjë prej Kushteve ose ndonjë marrëveshje në lidhje me detyrimet e Emetuesit sipas ose në lidhje me Notat;

c) për të miratuar çdo propozim nga Emetuesi për çdo modifikim të ndonjë dispozite të Akt Marrëveshjes ose ndonjë mase në lidhje me detyrimet e Emetuesit sipas saj;

d) për të miratuar zëendësimin e ndonjë personi për Emetuesin (ose ndonjë zëvendësues i mëparshëm) si debitor principali sipas Notave [dhe Akt Marrëveshjes];

e) për të hequr dorë nga ndonjë shkelje ose për të autorizuar ndonjë shkelje të propozuar nga Emetuesi të detyrimeve të tij sipas ose në lidhje me Notat [ose Akt Marrëeshjes] ose çdo veprimi ose mosveprimi që mund të përbënte ndryshe një rast të mosplotësimit të detyrimeve sipas Notave;

f) për të autorizuar Agjentin Fiskal ose ndonjë person tjetër të ekzekutojë të gjitha dokumentet dhe për të bërë të gjitha gjërat e nevojshme për t'i dhënë fuqi ndonjë Rezolute të Jashtëzakonshme;

g) për të dhënë ndonjë autorizim ose miratim tjetër që kërkohet të jepet nga Rezoluta e

Jashtëzakonshme.

18. Komiteti i Zotëruesve të Notave

a. Emërimi

Zotëruesit e notave, me anë të një rezolute të kaluar në një mbledhje të Zotëruesve të Notave të thirrur dhe zhvilluar rregullisht, në përputhje me Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale me shumicë prej të paktën 50 për qind të shumës së përgjithshme të principalit të Notave në atë kohë të pashlyera ose me anë të një njoftimi me shkrim për Emetuesin (me një kopje për Agjentin Fiskal) të nënshkruar nga ose në emër të Zotëruesve prej të paktën 50 për qind në shumën e përgjithshme të principalit të Notave në atë kohë të pashlyer, mund të caktojnë një person ose disa persona si një komitet që të përfaqësojë interesat e Zotëruesve të Notave, nëse ka ndodhur ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

i) një Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve;

ii) ndonjë rast ose rrethanë që me dhënien e njoftimit, kalimin e kohës, lëshimit të një vërtetimi dhe/ose plotësimi të ndonjë kërkese tjetër të parashikuar në Kushtin (Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve) mund të bëhej një Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve; ose

iii) çdo njoftim publik nga Emetuesi, me qëllim që Emetuesi kërkon ose synon të kërkojë një ristrukturim të Notave (qoftë me anë të amendimit, ofertës së shkëmbimit ose ndryshe), megjithatë, me kusht që asnjë emërim i tillë të mos hyjë në fuqi nëse Zotëruesit e më shumë se 25 për qind të shumës së përgjithshme të kapitalit të Notave të pashlyera, ose kanë (A) kundërshtuar një emërim të tillë me anë të një njoftimi me shkrim për Emetuesin (me një kopje për Agjentin Fiskal) gjatë një periudhe të specifikuar kohe pas njoftimit të emërimit që jepet (nëse ky njoftim emërimi është bërë me anë të një njoftimi me shkrim për Emetuesin) ku kjo periudhë e specifikuar do të jetë ose 30 ditë ose periudhë tjetër e tillë më e gjatë ose më e shkurtër që komiteti, duke vepruar në mirëbesim, mund të përcaktojë si të përshtatshme sipas rrethanave, ose (B) votuar kundër një rezolute të tillë në mbledhjen e Zotëruesve të Notave të thirrur dhe zhvilluar rregullisht, në përputhje me marrëveshjen e Agjencisë Fiskale. Ky komitet, nëse caktohet me njoftim me shkrim për Emetuesin, mund të japë njoftim për caktimin e tij për të gjithë Zotëruesit e Notave në përputhje me Kushtin 15 (Njoftimet) sapo të jetë e mundur pasi njoftimi t'i jepet Emetuesit.

b) Kompetencat

Ky Komitet, mes të tjerash, me diskrecionin e vet mund (i) të angazhojë këshilltarët ligjorë dhe këshilltarët financiarë për ta asistuar në përfaqësimin e interesave të Zotëruesve të Notave, (ii) të miratojë ato rregulla që i çmon të përshtatshme në lidhje me procedimet e tij, (iii) të hyjë në diskutime me Emetuesin dhe/ose kreditorë të tjerë të Emetuesit, (iv) mund të caktojë një ose më shumë anëtarë të komitetit për të vepruar si pikë (pika) kontakti me Emetuesin dhe t'i japë Emetuesit të gjitha të dhënat përkatëse të kontaktit (v) të përcaktojë nëse ka apo jo një konflikt aktual ose të mundshëm interesi midis interesave të Zotëruesve të Notave në atë kohë të pashlyera dhe interesave të Zotëruesve të garancive të borxhit të ndonjë ose më shumë serive të tjera të emetuara nga Emetuesi dhe (vi) pas bërjes së një përcaktimi të mungesës së ndonjë konflikti aktual ose të mundshëm interesi midis interesave të Zotëruesve të Notave në atë kohë të pashlyera dhe interesave të Zotëruesve të garancive të borxhit të ndonjë ose më shumë serive të tjera të emetuara nga Emetuesi, bie dakord të përfundojë një çështje në një takim të kombinuar të komitetit dhe atij personi ose personave të tjerë që mund të jenë emëruar rregullisht si përfaqësues të Zotëruesve të garancive të secilës prej këtyre serive të tjera. Përveç se në masën e parashikuar në këtë paragraf (b) (Kompetencat), ky komitet nuk do të ketë aftësinë për të ushtruar ndonjë kompetencë ose diskrecion që Zotëruesit e Notave mund ta ushtrojnë vetë. Emetuesi do të paguajë çdo tarifë dhe shpenzim që mund të shkaktohen nga ky komitet ose një komitet i kombinuar (duke përfshirë, pa kufizim, kostot e dhënies së njoftimeve për Zotëruesit e Notave, tarifat dhe shpenzimet e këshilltarëve ligjorë dhe këshilltarëve financiarë të komitetit, nëse ka) brenda 30 ditëve nga dorëzimi për Emetuesin të një fature të hollësishme në mënyrë të hollësishme dhe dokumentacioni mbështetës.

19. Rezoluta e Jashtëzakonshme , detyruese për të gjithë Zotëruesit

Një Rezolutë e Jashtëzakonshme do të jetë detyruese për të gjithë Zotëruesit e Notave dhe Kuponave, pavarësisht nëse janë të pranishën në atë Mbledhje apo jo dhe secili prej Zotëruesit e Notave do të jetë i detyruar t'i japë atyre fuqi në mënyrën e duhur. Njoftimi i rezultatit të çdo vote mbi një Rezolutë të Jashtëzakonshme do t'i jepet Zotëruesve të Notave dhe Agjentëve Pagues (me një kopje për Emetuesin) brenda 14 ditëve nga përfundimi i Mbledhjes.

20. Procesverbalet

Për të gjitha rezolutat dhe procedimet në çdo Mbledhje do të mbahen procesverbale. Kryetari firmos procesverbalin që do të jetë të dhëna prima facie të procedimeve të regjistruara në të. Nëse dhe derisa të provohet e kundërta, çdo Mbledhje e tillë në lidhje me procedimet e të cilës janë përmbledhur dhe firmosur procesverbale, do të konsiderohet të jetë thirrur dhe zhvilluar rregullisht, dhe të gjitha rezolutat e

kaluara ose procedimet e kryera në të do të konsiderohen të jenë kaluar dhe kryer rregullisht.

21. Rezoluta me Shkrim

Një Rezolutë me Shkrim do të hyjë në fuqi sikur të ishte një Rezolutë e Jashtëzakonshme.

22. Çështje që kërkojnë unanimitet

Çdo propozim:

a) për të ndryshuar ligjin që rregullon Notat, gjykatat në juridiksionin e të cilave Emetuesi ka dorëzuar Notat, detyrimi i Emetuesit për të mbajtur një agjent për dhënien e njoftimit në Angli ose heqja dorë nga imuniteti nga ana e Emetuesit, në lidhje me paditë ose procedimet e ngritura nga ndonjë Zotërues Notash, të parashtruara në Kushtin 17 (Ligji Rregullues dhe Juridiksioni);

b) për të ndryshuar dispozita të Kushteve në lidhje me ndonjë shkëmbim ose zëvendësim të Notave ose shndërrim të Notave në çdo detyrim ose obligacion tjetër të Emetuesit ose ndonjë personi tjetër që do të rezultonte në Kushtet që janë ndryshuar në këtë mënyrë si më pak të favorshme për Zotëruesit e Notave që i nënshtrohen Kushteve të ndryshuara sesa:

iii) dispozitat e detyrimeve ose obligacioneve të tjera të Emetuesit ose ndonjë personi tjetër që rezulton nga shkëmbimi ose zëvendësimi ose shndërrimi përkatës; ose

iv) nëse më shumë se një seri detyrimesh ose obligacionesh të tjera rezulton nga shkëmbimi ose zëvendësimi ose shndërrimi përkatës, dispozitat e serive rezultuese që kanë shumën më të madhe të përgjithshme të principalit; ose

d) për të ndryshuar dispozitat e këtij paragrafi 22 (Çështje që kërkojnë unanimitet), mund t'u jepet fuqi vetëm me miratimin e Zotëruesve të të gjitha Notave të pashlyera.

SKEDULI 6
ZYRAT E CAKTUARA TË AGJENTËVE PAGUES

Agjenti Fiskal dhe Pagues:

Deutsche Bank AG, London Branch
Winchester House
1 Great Winchester Street
London EC2M 2PP

Faks: +44 20 7547 6149
Në vëmendje të: Trust & Securities Services

NËNSHKRIMET

Emetuesi
REPUBLIKA E SHQIPËRISË, PERFAQESUAR NGA KESHILLI I MINISTRAVE QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCAVE
Nga: ……..

Agjenti Fiskal dhe Pagues
DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH
Nga: ……..

KJO MARRËVESHJE ZOTIMI bëhet më [•] 2010

NGA

1. REPUBLIKA E SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË TIJ TË FINANCAVE] (Emetuesi)

NË FAVOR TË

2. ZOTËRUESIT TË LLOGARISË (sipas përkufizimit të mëposhtëm).

NDËRSA

A. Emetuesi ka autorizuar krijimin dhe emetimin e EUR [•] në një shumë të përgjithshme principale prej [•] për qind. Notat e kërkueshme [•] (Notat).

B. Notat do të jenë në formën e prurësit me prerje prej EUR 50,000 dhe shumëfish integral të EUR 1,000 më shumë të saj dhe deri në, duke përfshirë EUR 99,000. Asnjë Notë në formën definitive nuk do të emetohet me një prerje mbi EUR 99,000. Notat do të emetohen fillimisht në formën e një note të përkohshme globale (Nota e Përkohshme Globale) që do të jetë e shkëmbyeshme me notën e përhershme globale (Nota e Përhershme Globale) ne rrethanat e përcaktuara në Notën e Përkohshme Globale. Nota e Përhershme Globale nga ana tjetër do të jetë e shkëmbyeshme me notat në formën definitive (Nota Definitive), me kuponët e interesit bashkëngjitur, në rrethanat e përcaktuara në Notën e Përhershme Globale.

C. Nota e Përhershme Globale do t’i jepet një depozituesi të zakonshëm për Euroclear Bank SA/NV (Euroclear) dhe Clearstream Banking, société anonyme, Luxembourg ("Clearstream, Luxembourg").

D. Emetuesi, në lidhje me Notat, do të lidhë një marrëveshje agjencie fiskale (të ndryshuar ose plotësuar herë pas here, “Marrëveshja e Agjencisë Fiskale”) me Deutsche Bank AG, London Branch ("Agjenti Fiskal", shprehja e së cilës përfshin çdo agjent fiskal pasues të caktuar herë pas here në lidhje me Notat) dhe agjentët e tjerë pagues që emërtohen në të.

E. Emetuesi dëshiron të marrë masa për mbrojtjen e interesave të Zotëruesve të Llogarisë në rast se Nota e Përhershme Globale bëhet e pavlefshme në pajtim me termat e saj.

KJO MARRËVESHJE ZOTIMI DËSHMON sa më poshtë:

1. Interpretimi

1.1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje Zotimi, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

"Zotërues Llogarie" është një zotërues llogarie tek Sistemi Clearing që në Datën e Përcaktimit ka kredituar tek llogaria e titujve tek ky Sistem Clearing një ose më shumë hyrje në lidhje me Notën e Përhershme Globale, përveç Sistemit Clearing në cilësinë e tij si zotërues llogarie në Sistemin tjetër Clearing;

"Sistem Clearing" nënkupton Euroclear and Clearstream, Luxembourg;

"Kushtet" nënkuptojnë Termat dhe Kushtet e Notave (që përcaktohen në Skedulin 4 të Marrëveshjes së Agjencisë Fiskale dhe ndryshohen herë pas here në përputhje me termat e tyre) dhe

çdo referencë ndaj një "Kushti" të renditur është referencë ndaj dispozitës korresponduese të renditur të saj;

"Data e Përcaktimit" është data në të cilën Nota e Përhershme Globale bëhet e pavlefshme në pajtim me termat e saj;

"Të Drejtat e Drejtpërdrejta" janë të drejtat e përmendura në Klauzolën 2.1;

"Hyrje" është çdo hyrje që bëhet në llogarinë e titujve të një Zotëruesi Llogarie me një Sistem Clearing në lidhje me Notat e përfaqësuara nga Nota e Përhershme Globale; dhe

"Shuma Principale" është në lidhje me çdo Hyrje, shuma e përgjithshme principale e Notave me të cilën ka të bëjë kjo Hyrje.

1.2 Terma të tjerë të përkufizuar

Termat e përkufizuar në Kushtet kanë të njëjtat kuptime në këtë Marreveshje Zotimi.

1.3 Dispozitat

Çdo referencë në këtë Marreveshje zotimi tek një Dispozitë, nëse nuk përcaktohet ndryshe, është referencë në një dispozitë të saj.

1.4 Titujt

Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marreveshjeje zotimi.

1.5 Legjislacioni

Çdo referencë në këtë Marreveshje zotimi në legjislacion (qoftë legjislacion parësor apo rregullore apo legjislacion tjetër dytësor i bërë në pajtim me legjislacionin parësor) interpretohet si një referencë tek ky legjislacion ashtu siç mund të jetë apo ndryshuar apo ri-miratuar herë pas here.

2. TË DREJTA TË DREJTPËRDREJTA

2.1 Krijimi

Nëse Nota e Përhershme Globale shfuqizohet në pajtim me termat e saj, secili Zotërues i Llogarisë ka kundrejt emetuesit të gjitha të drejtat ("Të Drejta të Drejtpërdrejta"), që ky Zotërues Llogarie do të kishte patur në lidhje me Notat nëse, menjëherë para Datës së Përcaktimit, do të ishte zotërues i Notave Definitive, të nënshkruara, vërtetuar dhe emetuar rregullisht, në një shumë të përgjithshme principale të barabartë me Shumën Principale të këtyre Hyrjeve të Zotëruesve të Llogarive duke përfshirë (pa kufizim) të drejtën për të marrë të gjitha pagesat e kërkueshme në çdo kohë në lidhje me këto Nota Definitive sikur këto Nota Definitive ose (sipas rastit) Kuponi/ët përkatës të ishin paraqitur rregullisht dhe (në rastin e një Kuponi ose shlyerjen e një Note Definitive) dorëzuar në datën e kërkueshme në pajtim me Kushtet. Çdo gjë që mund të pengojë emetimin e Notave Definitive në një shumë të përgjithshme principale të barabartë me Shumën Principale të çdo Hyrjeje të një Zotëruesi Llogarish nuk do të merret parasysh për qëllimet e kësaj Dispozite 2.1, por pa cenuar efektivitetin e ndonjë qëllimi tjetër.

2.2 Mosveprime të mëtejshme

Nuk kërkohet asnjë veprim tjetër nga ana e Emetuesit apo ndonjë personi tjetër:

2.2.1 Të Drejta të Drejtpërdrejta: për Zotëruesit e Llogarisë të gëzojnë të Drejta të Drejtpërdrejta;

2.2.2 Përfitimi i Kushteve: për çdo Zotërues Llogarie për të patur përfitimin e Kushteve sikur ata të ishin përfshirë *mutatis mutandis* në Marreveshjen e Zotimit,

me kusht që, asgjë në këtë kontratë nuk i jep të drejtë ndonjë Zotëruesi të Llogarisë për të marrë ndonjë pagesë që është bërë në lidhje me Notën e Përhershme Globale.

3. PROVA

3.1 Regjistrat

Regjistrat në lidhje me Sistemet Clearing do të jenë përfshirës në lidhje me Zotëruesit e Llogarive dhe shumat përkatëse të kredituara në llogaritë e titujve të tyre dhe një deklarim të nxjerrë nga një Sistem Clearing, që përcakton:

3.1.1 emrin e Zotëruesit të Llogarisë për të cilin është emetuar; dhe

3.1.2 Shumën Principale të një Hyrjeje të kredituar në llogarinë e titujve të këtij Zotëruesi Llogarie me këtë Sistem Clearing në çdo datë,

është provë përfshirëse për të gjitha qëllimet e kësaj Marreveshje zotimi.

3.2 Data e Përcaktimit

Nëse një Sistem Clearing përcakton Datën e Përcaktimit, ky përcaktim është detyrues për të

gjithë Zotëruesit e Llogarisë me këtë Sistem Clearing.

4. DEPOZITIMI I MARRËVESHJES SË ZOTIMIT

Kjo Marreveshje zotimi depozitohet dhe mbahet nga Agjenti Fiskal deri në datën në të cilën janë përmbushur plotësisht të gjitha detyrimet e Emetuesit sipas ose në lidhje me Notat (duke përfshirë, pa u kufizuar në detyrimet sipas kësaj Marrëveshje zotimi). Emetuesi njeh të drejtën e çdo Zotëruesi të Llogarisë për të paraqitur këtë Marrëveshje Zotimi.

5. DETYRIMET E PULLËS

Emetuesi paguan të gjitha tatimet dhe detyrimet e pullës, regjistrimit dhe të tjera (duke përfshirë çdo interes apo gjobë për ose në lidhje me këtë) që paguhen për ose në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin e Marreveshjes se zotimit dhe zhdëmton çdo Zotërues Llogarish ndaj çdo pretendimi, kërkese, veprimi, detyrimi, dëmi, kostoje, humbje apo shpenzimi (duke përfshirë, pa u kufizuar në tarifat ligjore dhe çdo tatim mbi vlerën e shtuar të aplikueshëm) që ai shkakton si rezultat ose që rrjedh në lidhje me çdo mospagesë ose vonesë në këtë pagesë.

6. PËRFITIMET E MARRËVESHJES SË ZOTIMIT

6.1 Veprim i Njëanshëm

Kjo Marreveshje zotimi hyn në fuqi si veprim i njëanshëm për përfitimin e Zotëruesve të Llogarisë herë pas here.

6.2 Përfitimi

Kjo Marrëveshje zotimi siguron në interes të secilit Zotërues Llogarie dhe pasuesve të tij (të mëvonshëm) dhe te caktuarëve, ku secili ka të drejtë të ekzekutojë veçmas këtë Marreveshje zotimi kundrejt Emetuesit.

6.3 Transferimi

Emetuesi nuk ka të drejtë të transferojë asnjë nga të drejtat, përfitimet dhe detyrimet e këtushme. Çdo Zotërues Llogarie ka të drejtë të transferojë të gjitha apo një prej të drejtave dhe përfitimeve të këtushme.

7. PAVLEFSHMËRI E PJESSHME

Nëse në një moment një dispozitë e kësaj është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e paekzekutueshme në një aspekt të caktuar në pajtim me ligjet e një juridiksioni, as ligjshmëria, vlefshmëria apo ekzekutueshmëria e dispozitave të tjera dhe as ligjshmëria, vlefshmëria ose ekzekutueshmëria e kësaj dispozite sipas ligjeve të një juridiksioni tjetër nuk ndikohet apo cenohet nga kjo.

8. NJOFTIMET

8.1 Adresa për njoftime

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera drejtuar Emetuesit bëhen me shkrim (me letër ose faks) dhe i dërgohen Emetuesit në:

[Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Nr 1
Tirana
Shqipëri]
Faks: + 355 422 28494
Vëmendje: Mr. Ridvan Bode, Minister i Financave

ose në një adresë tjetër ose numër faksi ose për vëmendjen e atyre personave të tjerë ose departamente që Emetuesi ka vënë në dijeni Zotëruesit e Notave në mënyrën e parashikuar për bërjen e njoftimeve në lidhje me Notat.

8.2 Hyrja në Fuqi

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i dërguar në pajtim me Klauzolën 8 (Njoftime) hyn në fuqi me marrjen nga Emetuesi, duke siguruar, gjithsesi, që çdo njoftim i tillë ose komunikim tjetër që përndryshe do të hynte në fuqi pas orës 4:00 pasdite për çdo ditë të veçantë në vendin e Emetuesit nuk hyn në fuqi deri më 10:00 paradite në ditën pasuese të punës në vendin e Emetuesit.

9. LIGJI MBIZOTËRUES

Kjo Marrëveshje zotimi dhe çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të rregullohet nga ligji anglez.

10. ARBITRAZHI

10.1 Arbitrazhi

Në pajtim me Kushtin 11.4 (Opsioni i Zotëruesve të Llogarive), çdo mosmarrëveshje ("Mosmarrëveshje") që rrjedh nga ose në lidhje me kete Marreveshje zotimi (duke përfshirë çdo mosmarreveshje te lidhur me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj Marrëveshje Zotimi dhe një mosmarrëveshje e lidhur me detyrime jokontraktore që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje zotimi) ose pasojat e mosvlefshmërisë së saj do t'i referohet arbitrazhit në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar (LCIA), dhe këto rregulla konsiderohen të përfshihen nëpërmjet referencës në këtë Kusht.

10.2 Formimi i gjykatës së arbitrazhit, selia dhe gjuha e arbitrazhit

10.2.1 Formimi i gjykatës së arbitrazhit: Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra, secili prej të cilëve nuk ka interes në mosmarrëveshje dhe nuk ka lidhje me asnjë palë dhe është një jurist me eksperiencë në veprimet e titujve ndërkombëtare. Emetuesi dhe Zoteruesit e Llogarive, secili cakton një arbitër të cilët se bashku caktojnë Kryetarin e Gjykatës. Nëse ky caktim nuk ka ndodhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pasi pala paditëse bën kërkesën për arbitrazh, ose nëse një Kryetar nuk është zgjedhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga zgjedhja e arbitrit të dytë, Gjykata e Arbitrazhit e Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar cakton tre arbitra ose kryetarin, sipas rastit. Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit mund të caktojë arbitra nga shtetasit e çdo vendi, pavarësisht nëse një palë është shtetas i atij vendi. Arbitrat nuk kanë autoritet për të dhënë vendime zhdëmtimi si dënim dhe në asnjë rast nuk mund të vendosë apo bëjë konstatime në kundërshtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

10.2.2 Selia e arbitrazhit: Selia e arbitrazhit është Londra, Angli dhe të gjitha seancat janë në Londër, Angli.

10.2.3 Gjuha e arbitrazhit: Gjuha e arbitrazhit është anglishtja

10.3 Tarifat

Tarifat e arbitrazhit (duke përjashtuar përgatitjen e çdo pale, udhëtimin, tarifat e avokatëve dhe kosto të ngjashme) mbulohet në pajtim me vendimin e arbitrave. Vendimi i arbitrave është përfundimtar, detyrues dhe i ekzekutueshëm për palët dhe vendimi mbi çdo vendim arbitrazhi mund të konfirmohet në çdo gjykatë që ka juridiksion mbi të.

10.4 Rekursi në Gjykatë

Për qëllimet e arbitrazhit në pajtim me Kushtin 10 (Arbitrazhi), Emetuesi dhe Zotëruesi perkates i Llogarive përjashtojnë juridiksionin e Gjykatave sipas Seksioneve 45 dhe 69 të Ligjit të Arbitrazhit të vitit 1996.

10.5 Opsioni i Zotëruesve të Llogarive

Në çdo kohe para se një Zotërues Llogarish, ka caktuar nje arbiter per te zgjidhur ndonje Mosmarreveshje ose Mosmarreveshjet sipas Kushtit 10.1 (Arbitrazhi), çdo Zotërues Llogarish me të drejtën e tij mund te zgjedhe me njoftim drejtuar me shkrim Emetuesit, qe kjo Mosmarreveshje ose Mosmarreveshjet te shqyrtohen nga gjykatat Angleze ose nga çdo gjykate tjeter e juridiksionit kompetent, sic përshkruhet me hollesisht ne Kushtin 11.3 (Te drejtat e Zoteruesve te Llogarive per te proceduar jashte Anglise) Ne vijim te ndonje zgjedhje te tille, asnje gjykate arbitrazhi nuk do te kete juridiksionin lidhur me ndonje Mosmarreveshje ose Mosmarreveshjet.

11. Gjykatat angleze

Në rast se një Zotërues Llogarish emeton një njoftim në pajtim me Kushtin 10.5 (Opsioni i Zotëruesve të Llogarive), zbatohen dispozitat e mëposhtme në këtë Kusht 11 (Gjykatat Angleze).

11.1 Juridiksioni

Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje ("Mosmarrëveshje") që rrjedh nga ose në lidhje me Marreveshjen e Zotimit (duke përfshirë çdo detyrim në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose prishjen e kësaj Marreveshje zotimi ose detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marreveshje Zotimi) ose pasojat e pavlefshmërisë së saj.

11.2 Forumi i përshtatshëm

Emetuesi bie dakord që gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje ose Mosmarreveshjet dhe, për pasojë, nuk do të argumentojë të kundërtën.

11.3 Të drejtat e Zotëruesve të Llogarisë për të filluar procedime jashtë Anglisë

Dispozita 11 (Gjykatat angleze) është në interes vetëm të Zotëruesve të Llogarisë. Si rezultat, asgjë në këtë Dispozitë 9 (Ligji Rregullues), 10 (Arbitrazhi) ose 11 (Gjykatat Angleze) nuk pengon

Zotëruesin e Llogarisë nga fillimi i procedimeve në lidhje me një Mosmarrëveshje ("Procedimi") në çdo gjykatë tjetër me juridiksion. Në masën që lejohet nga ligji, Zotëruesit e Llogarisë mund të fillojnë procedim njëkohësisht në një numër juridiksionesh.

11.4 Dorëzimi i dokumenteve

Emetuesi bie dakord që dokumentet që fillojnë Procedime dhe çdo dokument tjetër që kërkohet të jepet në lidhje me ato Procedime mund të njoftohet duke u dorëzuar tek Emetuesi ne Law Debenture Corporate Services Limited, 5th Floor, 100 Wood Street, London EC2V 7EX, England.

Nëse per ndonje aresye ky person nuk eshte ose pushon se qeni efektivisht i caktuar qe te pranoje dorezimin e dokumentave ne emer te Emetuesit, Emetuesi do te caktoje nje person tjeter ne Angli qe te pranoje dorezimin e dokumentave ne emer te tij dhe do te dorezoje ne Zyren e Percaktuar te Agjentit Fiskal, nje kopje te pranimit te agjentit te ri te caktuar brenda 30 diteve. Asgje ne kete paragraf nuk do te kufizoje te drejten e cdo Zoteruesi Llogarish per ti dorezuar dokumentat kunder Emetuesit ne cdo menyre tjeter te lejuar me ligj.

11.5 Miratimi për zbatim etj.

Ne varesi te kushtezimeve te shprehura ne Kushtin 11.6 (Heqja dore nga Imuniteti), Emetuesi përgjithësisht jep pëlqimin për çdo Procedim për dhënien e çdo lehtësimi ose nxjerrjen e çdo dokumenti në lidhje me këtë Procedim duke përfshirë (pa kufizim) bërjen, ekzekutimin dhe zbatimin mbi një pronë cilado qoftë (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i destinuar) të çdo urdhri apo vendimi që është dhënë në këtë Procedim.

11.6 Heqja Dorë nga Imuniteti

Në masën që Emetuesi mund të kete te drejten te pretendojë në çdo juridiksion për veten e vet apo për sendet e tij pasurore ose të ardhurat imunitet ndaj padisë, ekzekutimit, sekuestrimit (qoftë në kuadrin e ekzekutimit para vendimit ose ndryshe) ose veprimi tjetër ligjor dhe në masën që ky imunitet (që pretendohet apo jo) mund t'i atribuohet në çdo juridiksion emetuesit ose sendeve pasurore apo të ardhurave, Emetuesi bie dakord të mos pretendojë dhe heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga ky imunitet në masën më të gjerë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni, duke siguruar gjithsesi, se Emetuesi nuk heq dore nga imuniteti lidhur me: (i) "godinat e misioneve", te tashme ose te ardhme, sic percaktohet ne Konventen e Vienes mbi Marredheniet Dipllomatike, nenshkruar me 1961, "godinat konsullore", te tashme ose te ardhme , sic percaktohet ne Konventen e Vienes mbi Marredheniet Konsollore, nenshkruar me 1963 ose ndryshe te perdorura nga nje dipllomat ose mision dipllomatik i Shqiperise ose ndonje agjenci ose mjet i tyre; ose (ii) cdo pasuri e paluajtshme qe bie nen kushtet e paragrafit 1-3 te nenit 3, te Ligjit Shqiptar Nr. 8743, date 22 Shkurt 2001 "Mbi pasurite e palujtshme te shtetit

11.7 Modifikimi

Marrëveshja e Agjencisë fiskale përmban dispozita për thirrjen e mbledhjeve të Zotëruesve të Notave për të shqyrtuar çështjet në lidhje me Notat, duke përfshirë modifikimin e çdo dispozite të kësaj Marreveshje zotimi. Çdo ndryshim i tillë mund të bëhet me veprim shtesë të njëanshëm nëse sanksionohet nga një Rezolutë e Jashtëzakonshme dhe është detyruese për të gjithë Zotëruesit e Llogarisë.

NË DËSHMI TË KËSAJ kjo Marreveshje zotimi është nënshkruar nga Emetuesi e destinuar të jepet dhe faktikisht jepet në datën e shkruar më sipër.

NËNSHKRUAR si një kontratë)
nga REPUBLIKA E SHQIPËRISË,)
E PERFAQESUAR NGA KESHILLI)
I MINISTRAVE, QË VEPRON)
NEPERMJET MINISTRIT TE TIJ TE FINANCAVE)

TERMAT DHE KUSHTET E NOTAVE[4]

[4] Shenim i Perkthyesit: Termi "Nota" i referohet Instrumentit te Titullit te Borxhit

€[•] [•] Për qind. Notat e kërkueshme [•] ("Notat", ku kjo shprehje përfshin çdo notë tjetër të ardhme të emetuar në pajtim me Kushtin 14 (Emetime të Mëtejshme) dhe që formojnë një seri të vetme me këtë) të Republikës së Shqipërisë ("Emetuesi") [përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i përfaqësuar nga Ministri i Financave] janë objekt i një marrëveshjeje agjencie të datës [•] 2010 (ndryshuar ose plotësuar herë pas here, "Marrëveshja e Agjencisë") ndërmjet Emetuesit, [Deutsche Bank AG, Dega e Londrës] si agjent fiskal ("Agjenti Fiskal", ku kjo shprehje përfshin çdo agjent fiskal pasues të caktuar herë pas here në lidhje me Notat) dhe agjentët pagues të caktuar në të (së bashku me Agjentin Fiskal, "Agjentët Pagues", ku kjo shprehje përfshin çdo agjent pasues ose shtesë pagues të caktuar herë pas here në lidhje me Notat). Disa dispozita të këtyre Kushteve janë përfshirje të Marrëveshjes së Agjencisë dhe objekt i dispozitave të hollësishme. Zotëruesit e Notave ("Zotëruesit e Notave") dhe zotëruesit e kuponave e interesit përkatës ("Zotëruesit e Kuponave" dhe "Kuponat", përkatësisht) u nënshtrohen dhe mendohet të kenë dijeni për të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Agjencisë të zbatueshme për ta. Kopje të Marrëveshjes së Agjencisë ofrohen për këqyrje nga Zotëruesit e Notave gjatë orëve normale të punës në Zyrat e Caktuara (siç përkufizohen në Marrëveshjen e Agjencisë) për secilin nga Agjentët Pagues, Zyrat fillestare të Caktuara të të cilëve janë përcaktuar më poshtë.

1. Forma, Prerja dhe Titulli

Notat janë numërtuar në seri dhe në formën e prurësit në prerje prej € 50,000 dhe shumëfisha integrale të €1,000 më të mëdha dhe deri në, duke përfshirë € 99,999, secila me Kuponat e bashkangjitura në momentin e emetimit. Notat e një prerjeje nuk do të jetë të shkëmbyeshme për Notat e një prerjeje tjetër. Titulli për Notat dhe Kuponat kalon nëpërmjet dorëzimit. Zotëruesi i një Note apo Kuponi (përveç kur kërkohet ndryshe me ligj) trajtohet si një pronar absolut për të gjithë qëllimet (pavarësisht nëse është i kërkueshëm apo jo, dhe pavarësisht nga ndonjë njoftim pronësie, besimi apo interesi tjetër në të, çdo shkrim për të dhe çdo njoftim për ndonjë humbje apo vjedhje të tij të mëparshme) dhe asnjë person nuk është i detyruar ta trajtojë kështu këtë zotërues. Asnjë person nuk ka të drejtë të ekzekutojë ndonjë kusht apo term të Notave në bazë të Ligjit të Kontratave (Të Drejtat e Palëve të Treta) të vitit 1999.

2. Statusi

Notat përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe pa kusht për Emetuesin i cili kurdoherë i rendit ato pari passu ndërmjet tyre dhe të paktën pari passu me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara të Emetuesit, përveç kur këto detyrime mund të preferohen nga dispozitat ligjore që janë të detyrueshme dhe me zbatim të përgjithshëm.

3. Mosrëndimi me Barrë

Për sa kohë që ka Nota të pashlyera (siç përkufizohet në Marrëveshjen e Agjencisë) Emetuesi nuk krijon apo lejon ekzistencën e ndonjë Interesi Titulli (siç përkufizohet më poshtë) të ndryshme nga një Interes i Lejuar Titulli) Sigurimi (siç përkufizohet më poshtë) në pronën ose sendet e veta pasurore për të siguruar një Borxh Publik të Huaj ose (i) Notat janë siguruar në mënyrë të barabartë dhe proporcionale me këtë Borxh Publik të Huaj ose (ii) Notat kanë përfitimin e një garancie, sigurimi apo zhdëmtimi ose një masë tjetër që do të jetë njëlloj i rëndësishëm.

Në këto kushte:

"Interes i Lejuar Titulli" do të thotë:

a) çdo Interes Titulli mbi pronën (ose të ardhurat prej saj) për të siguruar një Borxh Publik të Jashtëm të shkaktuar për qëllimin e financimit të përftimit ose ndërtimit të kësaj prone;

b) çdo Interes Titulli që ekziston mbi pronën (ose të ardhurat prej saj) në momentin e përftimit të saj;

c) çdo Interes Titulli që siguron Borxhin Publik të Jashtëm të shkaktuar me qëllim Financimin e Projektit me kusht që (i) zotëruesit e këtij Borxhi të Jashtëm Publik bien dakord të kufizojnë mbështetjen e tyre mbi sendet pasurore dhe të ardhurat e këtij projekti si burimi kryesor i shlyerjes së këtij Borxhi të Jashtëm Publik dhe (ii) prona mbi të cilën jepet ky Interes Titulli përbëhet vetëm nga këto sende pasurore dhe të ardhura;

d) çdo Interes Titulli që ekziston në datën fillestare të lëshimit të Notave; dhe

e) rinovimi ose zgjatja e një Interesi Titulli i përshkruar në nënparagrafët (a) dhe (d) më sipër, me kusht që shuma principale e Borxhit Publik të Jashtëm e siguruar me këtë nuk rritet.

"Financimi i Projektit" është çdo masë për gjetjen e fondeve që duhet të përdoren vetëm për të financuar një projekt për përftimin, ndërtimin, zhvillimin ose shfrytëzimin e një prone.

"Borxh i Jashtëm Publik" është çdo detyrim (i ndryshëm nga Notat) për fondet e marra hua që (i) shprehen ose janë të pagueshme në një monedhë ose nëpërmjet një reference tek një monedhë e ndryshme nga monedha e ligjshme e Republikës së Shqipërisë dhe (ii) evidentohen ose përfaqësohen me bono, nota ose tituj të tjerë që për momentin janë të përshtatshme ose destinuar për t'u kuotuar, listuar ose tregtuar normalisht në çdo bursë, sistem të tregtimit automatik, mbi banak ose treg tjetër sigurimesh.

"Interes Titulli" është e drejta e pengut, pengu, hipoteka, interesi i titullit, rëndimi ose barrë të tjera apo masë preferenciale që ka efektin praktik të krijimit të një interesi titulli.

4. Interesi

Notat japin interes nga data [•] 2010 ("Data e Emetimit"), me normën [•] për qind në vit, ("Norma e Interesit") që paguhen në fund të afatit më [•] të çdo viti (secila, një "Datë për Pagesën e Interesit"), në pajtim me parashikimin e Kushtit 6 (Pagesat).

Secila Notë pushon së dhëni interes nga data e kërkueshme për shlyerje, përveç kur, me prezantimin e kërkueshëm, pagesa e principalit mbahet në mënyrë të parregullt ose refuzohet, dhe në këtë rast ajo vazhdon të japë interes në të njëjtën normë (si para ashtu edhe pas vendimit) deri në, cila do të jetë më parë (a) dita në të cilën të gjitha shumat e kërkueshme në lidhje me këtë Notë deri në atë ditë merre nga ose në emër të Zotëruesit përkatës të Notës dhe (b) dita që është shtatë ditë pasi Agjenti Fiskal ka njoftuar Zotëruesin e Notës që ai ka marrë të gjitha shumat e kërkueshme në lidhje me Notat deri në këtë ditë të shtatë (përveç në masën që ka patur një vonesë të mëvonshme në pagesë).

Shuma e interesit të pagueshëm në Datën e Pagesës së Interesit është €[•] për Shumë Llogarie. Nëse interesi kërkohet të paguhet në lidhje me një Notë në një datë tjetër, ai llogaritet duke zbatuar Normën e Interesit për Shumën e Llogaritjes, duke shumëzuar produktin me Fraksionin e Numërimit të Ditës përkatëse dhe duke e rrumbullakosur shifrën që del deri në centin më të afërt (gjysma e centit rrumbullakoset për lart) dhe duke shumëzuar këtë shifër të rrumbullakosur me një fraksion të barabartë me prerjen e kësaj Note të ndarë me Shumën e Llogarisë, ku:

"Shuma e Llogarisë" është € 1,000;

"Fraksioni i Numërimit të Ditës" është, në lidhje me këtë periudhë, numri i ditëve të periudhës përkatëse, nga (duke përfshirë) ditën e parë të kësaj periudhe deri (duke përjashtuar) ditën e fundit të kësaj periudhe, të ndarë nga numri i ditëve në Periudhën e Rregullt në të cilën përfshihet periudha përkatëse; dhe

"Periudha e Rregullt" është çdo periudhë nga (duke përfshirë) Datën e Emetimit ose çdo Datë të Pagesës së Interesit (duke përjashtuar) Datën tjetër të Pagesës së Interesit.

5. Shlyerja dhe Blerja

a) Shlyerja e planifikuar: Përveç kur shlyhet, ose blihet dhe anulohet më parë, Notat shlyhen në shumën e tyre kryesore më [•], në pajtim me parashikimin e Kushtit 6 (Pagesat).

b) Mosshlyerje të tjera: Emetuesi nuk ka të drejtë të shlyejë Notat ndryshe nga sa parashikohet në paragrafin (a) (Shlyerja e Planifikuar) më sipër.

c) Blerje: Emetuesi në çdo kohë mund të blejë Nota në treg të hapur ose ndryshe me çdo çmim, me kusht që të gjithë Kuponat e pamaturuar të blihen me to.

d) Anulimi: Të gjitha notat e shlyera apo blera nga Emetuesi dhe çdo Kupon i pamaturuar i bashkangjitur ose i dhënë anulohet dhe nuk mund të riemetohet apo rishitet.

6. Pagesat

a) Principali: Pagesat e principalit bëhen vetëm kundrejt paraqitjes dhe (me kusht që pagesa të bëhet plotësisht) dorëzimit të Notave në Zyrën e Caktuar të çdo Agjenti Pagues jashtë Shteteve të Bashkuara me tërheqje me çek në Euro ose me transfertë tek një llogari në Euro (ose një llogari tjetër ku mund të kreditohet apo transferohet Euro) që mbahet nga personi që merr pagesën tek një bankë në një qytet në të cilin bankat kanë hyrje në Sistemin TARGET.

b) Interesi: Pagesat e interesit, në pajtim me paragrafin (g) (Pagesat e ndryshme nga ato në lidhje me Kuponët e maturuar), më poshtë, bëhen vetëm kundrejt paraqitjes dhe (me kusht që pagesa të bëhet plotësisht) dorëzimit të Kuponave të përshtatshëm në Zyrën e Caktuar të çdo Agjenti Pagues jashtë Shteteve të Bashkuara në mënyrën e përshkruar në paragrafin (a) (Principali) më sipër.

c) Interpretimi: Në këto Kushte:

"Sistemi TARGET" është sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-Time Gross Settlement Express Transfer që përdor një platformë të vetme të përbashkët dhe që është vendosur në datën 19 nëntor 2007, dhe

d) Pagesat në pajtim me ligjet fiskale: Të gjitha pagesat në lidhje me Notat u nënshtrohen në të gjitha rastet ligjeve të zbatueshme fiskale dhe ligjeve dhe rregulloreve në vendin e pagesës, por pa cenuar dispozitat e Kushtit 7 (Tatimi). Nuk ngarkohen komisione ose shpenzime për Zotëruesit e Notave apo Zotëruesit e Kuponëve në lidhje me këto pagesa.

e) Zbritjet për Kuponët e pamaturuar: Nëse një Notë paraqitet pa të gjithë Kuponët e pamaturuar në lidhje me to, atëherë:

i) nëse shuma e plotë e Kuponave që mungojnë është më e vogël se ose e barabartë me shumën e principalit të kërkueshëm për pagesë, një shumë e barabartë me shumën e plotë të Kuponave që mungojnë do të zbritet nga shuma e principalit të kërkueshëm për pagesë, me kusht që nëse shuma bruto e ofruar për pagesë është më e vogël se shuma e principalit të kërkueshëm për pagesë, shuma e zbritur do të jetë ajo pjesë e shumës së plotë për ata Kuponë që mungojnë që shuma bruto që ofrohet praktikisht për pagesë ka në shumën e principalit që kërkohet për pagesë;

ii) nëse shuma e plotë e Kuponave që mungojnë është më e madhe se shuma e principalit që kërkohet për pagesë:

A. ky numër i Kuponave që mungojnë bëhet i pavlefshëm (në rend të kundërt me maturimin) që do të rezultojë në shumën e plotë të mbetjes së këtyre Kuptonave që mungojnë ("Kuponat Përkatës") të barabartë me shumën e principalit të kërkueshëm për pagesë; me kusht që, nëse ky nënparagraf do të kërkonte të bëhej i pavlefshëm një fraksion të një Kuptoni që mungon, ky Kupon bëhet i pavlefshëm në tërësinë e tij; dhe

B. një shumë e barabartë me shumën e plotë të Kuponave Përkatës (ose, nëse është më e vogël, shuma e principalit që kërkohet për pagesë) do të zbritet nga shuma e principalit të kërkueshëm për pagesë; me kusht që, nëse shuma bruto e ofruar për pagesë është më e vogël se shuma e principalit të kërkueshëm për pagesë, shuma e zbritur do të jetë ai raport i shumës së plotë të Kuponave Përkatës (ose, sipas rastit, shuma e principalit të kërkueshëm për pagesë) që mban shuma bruto që ofrohet faktikisht për pagesë kundrejt shumës së principalit të kërkueshëm për pagesë.

Çdo shumë e principalit që zbritet në këtë mënyrë paguhet në mënyrën e parashikuar në paragrafin (a) (Principali) e mësipërm kundrejt paraqitjes dhe (me kusht që pagesa të bëhet e plotë) dorëzimit të Kuponëve përkatës që mundojnë. Asnjë pagesë nuk bëhet në lidhje me kuponët e pavlefshëm.

f) Pagesat në ditët e punës: Nëse data e kërkueshme për pagesën e një shume në lidhje me një Notë ose Kupon nuk është një ditë pune në vend të prezantimit, zotëruesi nuk ka të drejtë për pagesën në këtë vend të shumës së kërkueshme deri në ditën pasuese të ditës së punës në atë vend dhe nuk ka të drejtë për interes tjetër apo pagesë tjetër në lidhje me këtë vonesë. Në këtë paragraf, "ditë pune" do të thotë: në lidhje me një vend prezantimi, çdo ditë në të cilën bankat janë të hapura për prezantim dhe pagesën e titujve të prurësit dhe për veprime në monedha të huaja në atë vend prezantimi dhe, në rastin e pagesës nëpërmjet transfertës tek një llogari Euroje sipas referencës së mësipërme, në të cilën është i hapur një Sistem TARGET.

g) Pagesat e ndryshme nga ato për Kuponat e maturuar: Pagesat e interesit të ndryshme nga ato në lidhje me Kuponat e maturuar bëhen vetëm kundrejt prezantimit të Notave përkatëse në Zyrën e përcaktuar të Agjentit Pagues jashtë Shteteve të Bashkuara.

h) Pagesat e pjesshme: Nëse një Agjent Pagues bën një pagesë të pjesshme në lidhje me një Notë ose Kupon të paraqitur tek ai për pagesë, ky Agjent Pagues nënshkruan një deklaratë që tregon shumën dhe datën e kësaj pagese.

7. Tatimi

Të gjitha pagesat e principalit dhe interesit në lidhje me Notat dhe Kuponat nga ose në emër të Emetuesit bëhen të lira dhe pa mbajtje apo zbritje për ose për llogari të një tatimi, detyrimi të tashëm apo të ardhshëm, vlerësimi apo detyrimi qeveritar i cilësdo natyre, të faturuar,vendosur vjelë, mbajtur apo vlerësuar në emër të Republikës së Shqipërisë ose një nën-ndarjeje politike të saj apo një autoriteti që ka kompetencë për të tatuar, përveç kur ndalimi ose zbritja e këtyre tatimeve, detyrimeve, vlerësimeve apo detyrimeve qeveritare kërkohet me ligj. Në atë rast Emetuesi paguan ato shuma shtesë që rezultojnë në marrjen nga Zotëruesit e Notave ose Zotëruesit e Kuponave pasi ky ndalim ose zbritje e këtyre shumave që do të ishin marrë prej tyre nëse ky ndalim ose zbritje nuk do të kërkohej, përveç kur këto shuma shtesë bëhen të pagueshme në lidhje me çdo Notë ose Kupon të paraqitur për pagesë:

a) nga ose në emër të zotëruesit që u nënshtrohet këtyre tatimeve, detyrimeve, vlerësimeve ose

detyrimeve qeveritare në lidhje me këtë Notë ose Kupon për shkak të pasjes së një lidhjeje me Republikën e Shqipërisë të ndryshme nga thjesht zotërimi i Notës ose Kuponit; ose

b) nëse ky ndalim ose zbritje vendoset mbi një pagesë për një individ dhe kërkohet të bëhet në pajtim me Direktivën e Këshillit Evropian 2003/48/EC mbi tatimin e të ardhurave nga kursimet ose çdo ligj që zbatohet ose respekton apo prezantohet për të respektuar këtë Direktivë; ose

c) nga ose në emër të një zotëruesi që do të ishte në gjendje të mënjanonte këtë ndalim ose zbritje duke paraqitur Notën ose Kuponin përkatës një Agjenti Pagues në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian; ose

d) më shumë se 30 ditë pas Datës Përkatëse përveç se në masën që zotëruesi i kësaj Note ose Kuponi do të kishte patur të drejtën për ato shuma shtesë me paraqitjen e këtij Kuponi ose Note për pagesën në ditën e fundit të kësaj periudhë prej 30 ditësh.

Në këto Kushte, "Data Përkatëse" do të thotë ajo që është me vonë nga (1) data në të cilën pagesa në fjalë bëhet e kërkueshme dhe (2) nëse shuma e plotë e pagueshme nuk është marrë në një qytet në të cilin bankat kanë hyrje në Sistemin TARGET nga Agjenti Fiskal në ose para kësaj date të kërkueshme, data në të cilën (shuma e plotë është marrë) njoftimi për atë qëllim u është bërë Zotëruesve të Notës.

Çdo referencë në këto Kushte tek principali ose interesi konsiderohet të përfshijë çdo shumë shtesë në lidhje me principalin dhe interesin (sipas rastit) që mund të jetë i pagueshëm në bazë të këtij Kushti 7 (Tatimi).

8. Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve

Nëse ndodh dhe vazhdon një nga rastet e mëposhtme (secili një “Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve”):

a) Mospagesa: çdo shumë e principalit nuk paguhet në datën e kërkueshme për pagesën e saj ose çdo shumë interesi mbi Notat nuk paguhet brenda 15 ditëve nga data e kërkueshme për pagesën e saj; ose

b) Shkelja e detyrimeve të tjera: Republika e Shqipërisë nuk përmbush ose respekton një ose disa prej detyrimeve të tjera në bazë të Notave, dhe ky mosplotësim i detyrimeve nuk mund të korrigjohet ose, nëse mund të korrigjohet, nuk korrigjohet brenda 30 ditëve pas njoftimit të këtij mosplotësimi detyrimi që i është bërë Republikës së Shqipërisë në zyrën e specifikuar të Agjentit Fiskal nga një zotërues i Notave; ose

c) Mosplotësimi i Dyfishtë i Detyrimeve i Emetuesit:

i) zotëruesit e një Borxhi Publik të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë e përshpejtojnë këtë Borxh të Jashtëm Publik ose e deklarojnë këtë Borxh të Jashtëm Publik të kërkueshëm dhe të pagueshëm, ose që kërkohet të parapaguhet (ndryshe nga një pagesë e kërkuar e planifikuar rregullisht), para maturimit të deklaruar fillimisht të tij; ose

ii) Republika e Shqipërisë nuk paguan plotësisht principalin ose interesin e një Borxhi të Jashtëm Publik kur bëhet i kërkueshëm (pas skadimit të një afati pa pagesa të zbatueshëm fillimisht) ose një Garanci për një Borxh të Jashtëm Publik të dhënë nga Republika e Shqipërisë nuk respektohet kur është i kërkueshëm dhe kërkohet (pas skadimit të një afati pa pagesa fillimisht të zbatueshëm); me kusht që shuma e përgjithshme e Borxhit të Jashtëm Publik ose Garancia në lidhje me të cilën një ose më shumë ngjarje të përmendura më sipër në këtë paragraf (c) kanë ndodhur është e barabartë ose më e madhe se EUR 20, 000, 000 ose ekuivalenti i saj në monedha të tjera; ose

d) Moratoriumi: Republika e Shqipërisë pezullon pagesën ose pranon paaftësinë e saj për të paguar Borxhin Publik të Jashtëm ose një pjesë të tij ose deklaron një moratorium të përgjithshëm në lidhje me Borxhin e saj Publik të Jashtëm ose një pjesë të tij ose ndodh një ngjarje e ngjashme nga sa më sipër; ose

e) Paligjshmëri ose Pavlefshmëri: Vlefshmëria e Notave kundërshtohet nga Republika e Shqipërisë ose Republika e Shqipërisë mohon ndonjë prej detyrimeve në bazë të Notave ose është apo bëhet e paligjshme për Republikën e Shqipërisë të përmbushë ose respektojë të gjitha ose ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara në Notat ose ndonjë prej detyrimeve të tilla është ose bëhet i paekzekutueshëm ose i pavlefshëm; ose

f) Fondi Monetar Ndërkombëtar: Republika e Shqipërisë pushon së qeni anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar ose pushon së qeni i përshtatshëm për të përdorur burimet e përgjithshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar: ose

g) Miratimi etj: çdo rregullore, dekret, pëlqim, aprovim, licence apo autoritet tjetër i nevojshëm për t'i mundësuar Emetuesit përmbushjen e detyrimeve në bazë të Notave ose të Marrëveshjes ndërkombëtare për Agjencinë Fiskale ose për vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e saj skadon ose mbahet, revokohet, pushohet ose ndryshe pushon së qeni në fuqi ose ndryshohet në mënyrën që ndikon negativisht çdo të drejtë ose pretendim të një Zotëruesi Notash në lidhje me çdo pagesë të kërkueshme në pajtim me këtë Kushte,

atëherë zotëruesit e të paktën 25 për qind, në shumën principale të plotë të Notave të mbetura, me njoftim me shkrim drejtuar Emetuesit (me një kopje drejtuar Agjentit Fiskal), deklarojnë të gjitha Notat menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, dhe me këtë rast ato bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme në shumën e tyre principale së bashku me interesin e mbledhur pa veprim apo formalitet tjetër. Njoftimi i një deklarate të tillë u bëhet menjëherë të gjithë Zotëruesve të notave nga Emetuesi. Nëse Emetuesi merr njoftim me shkrim nga zotëruesit e të paktën 50 për qind në shumën principale të përgjithshme të Notave të mbetura me efektin që Rasti ose Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve që shkaktojnë një prej deklaratave të përshpejtimit të përmendura më sipër korrigjohet ose korrigjohen pas një deklarate të tillë dhe që zotëruesit dëshirojnë që kjo deklaratë të tërhiqet, Emetuesi u bën njoftim për këtë Zotëruesve të Notave (dhe për dijeni Agjentit Fiskal), dhe pas kësaj deklarata përkatëse tërhiqet dhe nuk ka efekt tjetër të mëtejshëm pa ndikim mbi të drejtat ose detyrimet që mund të kenë lindur para se Emetuesi të ketë bërë këtë njoftim (në pajtim me këto Kushte apo ndryshe). Asnjë tërheqje e tillë nuk ndikon mbi ndonjë Rast pasues të Mosplotësimit të Detyrimeve ose ndonjë të drejtë të një Zotëruesi Note në lidhje me to.

Në këto Kushte:

"Garanci" do të thotë çdo garanci ose zhdëmtim në lidhje me borxhin apo një detyrim tjetër të ngjashëm.

9. Parashkrimi

Pretendimet për principalin bëhen të pavlefshme përveç kur Notat përkatëse paraqiten për pagesë brenda dhjetë vjetëve nga Data Përkatëse e përshtatshme. Pretendimet për interes bëhen të pavlefshme përveç kur Kuponat përkatës paraqiten për pagesë brenda pesë vjetëve nga Data Përkatëse e përshtatshme.

10. Zëvendësimi i Notave dhe Kuponave

Nëse një Notë ose Kupon humbet, vidhet, prishet, dëmtohet apo shkatërrohet, ai mund të zëvendësohet në Zyrën e Specifikuar të Agjentit Fiskal, në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe kërkesat e këmbimit të bursës, me pagesën nga pretenduesi të shpenzimeve të kërkuara në lidhje me këtë zëvendësim dhe me ato terma në lidhje me provat, garancinë, zhdëmtimin apo tjetër që Emetuesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Notat ose Kuponat e prishura ose të dëmtuara duhet të dorëzohen para së të bëhet zëvendësimi.

11. Agjentët Pagues

Gjatë veprimit në pajtim me Marrëveshjen e Agjencisë dhe në lidhje me Notat dhe Kuponat, Agjenti Pagues vepron vetëm si agjent i Emetuesi dhe nuk merr ndonjë detyrim kundrejt apo ndonjë raport agjencie apo besimi me ndonjë prej Zotëruesit e Notave ose Zotëruesit e Kuponave.

Agjenti Pagues fillestar dhe Zyrat e tyre fillestare të përcaktuara janë renditur më poshtë. emetuesi rezervon të drejtën që në çdo kohë të ndryshojë ose ndërpresë emërimin e Agjentit Pagues dhe të emërojë një agjent pasues fiskal dhe agjentë shtesë pagues; megjithatë me kusht që Emetuesi të ketë gjithmonë (a) një agjent fiskal, (b) agjent pagues në Londër dhe (c) një agjent pagues në një shtet anëtar të BE-së dhe nuk është i detyruar të mbajë ose zbresë tatimet në pajtim me ndonjë ligj që zbaton Direktivën e Këshillit Evropian 2003/48/EC.

Njoftimi për çdo ndryshim në Agjentët Pagues ose në Zyrat e tyre Përkatëse u bëhet menjëherë Zotëruesve të Notave.

12. Takimet e Zotëruesve të Notave; Rezolutat me Shkrim

a) Thirrja e Takimeve të Zotëruesve të Notave

Marrëveshja e Agjencisë Fiskale përmban dispozita për thirrjen e takimeve të Zotëruesve të Notave për të shqyrtuar çështjet në lidhje me Notat, duke përfshirë modifikimin e çdo dispozite të këtyre Kushteve ose dispozitave të Marrëveshjes së Agjencisë Fiskale. Një takim i tillë thirret nga Emetuesi ose Agjenti Fiskal dhe thirret nga Emetuesi ose Agjenti Fiskal në çdo moment me kërkesë me shkrim të zotëruesve të të paktën 10 për qind të shumës principale të përgjithshme të Notave të mbetura.

b) Kuorumi

Kuorumi në çdo mbledhje të Zotëruesve të Notave që mblidhet për të votuar për një Rezolutë të Jashtëzakonshme do të jetë:

i) një ose disa persona të pranishëm që zotërojnë ose përfaqësojnë të paktën 50 për qind të shumës principale të përgjithshme të Notave të mbetura; ose

ii) nëse një takim shtyhet dhe riplanifikohet për shkak të mungesës së kuorumit, në çdo mbledhje të ricaktuar të Zotëruesve të Notave, një ose më shumë persona të pranishëm që kanë ose përfaqësojnë të paktën 25 për qind të shumës së përgjithshme principale të Notave të mbetura;

megjithatë, me kusht që çdo propozim në lidhje me një Çështje të Rezervuar mund të aprovohet nga një Rezolutë e Jashtëzakonshme e miratuar në një mbledhje të Zotëruesve të Notave ku një ose më shumë persona të pranishëm që kanë ose përfaqësojnë të paktën 75 për qind të shumës së përgjithshme principale të Notave të mbetura përbëjnë kuorumin.

c) Çështje të Rezervuara

Në këto Kushte, " Çështje të Rezervuara " do të thotë, në pajtim me paragrafin (d) (Çështje që kërkojnë unanimitet), çdo propozim:

i) për të ndryshuar datën ose metodën e përcaktimit të datës për pagesën e principalit, interesit ose një shume tjetër në lidhje me Notat, ose për të pakësuar ose anuluar shumën e principalit, interesit apo një shumë tjetër të pagueshme në një datë në lidhje me Notat ose për të ndryshuar metodën e llogaritjes së shumës së principalit, interesit apo një shumë tjetër të pagueshme në lidhje me Notat në një datë të caktuar;

ii) për të ndryshuar monedhën në të cilën një shumë e caktuar në lidhje me Notat është e pagueshme ose vendin në të cilin duhet të bëhet pagesa;

iii) për të ndryshuar kuorumin e kërkuar në çdo mbledhje të Zotëruesve të Notave ose shumicën e kërkuar për të miratuar një Rezolutë të Jashtëzakonshme, Rezolutë me Shkrim (siç përcaktohet në Kushtin 12 (f)) ose një rezolutë tjetër të Zotëruesve të Notave ose numrin ose përqindjen e Notave që kërkohet për t'u mbajtur, në lidhje me marrjen e një vendimi ose veprimi nga ose në emër të Zotëruesve të Notave ose të një prej tyre;

iv) për të ndryshuar këtë përkufizim, përkufizimin e "Rezolutë e Jashtëzakonshme", përkufizimin e "i mbetur" ose përkufizimin e "Rezolute më Shkrim";

v) për të ndryshuar ose hequr dorë nga dispozitat e Notave të përcaktuara në Kushtin 2 (Statusi); ose

vi) për të ndryshuar çdo dispozitë të Notave që përshkruajnë rrethanat në të cilën Notat mund të deklarohen të kërkueshme dhe të pagueshme para datës së maturimit të planifikuar, të përcaktuar në Kushtin 8 (Rasti i Mosplotësimit të Detyrimeve).

d) Çështjet që kërkojnë unanimitet:

Çdo propozim:

i) për të ndryshuar ligjin e zbatuar për Notat, gjykatat në juridiksionin e të cilave Emetuesi ka nënshtruar Notat, detyrimin e emetuesit për të mbajtur një agjent për dorëzimin e dokumenteve gjyqësore në Angli ose Heqjen Dorë nga Emetuesi nga imuniteti, në lidhje me veprimet ose gjykimet e filluara nga një Zotërues i Notave, të përcaktuara në Kushtin 17 (Ligji Mbizoterues);

ii) për të ndryshuar një dispozitë të këtyre Kushteve në lidhje me një ndryshim ose zëvendësim të Notave për, ose konvertimin e Notave në detyrime të tjera ose tituj të tjerë të Emetuesit ose një personi tjetër, që do të rezultonin në Kushtet e modifikuara më pak të favorshme për zotëruesit e Notave që u nënshtrohen kushteve të modifikuara, se sa:

A. dispozitat e detyrimeve apo titujve të tjerë të Emetuesit ose një personi tjetër që rrjedhin nga shkëmbimi përkatës ose zëvendësimi apo konvertimi; apo

B. nëse më shumë se një seri e detyrimeve ose garancive rezulton nga shkëmbimi ose zëvendësimi apo konvertimi, dispozitat e serisë rezultuese që kanë shumën më të madhe principale të përbashkët; ose

iii) për të modifikuar dispozitat e këtij paragrafi (d) (Çështjet që kërkojnë unanimitet), mund t'u jepet efekt me pëlqimin e zotëruesve të të gjithë Notave të mbetura.

e) Modifikimet

Në pajtim me dispozitat e paragrafit (d) Çështjet që kërkojnë unanimitet) çdo modifikim i këtyre dispozitave të këtyre Kushteve mund të bëhet nëse aprovohet nga një Rezolutë e

Jashtëzakonshme apo një Rezolutë me Shkrim Në këto Kushte, “Rezolutë e Jashtëzakonshme” do të thotë një rezolutë e miratuar në një mbledhje të Zotëruesve të Notave të mbledhur rregullisht dhe që mbahet në pajtim me Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale nga një shumicë prej të paktën:

i) në rastin e Çështjeve të Rezervuara, 75 për qind e shumës principale të plotë të Notave të mbetura; ose

ii) në rastin e një çështjeje të ndryshme nga Çështje e Rezervuar, 66 2/3 për qind e shumës principale të plotë të Notave të mbetura që përfaqësohen në mbledhje.

Një Rezolutë e Jashtëzakonshme e miratuar rregullisht në çdo mbledhje të tillë është detyruese për të gjithë Zotëruesit e Notave, të pranishëm ose jo dhe nëse ata kanë votuar në favor apo jo, dhe të gjithë Zotëruesit e Kuponëve.

f) Rezolutat me Shkrim

Përveç kësaj, Marrëveshja e Agjencisë Fiskale përmban dispozita në lidhje me Rezolutat me Shkrim. Një “Rezolutë me Shkrim” është një rezolutë me shkrim e nënshkruar nga ose në emër të zotëruesve prej të paktën 75 për qind të shumës së plotë principale të Notave të mbetura, në rastin e një Çështjeje të Rezervuar, ose 66 2/3 për qind të shumës së plotë principale të Notave të mbetura, në rastin e një çështjeje të ndryshme nga një Çështje e Rezervuar. Një Rezolutë me Shkrim mund të gjendet në një dokument ose disa dokumente në të njëjtën formë, secili i nënshkruar nga ose në emër të një ose më shumë Zotëruesve të Notave. Çdo Rezolutë me Shkrim është detyruese për të gjithë Zotëruesit e Notave, qofshin të nënshkruara prej tyre apo jo, dhe për të gjithë Zotëruesit e Kuponëve.

g) Gabim i dukshëm, etj.

Notat, këto Kushte dhe dispozitat e Marrëveshjes të Agjencisë Fiskale mund të ndryshohen pa pëlqimin e Zotëruesve të Notave ose Zotëruesve të Notave për të korrigjuar një gabim të dukshëm. Përveç kësaj, palët në Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale mund të bien dakord për të modifikuar dispozitat e saj, por emetuesi nuk bie dakord pa pëlqimin e Zotëruesve të Notave për asnjë modifikim të tillë, përveç kur është i një natyre formale, të parëndësishme ose teknike ose nuk cenon materialisht interesat e Zotëruesve të Notave.

h) Notat e kontrolluara nga Emetuesi

Për qëllimet e (i) pohimit të të drejtës së pjesëmarrjes dhe votimit në një mbledhje të Zotëruesve të Notave ose të drejtën për nënshkruar ose autorizuar nënshkrimin e çdo Rezolute me Shkrim, (ii) ky Kusht 12 (Takimet e Zotëruesve të Notave; Rezolutat me Shkrim) dhe Grafiku 5 (Takimet e Zotëruesve të Notave) i Marrëveshjes së Agjencisë Fiskale, (iii) Kushti 13 (Komiteti i Zotëruesve të Notave) dhe (iv) Kushti 8 (Rasti i Mosplotësimit të Detyrimeve), ato Nota (sipas rastit) që mbahen në rrethanat ku Emetuesi ka kompetencën të drejtojë hedhjen në votë në lidhje më këto Nota, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, (përveç dhe deri sa të pushojë kjo konsideratë) konsiderohet dhe mendohet të mos qëndrojë e mbetur. Pa cenuar përgjithësimin e fjalisë së mëparshme, emetuesi konsiderohet të ketë kompetencën të drejtojë hedhjen në votë në lidhje me një Notë, nëse Nota zotërohet nga ose në emër të emetuesit ose nga apo në emër të një personi që është në pronësi apo kontrollohet drejtpërdrejt ose jo nga emetuesi ose nga një instrument i sektorit publik nga Emetuesi, nëse

i) "Instrumentaliteti i sektorit publik" është Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe çdo departament tjetër, ministri apo agjenci të qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose çdo korporatë, trust, institucion financiar ose subjekt tjetër në pronësi ose kontroll të qeverisë së Republikës së Shqipërisë; dhe

ii) "kontroll" është kompetenca, e drejtpërdrejtë ose jo, nëpërmjet pronësisë së titujve të votimit ose interesave të tjera të pronësisë apo tjetër, për të drejtuar menaxhimin ose zgjedhur apo caktuar një shumicë të bordit të drejtorëve ose personave të tjerë që përmbushin funksione të ngjashme në mungesë të ose si shtesë e bordit të drejtorëve të një korporate, trusti, institucioni financiar ose subjekti tjetër.

Para çdo mbledhjeje të Zotëruesve të Notave ose Rezolutës me Shkrim Emetuesi i jep Agjentit fiskal një certifikatë të emetuesit që përcakton numrin e përgjithshëm të Notave që mbahen në rrethanat kur Emetuesi ka në datën e një certifikate të tillë kompetencën për të drejtuar votimin në lidhje me këto Nota. Agjenti Fiskal ofron për inspektim çdo certifikatë të tillë gjatë orëve normale të punës në Zyrën e Përcaktuar dhe, me kërkesë të arsyeshme, lejon bërjen e kopjeve të kësaj certifikate.

13. Komiteti i Zotëruesve të Notave

a) Emërimi

Zotëruesit e Notave, me një rezolutë të miratuar në mbledhjen e Zotëruesve të Notave të thirrur rregullisht dhe të mbajtur në pajtim me Marrëveshjen e Agjencisë Fiskale me një shumicë prej të paktën 50 për qind në shumën e plotë principale të Notave që është e mbetur ose me njoftim me shkrim drejtuar Emetuesit (për dijeni Agjentit Fiskal) të nënshkruar nga ose në emër të zotëruesve prej të paktën 50 për qind të shumës principale të plotë të Notave të mbetura, emërojnë çdo person ose persona si një komitet për të përfaqësuar interesat e Zotëruesve të Notave nëse ka ndodhur një nga ngjarjet e mëposhtme:

i) një Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve;

ii) një ngjarje ose rrethanë që, me bërjen e njoftimit, parashkrimin, lëshimin e një certifikate dhe/ose përmbushjen e një kërkese tjetër të parashikuar në Kushtin 8 (Rasti i Mosplotësimit të Detyrimeve) mund të bëhen Raste të Mosplotësimit të Detyrimeve; ose

iii) çdo njoftim publik nga Emetuesi, me qëllim që Emetuesi kërkon ose synon të kërkojë ristrukturimin e Notave (qoftë me ndryshim, këmbim, ofertë apo tjetër),

me kusht që, asnjë caktim tjetër nuk hyn në fuqi nëse zotëruesit e më shumë se 25 për qind të shumës principale të plotë të Notave të mbetura kanë (A) kundërshtuar këtë emërim me njoftim me shkrim drejtuar emetuesit (për dijeni Agjentit Fiskal) gjatë periudhës së specifikuar pas njoftimit të caktimit (nëse një njoftim i tillë i emërimit bëhet me shkrim drejtuar Emetuesit) nëse kjo periudhë e tillë është 30 ditë ose më e gjatë apo më e shkurtër, që komiteti mund të vendosë, duke vepruar në mirëbesim, të jetë i përshtatshëm sipas rrethanave, ose (B) votuar kundër një rezolute të tillë në një mbledhje të Zotëruesve të Notave të mbledhur rregullisht dhe të mbajtur në pajtim me Marrëveshjen për Agjencinë Fiskale. Ky komitet, nëse caktohet me njoftim me shkrim drejtuar Emetuesit, bën njoftim për emërimin e tij për të gjithë zotëruesit e Notave në pajtim me Kushtin 15 (Njoftimet) sapo të e mundur pasi njoftimi t'i jetë bërë emetuesit.

b) Kompetencat

Ky komitet, në diskrecionin e tij, ndërmjet të tjerash mund të (i) përfshijë këshilltarë ligjorë dhe këshilltarë financiarë për të asistuar në përfaqësimin e interesave të Zotëruesve të Notave, (ii) miratojë ato rregulla që i konsideron të përshtatshme në lidhje me gjykimet, (iii) hyn në diskutime me Emetuesin dhe/ose kreditorë të tjerë të Emetuesit, (iv) cakton një ose disa anëtarë të komitetit për të vepruar si pikat kryesore të kontaktit me emetuesin dhe të japë të gjitha hollësitë e kontaktit Emetuesit, (v) përcaktojë nëse ka ndonjë konflikt aktual ose potencial interesi ndërmjet interesave të zotëruesve të Notave të mbetura dhe interesave të zotëruesve të titujve të borxhit dhe ndonjë apo më shumë serive të tjera të lëshuara nga emetuesi dhe (vi) me përcaktimin e mungesës së konfliktit potencial apo aktual të interesave të zotëruesve të Notave që janë të mbetura dhe interesave të zotëruesve të titujve të borxhit të një ose më shumë serive të emetuara nga Emetuesi bien dakord të veprojnë në një mbledhje të kombinuar të komitetit dhe këtyre personave të tjerë që mund të jenë caktuar rregullisht si përfaqësues të zotëruesve të titujve të secilës seri tjetër. Përveç kur parashikohet në këtë paragraf (b) (Kompetencat), ky komitet nuk ka aftësinë për të ushtruar kompetenca apo diskrecionin që Zotëruesit e Notave mund të ushtronin vetë. Emetuesi mund të paguajë çdo tarifë dhe shpenzim që shkaktohen në mënyrë të arsyeshme nga një komitet i tillë dhe çdo komitet i tillë i kombinuar (duke përfshirë, pa u kufizuar, në shpenzimet e dhënies së njoftimeve për Zotëruesit e Notave, tarifat dhe shpenzimet e këshilltarëve ligjore dhe financiarë të komitetit, sipas rastit) brenda 30 ditëve nga dhënia tek emetuesi i një fature të hollësishme të arsyeshme dhe dokumentacionit mbështetës.

14. Çështje të Tjera

Emetuesi, herë pas here, pa pëlqimin e Zotëruesit të Notave ose të Zotëruesit të Kuponëve krijon dhe emeton nota të tjera që kanë të njëjtat terma dhe kushte si Notat në të gjitha aspektet (ose në të gjitha aspektet përveç pagesës së parë të interesit) për të formuar një seri të vetme me Notat.

15. Njoftimet

Njoftimet për Zotëruesit e Notave janë të vlefshme vetëm nëse publikohen në një gazetë kryesore në gjuhën angleze të përditshme të publikuar në Londër (që pritet të jetë Financial Times). Çdo njoftim i tillë konsiderohet të jetë bërë në datën e publikimit të parë. Zotëruesit e Kuponëve konsiderohen për të gjitha qëllimet të kenë njoftim për të gjitha njoftimet e dhëna Zotëruesve të Notave.

Të gjitha njoftimet drejtuar Emetuesit do të jenë të vlefshme nëse i dërgohen Republikës së Shqipërisë (Ministrisë së Financave) të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, ose në një adresë tjetër që mund të njoftohet nga Emetuesi Zotëruesit të Notave në pajtim me paragrafin e mësipërm.

16. Zhdëmtimi i Monedhës

Nëse një shumë e kërkueshme prej emetuesit në lidhje me Notat ose Kuponët ose një vendim apo urdhër i dhënë në lidhje me këtë është konvertuar nga monedha ("monedha e parë") në të cilën ajo paguhet në bazë të këtyre Kushteve ose një vendim apo urdhër në një monedhë tjetër ("monedha e dytë") për qëllimin e (a) bërjes ose depozitimit të një pretendimi ose prove kundër Emetuesit, (b) marrjes së një urdhri apo vendimi në një gjykatë ose organ tjetër ose (c) ekzekutimit të një urdhri apo vendimi të dhënë apo marrë në lidhje me Notat, Emetuesi zhdëmton çdo Zotërues Notash me kërkesë me shkrim të këtij Zotëruesi Notash drejtuar emetuesit dhe dorëzuar Emetuesit ose Zyrës Përkatëse të Agjentit fiskal, ndaj çdo humbjeje të pësuar si rezultat i një mospërputhjeje ndërmjet (i) kursit të këmbimit të përdorur për këtë qëllim për të konvertuar shumën në fjalë nga monedha e parë në monedhën e dytë dhe (ii) kursin ose kurset e këmbimit me të cilin Zotëruesi i Notave mund të ketë blerë normalisht në treg monedhën e parë me monedhën e dytë me marrjen e një shume të paguar për të në përmbushje, plotësisht ose pjesërisht, të një urdhri, vendimi, pretendimi apo prove.

Ky zhdëmtim përbën një detyrim të ndarë dhe të pavarur të Emetuesit dhe përbën shkak për një veprim të veçantë dhe të pavarur.

17. Ligji Mbizoterues

Notat dhe çdo detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me Notat rregullohet nga ligji anglez.

18. Arbitrazhi

(a) Arbitrazhi

Në pajtim me Kushtin 18(e) (Opsioni i Zotëruesve të Notave), çdo mosmarrëveshje ("Mosmarrëveshje") që rrjedh nga ose në lidhje me Notat (duke përfshirë çdo detyrim jo-kontraktor që rrjedh nga ose në lidhje me Notat) i referohet arbitrazhit në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar (LCIA), dhe këto rregulla konsiderohen të përfshihen nëpërmjet referencës në këtë Kusht.

(b) Formimi i gjykatës së arbitrazhit, selia dhe gjuha e arbitrazhit

i) Formimi i gjykatës së arbitrazhit: Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra, secili prej të cilëve nuk ka interes në mosmarrëveshje dhe nuk ka lidhje me asnjë palë dhe është një jurist me eksperiencë në veprimet e titujve ndërkombëtarë. Emetuesi dhe Zoteruesi i Notave secili cakton një arbitër të cilët se bashku caktojnë Kryetarin e Gjykatës. Nëse ky caktim nuk ka ndodhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pasi pala paditëse bën kërkesën për arbitrazh, ose nëse një Kryetar nuk është zgjedhur brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga zgjedhja e arbitrit të dytë, Gjykata e Arbitrazhit e Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar cakton tre arbitra ose Kryetarin, sipas rastit. Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit mund të caktojë arbitra nga shtetasit e çdo vendi, pavarësisht nëse një palë është shtetas i atij vendi. Arbitrat nuk kanë autoritet për të dhënë vendime zhdëmtimi si dënim dhe në asnjë rast nuk mund të vendosë apo bëjë konstatime në kundërshtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

ii) Selia e arbitrazhit: Selia e arbitrazhit është Londra, Angli dhe të gjitha seancat janë në Londër, Angli.

iii) Gjuha e arbitrazhit: Gjuha e arbitrazhit është anglishtja.

c) Tarifat

Tarifat e arbitrazhit (duke përjashtuar përgatitjen e çdo pale, udhëtimin, tarifat e avokatëve dhe koston e ngjashme) mbulohet në pajtim me vendimin e arbitrave. Vendimi i arbitrave është përfundimtar, detyrues dhe i ekzekutueshëm për palët dhe vendimi mbi çdo vendim arbitrazhi mund të konfirmohet në çdo gjykatë që ka juridiksion mbi të.

d) Rekursi në Gjykatë

Për qëllimet e arbitrazhit në pajtim me Kushtin 18 (Arbitrazhi), Emetuesi dhe Zotëruesit e Notave përjashtojnë juridiksionin e Gjykatave sipas Seksioneve 45 dhe 69 të Ligjit të Arbitrazhit të vitit 1996.

e) Opsioni i Zotëruesve të Notave

Ne cdo kohe para se nje Zotërues Notash, ka caktuar nje arbiter per te zgjidhur cdo Mosmarreveshje ose Mosmarreveshjet sipas Kushteve 18 (a) (Arbitrazhi), cdo Zotërues Notash me te drejten e tij, mund te zgjedhe me njoftim drejtuar me shkrim Emetuesit, qe kjo Mosmarrëveshje ose Mosmarrëveshjet të shqyrtohen nga gjykata e Anglise ose nga cdo gjykate tjeter e juridksionit kompetent sic pershkruhet me hollesisht ne Kushtet 19 (c) (Te drejtat e Zotëruesve te Notave per te

filluar gjykime jashte Anglise). Ne vijim te ndonje zgjedhje te tille asnje gjykate arbitrazhi nuk do te kete jurdiksionin lidhur me ndonje Mosmarrëveshje ose Mosmarrëveshjet.

19. Gjykatat angleze

a) Juridiksioni

Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje ose Mosmarrevshjet që rrjedh nga ose në lidhje me Notat (duke përfshirë çdo detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me Notat).

b) Forumi i përshtatshëm:

Emetuesi bie dakord që gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje ose Mosmarreveshjet dhe, për pasojë, nuk do të argumentojë të kundërtën.

c) Të drejtat e Zotëruesve të Notave për të filluar gjykime jashtë Anglisë:

Kushti 19 (Gjykatat angleze) është në interes vetëm të Zotëruesve të Notave. Si rezultat, asgjë në këtë Kusht 17 (Ligji Mbizoterues), 18 (Arbitrazhi), 19 (Gjykatat Angleze) nuk pengon Zotëruesin e Notave nga fillimi i procedimeve në lidhje me një Mosmarrëveshje ("Procedimet") në çdo gjykatë tjetër me juridiksion. Në masën që lejohet nga ligji, Zotëruesit e Notave mund të fillojnë procedim njëkohësisht në një numër juridiksionesh.

d) Agjenti i dorëzimit të dokumenteve:

Emetuesi bie dakord që dokumentet që fillojnë Procedime dhe çdo dokument tjetër që kërkohet të jepet në lidhje me ato Procedime mund të dorëzohen tek Emetuesi në Issuer at Law Debenture Corporate Services Limited at 5th Floor, 100 Wood Street, London EC2V 7EX, England. Nese per ndonje aresye ky person nuk eshte ose pushon se qeni efektivisht i caktuar te pranoje dorezimin e dokumentavene emer te Emetuesit, Emetuesi do te caktoje nje person tjeter ne Angli pet pranuar dorezimin e dokumentave ne emer te tij dhe do te dorezoje ne Zyren e Percaktuar te Agjentit Fiskal nje kopje te pranimit e agjentit te ri te caktuar brenda 30 diteve. Asgje ne kete paragraf nuk do te kufizoje te drejten e cdo Zoteruesi Notash te dorezoje dokumentat kunder Emetuesit ne cdo menyre tjeter te lejuar me ligj.

e) Miratimi për Zbatim etj.

Emetuesi përgjithësisht jep pëlqimin për çdo Procedim për dhënien e çdo ndihme ose nxjerrjen e çdo dokumenti në lidhje me këtë Procedim, duke përfshirë (pa kufizim) bërjen, ekzekutimin dhe zbatimin mbi një pronë cilado qoftë (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i destinuar) të çdo urdhri apo vendimi që është dhënë në këtë Procedim.

f) Heqja dorë nga Imuniteti:

Në masën që emetuesi mund të pretendojë në çdo juridiksion për veten e vet apo për sendet e tij pasurore ose të ardhurat imunitet ndaj padisë, ekzekutimit, sekuestrimit (qoftë në kuadrin e ekzekutimit para vendimit ose ndryshe) ose veprimi tjetër ligjor dhe në masën që ky imunitet (që pretendohet apo jo) mund t’i atribuohet në çdo juridiksion emetuesit ose sendeve pasurore apo të ardhurave, Emetuesi bie dakord të mos pretendojë dhe heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga ky imunitet në masën më të gjerë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni (me kusht që Emetuesi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me (i) “godinat e misionit” të tashme ose të ardhshme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, “godinat e misionit” të tashme ose të ardhshme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, ose të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj; (ii) çdo pronë e paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e Nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr 8743, datë 22/02/2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”; ose (iii) një fond monetar dhe/ose shumë të destinuar për të përmbushur detyrimet e Republikës së Shqipërisë në bazë të traktateve, konventave apo marrëveshjeve të nënshkruara prej saj (për t’u diskutuar).